



BASHKIA VAU-DEJËS

PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR
RAPORT I PËRMBLEDHUR

Vau-Dejës 2017



BASHKIA VAU-DEJËS

**PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR
RAPORT I PËRMBLEDHUR**



Titulli: Plani i Përgjithshëm Vendor/Raport i Përmbledhur

Autorësia dhe kontributet: Ky dokument u përgatit nga Bashkia Vau-Dejës nën drejtimin e kryetarit të bashkisë z. Zef Hila, mbështetur nga Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (DLDP) në Shqipëri, përmes Agjencisë Zvicerane për Zhvillim (SDC), me ndihmesën teknike të konsulentit UTS-01 dhe mbikëqyrjen teknike nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit.

Grupi i punës:

Bashkia: Ana Shurdha, Joana Markolaj, Indrit Gradeci, Nikoline Kolndreu, Aurora Shkoza

Konsulenti: Roberto Mascarucci, Gjergji Islami, Markel Baballëku, Edmond Përgega, Marsida Tuxhari, Piero Rovigatti, Mario Eboli, Alfred Lako, Antonio Demaio, Admir Agolli, Shyqyri Aliaj, Oltion Marko, Enola Muhametaj, Klaudio Çollaku, Altin Sula, Shpresa Prifti, Denada Veizaj, Desi Memoçi, Ani Verzivolli, Ana Bregu, Majlinda Shehu, Arjan Shyti, Patris Martopullo, Anisa Llango, Ina Bajlozi

Përmbajtja

1	HYRJE	1
2	ANALIZA TERRITORIALE	2
2.1	Direktivat e planeve ekzistuese kombëtare, sektoriale, standardeve dhe normave	2
2.1.1	Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit (PPKT)	2
2.1.2	Dokumentet e tjera të planifikimit.....	3
2.2	Vështrim i përgjithshëm mbi territorin	4
2.2.1	Klima.....	7
2.2.2	Sizmiciteti	8
2.2.3	Burimet minerare.....	8
2.2.4	Burimet natyrore dhe zonat e mbrojtura.....	9
2.2.5	Burimet ujore dhe brigjet.....	10
2.2.6	Analiza mjedisore	11
2.2.7	Sistemi bujqësor	11
2.2.8	Zonat e trashëgimisë kulturore dhe historike.....	13
2.2.9	Infrastruktura	14
2.3	Përdorimi i tokës dhe 5 Sistemet	16
2.3.1	Sistemi Urban	16
2.3.2	Sistemi Natyror.....	17
2.3.3	Sistemi Bujqësor.....	17
2.3.4	Sistemi Ujor	18
2.3.5	Sistemi i Infrastrukturës	18
2.4	Popullsia, lëvizjet demografike dhe strehimi (stoku i banesave)	19
2.5	Aspektet ekonomike dhe sociale	20
2.6	Arsimi dhe shëndetësia	25
2.6.1	Arsimi	25
2.6.2	Shëndetësia	25
2.7	Aspektet sociale	26
2.8	Përgatitja e bazës së të dhënave të sistemit të informacionit gjeografik (GIS)	26
3	STRATEGJIA TERRITORIALE	27
3.1	Vizioni strategjik	27
3.1.1	Vizioni në shkallë të ndryshme.....	27
3.1.2	Koncepti i zhvillimit territorial.....	28
3.1.3	Objektivat dhe ndërhyrjet strategjike	30
3.2	Projektet dhe programet e zhvillimit	33
3.2.1	Projektet e ndërhyrjes.....	33
3.2.2	Përcaktimi i prioriteteve.....	35
3.3	Plani i Investimeve Kapitale dhe lidhja me PBA	55
3.3.1	Burimet financiare.....	55
3.3.2	Plani i veprimtimit	56

3.3.3	Lidhja e PPV me PBA	68
4	PLANI I ZHVILLIMIT	77
4.1	Plani i propozimeve territoriale.....	77
4.1.1	Ndarja e territorit sipas 5 sistemeve bazë.....	77
4.1.2	Ndarja e territorit në njësi zhvillimi.....	77
4.1.3	Rrjeti i infrastrukturave	79
4.1.4	Zonat e rëndësisë kombëtare	79
4.1.5	Zonat prioritare të zhvillimit ekonomik dhe urban	80
4.1.6	Planet e detajuara vendore (PDV).....	80
4.1.7	Shpërndarja e popullsisë në territor	81
4.1.8	Plani i strehimit	81
4.2	Plani i shërbimeve dhe infrastrukturave publike.....	82
4.2.1	Infrastruktura publike	82
4.2.2	Shërbimet sociale, tipologjia dhe rrezet e mbulimit	84
4.3	Monitorimi dhe rishikimi i planit të zhvillimit	84
5	RREGULLORJA VENDORE.....	86
5.1	Treguesit e zhvillimit.....	86
5.1.1	Intensiteti i ndërtimit	86
5.1.2	Kufizime sektoriale.....	86
5.2	Rregulla të përbashkëta për ndërtimet.....	87
5.2.1	Qendrat urbane.....	87
5.2.2	Efikasiteti energjetik.....	87
5.2.3	Monumentet e kulturës dhe ato historike	87
5.2.4	Bimësia në zonat urbane.....	88
5.2.5	Hapësira dhe përmirësimi i standardeve mjedisore	88
5.3	Pasaportat e njërive	88
6	Transparenca dhe përfshirja e qytetarëve	91
7	ANEKS.....	93

Lista e figurave

Fig. 1: Poli i zhvillimit rajonal Shkodër – Lezhë	2
Fig. 2: Njësitë administrative të Bashkisë Vau-Dejës	4
Fig. 3: Qendrat e banuara (qytete/fshatra) të Bashkisë Vau-Dejës	5
Fig. 4: Hartë veneciane e vitit 1571 e territorit të Vau-Dejës (Dagna)	6
Fig. 5: Pozicioni strategjik në raport me rajonin	6
Fig. 6: Toka bujqësore dhe përqëndrimi i serave në fshatin Kosmaç	12
Fig. 7: Koncepti i Vizionit Hapësinor	28
Fig. 8: Vizioni Strategjik i Zhvillimit	29
Fig. 9: Koncepti i korridorit lumor	32
Fig. 10: Rruga industriale nga kryqëzimi i Bushati drejt kufirit me Shkodrën	83
Fig. 11: Korridor i gjelbër	83
Fig. 12: Pista për biçikleta	83
Fig. 13: Shembull pasaporte (njësia VD-UB-162) draft	90
Fig. 14: Pamje nga faqja WebGis	91
Fig. 15: Foto gjatë organizmit të ekspozitës së PPV	92

Lista e tabelave

Tabela 1: Njësitë administrative, zonat urbane dhe qendrat e banuara	4
Tabela 2: Sipërfaqet e njësive administrative	5
Tabela 3: Të dhënat e tokës bujqësore sipas njësive administrative	12
Tabela 4: Planifikimi për vitin 2018-2020 sipas programeve buxhetore (lekë)	23
Tabela 5: Planifikimi i buxhetit sipas klasifikimit ekonomik (lekë)	23
Tabela 6: Të ardhurat e bashkisë dhe transferta e pakushtëzuar 2018-2020 (lekë)	24
Tabela 7: Të ardhurat nga burimet qendrore (lekë)	24
Tabela 8: Objektivat dhe ndërhyrjet strategjike	32
Tabela 9: Projekte strategjike prioritare	36
Tabela 10: Projektet pilot	37
Tabela 11: Plani i veprimit, Projektet e zhvillimi	60
Tabela 12: Projekte të PPV-së të parashikuara në PBA	69
Tabela 13: Ndikimi i PPV në 5 sistemet bazë territoriale	77
Tabela 14: Projektioni i popullsisë sipas njësive administrative	81

Shkurtime

AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
PPKT	Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit
PPV	Plani i Përgjithshëm Vendor
PDV	Plan i Detajuar Vendor
VSM	Vlerësim Strategjik Mjedisor
PBA	Projekt Buxheti Afat-Mesëm
PIK	Plani i Investimeve Kapitale
IMK	Instituti i Monumenteve të Kulturës

1 HYRJE

Ky raport paraqet një përmbledhje sintetike të raporteve të përgatitura për Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV) të Bashkisë Vau-Dejës. Në kapitujt vijues janë listuar gjetjet kryesore të secilit prej raporteve që janë pjesë integrale e PPV-së.

Raporti i Analizës Territoriale, që përkon edhe me fazën e parë të hartimit të PPV-së, fokusohet në evidentimin e potencialeve aktuale zhvillimore, por njëkohësiht nxjerr në pah dhe çështjet problematike kontekstuale për të konkluduar në rekomandimet që do të shërbejnë më tej për orientimin e strategjik të zhvillimit të bashkisë.

Raporti i Strategjisë Territoriale përshkruan vizionin strategjik hapësinor, projektet prioritare strategjike dhe analizën e tyre financiare, bazuar në treguesit e planeve kombëtare dhe në analizën territoriale.

Plani i Zhvillimit të Territorit dhe Rregullorja Lokale përmbajnë nënndarjen e territorit dhe metodologjinë e përdorur për identifikimin dhe trajtimin e çështjeve kryesore që plani i mbështetë për të arritur qëllimet e tij.

Në këtë raport të përmbledhur janë përfshirë dhe elementë të Vlerësimit Strategjik Mjedisor të hartuar paralelisht me raportet e sipërpërmendura.

Ekspertët e Grupit të Punës

Nëntor, 2017

2 ANALIZA TERRITORIALE

2.1 Direktivat e planeve ekzistuese kombëtare, sektoriale, standardeve dhe normave

Pas shqyrtimit të hollësishëm të dokumenteve kryesore të planifikimit në të gjitha nivelet si dhe pas vlerësimit të përmbajtjes së tyre në raport me legjislacionin dhe termat e referencës, janë evidentuar direktivat dhe propozimet që prekin drejtpërdrejtë zhvillimin e territorit të Bashkisë Vau-Dejës, të cilat kanë ndikuar në hartimin e vizionit dhe strategjisë së zhvillimit. Në mënyrë të përmbledhur, këto aspekte evidentohen në vijim.

2.1.1 Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit (PPKT)

Në qendër të vëmendjes së këtij plani, është zhvillimi ekonomik e social, menaxhimi i burimeve natyrore, mbrojtja e mjedisit dhe përdorimi racional i tokës në nivel kombëtar. Bazuar në këtë instrument, Vau-Dejës bën pjesë në polin e zhvillimit rajonal Shkodër-Lezhë që është edhe porta perëndimore lidhëse e rajonit malor verior me pjesën tjetër të vendit. Vau-Dejës bën pjesë në qendrat lokale të këtij rajoni dhe ka një karakter që lidhet kryesisht me zhvillimin e bujqësisë dhe turizmit.

Një direktivë shumë e rëndësishme e Planit Kombëtar të Përgjithshëm që ndikon në profilin e zhvillimit të Bashkisë Vau-Dejës ka të bëjë me Parkun Kombëtar të Alpeve Shqiptare. Fakti i pozicionimit gjeografik pranë këtij parku e transformon Vau-Dejës në një nga nyjet turistike më interesante të rajonit verior të vendit që mund të ofrojë një shumëllojshmëri të itinerareve turistike unike (lundrim, energji, peizazh, agroturizëm, turizëm alpin, sportiv, etj).




Fig. 1: Poli i zhvillimit rajonal Shkodër – Lezhë

Itinerari turistik vozitës lum-liqen, Vau-Dejës – Liqeni i Shkodrës – Pulaj – ishulli i Bojanës, së bashku me rrjetin rekreativ të parashikuar nga PPKT, janë ndër atraksionet kryesore për territorin. Pasurimi i këtij rrjeti lundrimi dhe rekreacioni dhe shtrirja e mëtejshme e tij mbeten detyrë e propozimeve strategjike dhe projekteve të zhvillimit.

Në lidhje me bujqësinë, Plani i Përgjithshëm Kombëtar parashikon zhvillimin e një tregu rajonal për promovimin e ekonomisë lokale.

Sa i përket infrastrukturës së transportit, ky plan imponon nevojën për rivitalizimin e transportit hekurudhor brenda territorit. Në këtë kuptim, propozohet reabilitimi i stacionit të trenit në Mjedë dhe kushtet fizike të hekurudhës.

Gjithashtu në territorin e bashkisë parashikohet të kalojë edhe tubacioni i gazit IAP që lidh vendin tonë me Malin e Zi. Në territor parashikohet të kalojnë edhe elementë të tjerë të infrastrukturës energjetike me rëndësi kombëtare dhe linja të ndërlidhjes me Republikën e Kosovës. Njëkohësisht, PPKT nxit krijimin e parqeve energjetike dhe shfrytëzimin e energjive të rinovueshme (fotovoltaike, eolike etj.).

2.1.2 Dokumentet e tjera të planifikimit

Në vijim paraqitet një ekstrakt i direktivave kryesore që burojnë nga dokumentet e ndryshme të planifikimit që kanë lidhje me territorin e bashkisë.

Sipas planit rajonal Shkodër-Lezhë (EPTISA), Vau-Dejës është pjesë e rajonit urban policentrik ndërkufitar, që lidh ekonominë e Lezhës, Shkodrës, Podgoricës, Tivarit dhe Ulqinit. Ky rajon synon zhvillimin dhe forcimin e ekonomisë lokale, krijimin e një territori të integruar, zhvillimin e potencialeve turistike dhe ruajtjen e zonave rurale. Kjo zonë do të shërbejë edhe për ndërlidhjen e Kosovës dhe Malit të Zi dhe do të bëjë pjesë në një itinerar turistik, ku Vau-Dejës përshkohet kryesisht në zonën fushore, me potencial zhvillimin e agroturizmit.

Sipas masterplanit të zhvillimit të turizmit në zonën e Alpeve, territori i Bashkisë Vau-Dejës preket nga zona bërthamë e planit në njësitë administrative Shllak dhe Temal. Gjithashtu, në zonën mbështetëse bëjnë pjesë edhe njësitë e tjera administrative të bashkisë. Ky masterplan e shndërron Vau-Dejës në portën jugperëndimore të njërit prej rajoneve turistike me potencial më të lartë zhvillimi në rang kombëtar. Si i tillë, mbetet detyrë e strategjisë territoriale që të propozojë zhvillimin e infrastrukturës së aksesit në territor si dhe shfrytëzimin e sipërfaqes së lundrueshme, duke krijuar një ofertë ndërlidhëse dhe turistike sa më atraktive.

Sipas dokumenteve të planifikimit të hartuara për ish-komunat, përpara miratimit të reformës administrative-territoriale, vihen re një seri direktivash mbi zhvillimin ekonomik. Ndër më kryesoret përmenden: bujqësia, blegtoria, bletaria, gjuetia, artizanati etj. Gjithashtu për qendrat urbane synohet promovimi i zonave funksionale mikse dhe përmirësimi i mobilitetit. Një prioritet tjetër i gjetur në këto dokumente ka të bëjë me bashkëpunimin ndër-rajonal midis zonës dhe fqinjëve përtej kufirit. Arsimi, trajnimi dhe ndërtimi i kapaciteteve, turizmi dhe agrobiznesi, shërbimet dhe infrastruktura, mbrojtja nga përmbytjet dhe bashkëveprimi ndër-rajonal mbeten ndër fushat prioritare të identifikuara në këto dokumente.

Me ndryshimin e shkallës territoriale në administrimin e territorit si dhe me krijimin e instrumenteve kombëtare të planifikimit, gjetjet e mësipërme duhet të interpretohen për të qënë efektive në kontekstin e ri dhe për të gjeneruar një strategji zhvillimi të integruar për territorin e bashkisë.

2.2 Vështrim i përgjithshëm mbi territorin

Bashkia Vau-Dejës shtrihet në pjesën veriore të vendit dhe bën pjesë në Qarkun Shkodër. Qendra më e madhe e afërt urbane është qyteti i Shkodrës, vetëm 20 km larg; ndërsa largësia nga Tirana, kryeqyteti i vendit, është 92 km. Bashkia kufizohet në veri dhe në perëndim me Bashkinë Shkodër dhe Tropojë, në lindje me Bashkitë Fushë-Arrëz dhe Pukë, ndërsa në jug me Bashkinë Lezhë. Qendra e bashkisë është qyteti i Vaut të Dejës.



Fig. 2: Njësitë administrative të Bashkisë Vau-Dejës

Tabela 1: Njësitë administrative, zonat urbane dhe qendrat e banuara			
Bashkia	Njësitë administrative	Nr. Zonave urbane	Qytetet dhe Fshatrat
Bashkia Vau-Dejës	Vau-Dejës	(1) Qytet (8) Fshatra	Qytetet: Vau Dejes, Fshatrat: Mjedë, Spathare, Shelqet, Kaç, Naraç, Dush, Karmë, Gomsiqe
	Bushat	(14) Fshatra	Fshatrat: Bushat, Shkjezë, Plezhë, Kosmaç, Stajkë, Ashtë, Rranxa, Fshat i Ri, Mali i Jushit, Plepan-Konaj, Melgush, Barbullush, Kukël, Hoten
	Vig-Mnele	(3) Fshatra	Fshatrat: Mnelë e Madhe, Mnelë e Vogël, Vig
	Hajmel	(5) Fshatra	Fshatrat: Hajmel, Dheu i Lehtë, Pistull, Paçram, Nënshatë
	Temal	(10) Fshatra	Fshatrat: Koman, Qerret, Arrë, Vilë, Telum, Kllogjen, MalagjiKajvall, Toplanë, Sermë, Gushtë
	Shllak	(7) Fshatra	Fshatrat: Vukjakaj-Gegaj, Palaj-Gushaj, Benë, Kroni i Madh, Barcollë, Vukaj, Uk-Bibaj
Total	6 Njësi administrative	48 qendra urbane / rurale	



Fig. 3: Qendrat e banuara (qytete/fshatra) të Bashkisë Vau-Dejës

Tabela 2: Sipërfaqet e njësive administrative							
Nësitë administrative	Bushat	Vig Mjelë	Temal	Shllak	Hajmel	Vau-Dejës	Total
Sipërfaqja (km ²)	95.73	72.89	117.08	70.98	36.67	102.38	495.72

Vau-Dejës përfshin një territor me zhvillim të hershëm që ka kulmuar në periudhën e Mesjetës, duke shfrytëzuar pozitën gjeografike dhe flukset e rrugëve tregtare.

Gjatë shek. XX kontrolli mbi përmbytjet dhe shtrirja e infrastrukturës rrugore, zhvendosi zhvillimin ekonomik dhe urban drejt zonave fushore në perëndim të territorit.



Fig. 4: Hartë veneciane e vitit 1571 e territorit të Vau-Dejës (Dagna)

Bashkia ka një sipërfaqe prej 495 km² dhe përbëhet nga nga 47 fshatra dhe 1 qytet (Vau-Dejës) të organizuara në 6 njësi administrative.




Fig. 5: Pozicioni strategjik në raport me rajonin

Territori i bashkisë është i larmishëm, me një relief kryesisht fushor në pjesën jug-perëndimore dhe malor në pjesën veri-lindore. Maja më e lartë është ajo e Cukalit me lartësinë 1721 m mbi nivelin e detit. Një rëndësi të madhe në këtë territor ka edhe ultësira e Zadrimës, që shquhet për prodhimet bujqësore dhe artizanatin.

Zhvillimi aktual ka karaktere të ndryshme dhe të painteguara në pjesë të ndryshme të territorit. Potencialet bujqësore, turizmi dhe artizanati, janë elementet kryesore të promovimit të zhvillimit dhe karakterit të bashkisë.

Ekonomia paraqitet kryesisht rurale. Bujqësia luan rolin parësor me 65-85% të punësimit. Rol të rëndësishëm luan edhe prania e infrastrukturës energjetike (prania e 4 HEC-eve) që punëson mbi 5% të fuqisë punëtore.

Aktualisht territori më i zhvilluar paraqitet njësi administrative Bushat, e ndjekur nga Vau-Dejësi dhe Hajmeli. Bushati ka karakter kryesisht rural me bujqësi të zhvilluar, ndërsa Vau-Dejës ka rolin e një qendre urbane, historike dhe me zhvillim të infrastrukturës energjetike. Zonat e thella të njësive administrative Shllak, Temal dhe Vig-Mnelë paraqesin prapambetje në zhvillimin urban dhe ekonomik si dhe aksesin në infrastrukturë.

Turizmi është një potencial ende i paeksploruar, por që paraqet alternativa të shumta për zhvillim, sidomos në raport me trashëgiminë kulturore, natyrën, bujqësinë, veprat energjetike, sportin, lundrimin etj. Prapambetja e këtij sektori lidhet me zhvillimin e dobët të infrastrukturës dhe me ofertën më konkurruese të deritanishme të Shkodrës, Shëngjinit dhe Velipojës.

2.2.1 Klima

Në përputhje me rajonizimin klimatik në Republikën e Shqipërisë, zona në të cilën shtrihet territori i Bashkisë Vau-Dejës, është pjesë e zonës klimatike mesdhetare. Tipari kryesor i klimës së përgjithshme për këtë zonë është dimër i butë dhe i lagësht dhe verë e nxehtë dhe e thatë.

Gjetjet

Kushtet klimatike të zonës të marrë në konsideratë, krijojnë disa probleme mjedisore për shkak të variacionit të treguesve klimatikë ndërmjet zonave. Disa nga këto ndikime, si rezultat i vlerave ekstreme të elementeve klimatike, janë:

Reshjet intensive të shiut që shkaktojnë përmbytje, erozion toke, erozion të shpateve të lumit, dëmtim të karakteristikave të dheut, varësi të prodhimeve bujqësore, probleme për sektorin e blegtorisë.

Temperaturat ekstreme dhe dëbora dëmtojnë infrastrukturën rrugore, shkaktojnë erozion të shkëmbinjve për shkak të alterimit nga ndryshimet e temperaturës, vonesa të proceseve bujqësore, kërkesa më të larta për ngrohje, që çon në emetime të rritura të disa gazrave në mjedis.

Rekomandime

Për të përballuar faktorët ekstremë të rrezikut klimatik si përmbytjet, zjarret, erozioni, duhen marrë në konsideratë një seri masash, ndër më kryesoret:

Planifikimin e masave, të tilla si pajisja me efikasitet të plotë i sistemeve të drenazimit për të parandaluar efektet në aktivitetet ekonomike;

Menaxhimi i kontrolluar i shkarkimeve të hidrocentraleve, masa për parandalimin e erozionit etj.

Mirëmbajtja dhe projektimi i rrugëve dhe ndërtesave duke marrë parasysh faktorët klimatikë për të rritur qëndrueshmërinë ndaj këtyre rreziqeve (vendosja e brezave të gjelbërt mbrojtës).

2.2.2 Sizmiciteti

Territori i Bashkisë Vau-Dejës gjendet në një rajon me sizmicitet të lartë, që referohet (tregohet)nga të dyja hartat: a) harta e intensitetit sizmik në Shqipëri (1980) bazuar në shkallën MSC-64, ku intensiteti për këtë zonë varion nga shkalla 8 deri 9; b) drafti i hartës PGA (Peak Ground Accceleration) që tregon se nxitimi sizmik për periudhë rikthimi 475 vjet varion nga 0.22g në 0.4g(Akademia e Shkencave, 2010). Zonat fushore kanë një nxitim (PGA) prej 0.38g dhe zonat malore kanë një nxitim mesatar 0.29g.

Është e rëndësishme të theksohet që brenda territorit të bashkisë ndodhen tre hidrocentrale, për të cilët siguria sizmike dhe inspektimi i përhershëm i digave të tyre janë thelbësore. Nxitimi maksimal i tokës (PGA) në lidhje me gjendjen kufitare të shërbyeshmërisë janë: 0.43g për Vau-Dejës dhe 0.33g për digën Koman. Aktiviteti sizmik i Komanit dhe Vau-Dejës monitorohet nga pajisjet sizmike dhe të gjitha të dhënat transferohen online në Qendrën Kombëtare Sizmiologjike.

Rezultatet e prejardhura nga analiza e gjendjes ekzistuese janë:

- Sizmiciteti në territorin Vau-Dejës është një nga më të lartit në vend;
- Aktiviteti sizmik i digave Koman dhe Vau-Dejës si dhe strukturat e tyre duhet të jenë të monitoruara vazhdimisht.

Drafti i ri i hartës probabilitare PGA (2010) do propozohet për t'u përdorur për punimet e reja të ndërtimit në Bashkinë Vau-Dejës.

2.2.3 Burimet minerare

Bashkia Vau-Dejës është e pasur me burime natyrore. Kërkimet gjeologjike kanë vlerësuar një numër të madh të depozitave të metaleve (bakër, mërkur) dhe jo metale (magnez, argjilë, dolomite etj.). Në pjesën veri-lindore të bashkisë vërehen disa depozita bakri. Janë tri miniera bakri në këtë pjesë të bashkisë, të quajtura Palaj, Karma 1 dhe Karma 2. Këto miniera u zhvilluan nga vitet 1987 në 1996. Sektori Palaj është i shfrytëzuar plotësisht, aktualisht nuk është në përdorim. Ndërkohë që shfrytëzimi i minierës së bakrit Karma 2 vazhdon me leje nr.1555, datë 22.02.2012. Në vitin 1970 miniera e Gomsiqeska vepruar për nxjerrjen e magnezit. Edhe kjo minierë, ashtu si ajo Palaj, është tashmë e mbyllur me VKM, Nr.230, datë 24.05.2002. Një minierë tjetër, aktualisht e mbyllur është ajo e Vig-Mnelës për nxjerrjen e mineralit kaolin. Përveç shfrytëzimit të minierave, Bashkia Vau-Dejës ka pasur disa miniera eksploruese për të kërkuar minerale si mërkur në fshatin Koni i Madh, në njësinë administrative të Shllakut, kërkimin e mineraleve të boksitit në fshatin Cukal, Mali i Bardhë në njësinë administrative të Shllakut.

2.2.4 Burimet natyrore dhe zonat e mbrojtura

Burimet natyrore, flora dhe fauna, marrin një rol udhëheqës në mjedis. Territori i Bashkisë Vau-Dejës është i ndërthurur dhe ofron të gjitha kushtet për zhvillimin e faunës dhe florës, për ruajtjen e të cilave duhet të treguar një kujdes i veçantë. Në këtë territor, bashkohen një shumëllojshmëri e ekosistemeve si ujore, shkurre mesdhetare gjithmonë të gjelbërta dhe gjetherënëse, pyje gjethegjërë dhe të përziera, livadhe dhe kullota.

Në territorin e Bashkisë Vau-Dejës janë disa zona të mbrojtura të kategorisë së tretë "Monumente të Natyrës" dhe kategorisë së pestë "Peizazhe të Mbrojtura".

Në kategoritë e monumenteve natyrore përfshihen këto zona:

Fusha e Liqethit

E vendosur në kreshtën malore të Cukalit, 1200 m mbi nivelin e detit, pranë fshatit Lekgegaj, njësia administrative e Shllakut. Përfaqëson një vrimë glaciale-karstike, e formuar në kryqëzimin tektonik dhe modeluar nga fenomenet karstike. Është 1.3 km e gjatë, e gjërë deri në 1000 m. Ajo ka formën e një ventilatori, me disa forma më të vogla karstike.

Fragment i thyerjes tektonike Shkodër-Pejë

Kjo është një nga thyerjet më të mëdha tektonike në territorin shqiptar, e cila shfaqet nga Shkodra në perëndim, deri në Pejë (Kosovë), në lindje.

Shpella e Malagjisë

E vendosur pranë fshatit Malagji, në pjesën verilindore të malit Cukal; në lartësi 1300 m mbi nivelin e detit. Ajo është 180 metra e gjatë dhe përbëhet nga disa galeri që ndërthuren me hapësira më të gjëra dhe puse të shumta mjaft të thella; kanë liqene të vogla.

Në kategorinë e peizazhit të mbrojtur përmendim:

Peizazhine mbrojtur ujqor dhe tokësor të Lumit Buna - Velipojë

Kjo zonë është shumë e pasur me biodiversitetin. Në grupin e gjitarëve dallojmë llojet e kërcënuara globalisht Lundërza (Lutra Lutra). Zona e mbrojtur ndërkufitare është ndër zonat më të rëndësishme në vendin tonë.

Problemet e hasura në rrjetin e zonave të mbrojtura

Ndër problemet kryesore që kanë lindur në rrjetin e zonave të mbrojtura të Bashkisë Vau-Dejës përmendet mungesa e fondeve për zbatimin e projekteve të reabilitimit dhe mbrojtjes, gjuetia e pakontrolluar, prerja e paligjshme, mungesa e informacionit në lidhje me vlerat e tyre etj.

Propozimet për përfshirje në rrjetin e zonave të mbrojtura:

Bazuar në vlerat e territorit të Bashkisë Vau-Dejës, propozohet që në rrjetin e zonave të mbrojtura të shtohen dy ekosisteme që do të jenë pjesë e kategorisë së Parkut Natyror Rajonal.

Zonat e propozuara janë unaza e liqenit Vau-Dejës dhe zonat perëndimore të njësisë administrative Bushat, në kufirin me Velipojën.

2.2.5 Burimet ujore dhe brigjet

Territori i Bashkisës Vau-Dejës karakterizohet nga burime të konsiderueshme ujore si lumenjtë, liqenet, rezervuarët dhe përrenjtë. Liqeni i Hidrocentralit të Vaut të Dejës përfaqëson sipërfaqen më të madhe ujore. Dy lumenjtë që kalojnë në territor janë: Drini dhe Gjadri.

Gjetjet

Burime të shumta ujore të territoreve, rrisin rëndësinë e menaxhimit të tyre duke marrë parasysh regjimin e çrregullt të ujit në këtë zonë. Për më tepër, rastet e përmbytjeve të viteve të fundit në këtë zonë, kërkojnë vëmendje të shtuar për çështjen e menaxhimit të burimeve ujore.

Rekomandime

- Shpallja e liqenit të Vau-Dejës "Zonë e Mbrojtur", do të ndihmonte në menaxhimin më të mirë të këtij aseti dhe kështu do sillte ruajtjen dhe zhvillimin e këtyre vlerave natyrore;
- Pyllëzimi i kodrës së Zefjanës në Bushat është një mundësi e mirë për ta kthyer atë në një park natyror për perspektivën e zhvillimit të turizmit.

2.2.6 Analiza mjedisore

Gjetjet

Në përgjithësi, ujërat e zeza paraqesin infrastrukturën më kritike publike në bashki. Ky sistem pothuajse nuk ekziston. Aktualisht, ky shërbim përfaqësohet nga vetëm 7.5 km (rrjeti kryesor i Bushatit, nga i cili përfitojnë 1.100 familje).

Shërbimi i grumbullimit të mbeturinave nuk ofrohet në gjithë territorin (Njësia administrative Temal dhe Shllak, të pambuluara me këtë shërbim). Sfida mbetet që mbledhja e mbeturinave të sigurohet në të gjithë territorin e bashkisë, të paktën në qendrat urbane të dy njësive të sipërpërmendura.

Aktualisht, në territorin e Bushatit, ndodhet landfilli i mbeturinave urbane, i cili ka një periudhë shërbimi prej 20 vjetësh. Mundësia e gjenerimit të rreziqeve nga prania e landfillit mund të përmblihet si vijon:

- Ndotje atmosferike;
- Shpërthimet e zjarrit;
- Ndotje e ujërave nëntokësore;
- Përhapja e agjentëve patogjenë.

Rekomandime

- Të përfshihet i gjithë territori i bashkisë në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave;
- Shtrirja e rrjetit të kanalizimit në të gjitha njësitë administrative;
- Kontrollimi i kushteve të veprimit të landfillit në Bushat dhe instalimi i sistemit të monitorimit.

2.2.7 Sistemi bujqësor

Sistemi bujqësor, i shtrirë në 11.107 ha përfaqëson 25% të sipërfaqes së përgjithshme të territorit të Bashkisë Vau-Dejës. Sektori bujqësor, së bashku me blegtorinë, janë sektorët kryesorë ku popullsia është e punësuar (ose e vetëpunësuar). Një vlerësim i bërë kohët e fundit, në varësi të sezonit, rreth 65-85% e popullsisë së bashkisë është e angazhuar në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë, fakt që tregon rëndësinë dhe vëmendjen që duhet të ketë bashkia për të përcaktuar prioritetet që mbështesin këtë sektor.

Objektivi i Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit për sistemin bujqësor është: **Efiçenca për një sektor bujqësor konkurrues përmes:**

- Ruajtjes;
- Konsolidimit;
- Modernizimit

Ngritja e një rrjeti të suksesshëm të zinxhirit ekonomik bujqësor: prodhim - grumbullim - përpunim - marketing, me qëllim rritjen e zinxhirit të vlerës ekonomike.

Bazuar në të dhënat e disponueshme nga studimi i pjellorisë së tokave të kryera në vitet '80, tabela në vijim paraqet të dhënat e tokës bujqësore për secilën njësi administrative:

Tabela 3: Të dhënat e tokës bujqësore sipas njësive administrative										
Njësia Administrative	Sip. e tokës bujqësore (ha)	Shkalla e pjellorisë								
		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX
Vau-Dejës	1165	-	-	7	295	645.8	25.6	91.6	100	-
Bushat	6502	-	-	2345	2733	70	993	361	-	-
Hajmel	2282	-	-	-	1901	381	-	-	-	-
Vig-Mnelë	528	-	-	-	-	-	60	468	-	-
Shllak, Temal	630	-	-	-	-	80	350	200	-	-
Total	11107	-	-	2352	4929	80	410	668	100	-

Pas hyrjes në fuqi të Reformës Territoriale Administrative, bashkitë e reja duhet të menaxhojnë një rrjet të madh të kanaleve të ujitjes dhe kullimit.

- Kanalet primare të menaxhuara nga Bordi Rajonal i Kullimit të Lezhës (gjithësej 177 km);
- Kanalet sekondare dhe terciare nga Bashkia Vau-Dejës (gjithësej 1210 km).

Pavarësisht disa ndërhyrjeve të bëra në vitet e fundit, përsëri situata e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit kërkon shumë investime për t'u bërë plotësisht efektive. Mirëmbajtja e këtij sistemi është baza për zhvillimin e bujqësisë dhe ndaj duhet të jetë një përparësi kryesore në investimet e bashkisë. Prandaj, bashkia duhet të zhvillojë sa më shpejt projekte dhe të caktojë ndërhyrje prioritare për ta përmirësuar sa më shpejt situatën e krijuar.



Fig. 6: Toka bujqësore dhe përqëndrimi i serave në fshatin Kosmaç

Ndër faktorët kryesorë që e përcaktojnë bujqësinë si një sektor kyç për zhvillim janë:

- Fusha e Zadrimesë e njohur për produktivitetin e saj të lartë bujqësor;
- Toka bujqësore në përgjithësi ka përbërje të lartë të humusit dhe kripëra të ndryshme minerale që ndihmojnë në rritjen dhe përmirësimin e prodhimit bujqësor;
- Burime të shumta ujore të zonës;
- Burime të konsiderueshme njerëzore, ndër të cilat numri i lartë i agronomëve;
- Prezenca në Vau-Dejës e Shkollës së Mesme Kombëtare Bujqësore, për të edukuar të rinjtë dhe për të rritur më tej asistencën për fermerët.

Ndër problemet kryesore që vuan nga sektori i bujqësisë dhe blegtorisë janë:

- Mungesa e mirëmbajtjes, pastrimit të sistemit të ujitjes dhe drenazhimit;
- Përmbytjet periodike;
- Erozioni i tokave bujqësore;
- Urbanizimi kaotik, kryesisht pranë akseve të transportit;
- Fragmentizimi i tokës si rezultat i privatizimit të tokës bujqësore;
- Si rezultat i fragmentizimit, përdorimi i teknologjive moderne në kultivim është ipapërbalueshëm nga fermerët;
- Lëvizjet e popullsisë dhe mungesa e angazhimit dhe interesit të brezit të ri;
- Mungesa e strukturave (magazinave dhe frigoriferëve) për mbledhjen, përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore të shpërndara në të gjithë territorin;
- Mungesa e mbështetjes financiare (lehtësimi i kredisë).

2.2.8 Zonat e trashëgimisë kulturore dhe historike

Vau-Dejës përfshin në territorin e saj objekte të trashëgimisë kulturore me status të deklaruar "Monument kulture" si dhe objekte të tjera me vlera pa status.

Shumica e këtyre trashëgimive kulturore, për shkak të rrethanave historike, kanë arritur në gjendjen e sotme si rrënoja.

- Kalaja e Sapës, shek. VII BC, kategoria e parë, vendndodhja Nënshat;
- Kalaja e Vigut, shekulli I, kategoria e parë, vendndodhja Vig;
- Zonat arkeologjike "A" dhe "B" në vendbanimin Koman, shekulli I, kategoria e parë, vendndodhja Koman;
- Varreza e lashtë e Komanit, shekulli VI-IX, kategoria e parë, vendndodhja Koman;
- Kalaja e Dalmacisë, shekulli V / VIII-IX, kategoria e parë, vendndodhja Koman;
- Kalaja e Vau-Dejës, shek. XIV, kategoria e parë, vendndodhja Vau-Dejës;
- Kisha e Shën Marisë, shekulli VIII, kategoria e parë, vendndodhja Vau-Dejës;
- Rrënojat e Kishës së Shën Markut, shekulli VIII-IX, kategoria e parë, vendndodhja Vau-Dejës;
- Kalaja e Shurdhahut (Sardis), shekulli XI, kategoria e parë, vendndodhja Ishulli i Shurdhahut;
- Zona e mbrojtur dhe kompleksi Mjeda Ndre, shek. XX, kategoria e dytë, vendndodhja Kukël.

Ndërhyrjet kryesore të propozuara që duken të nevojshme për t'u ndërmarrë nga bashkia janë:

- Të jetë pjesë e projektit të saj dhe rindërtimit të rrugëve që ofrojnë akses në monumente;
- Ekspeditat e pastrimit të bimësisë përreth monumenteve me grupe të organizuara të nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme dhe hapja e rrugëve rreth ndërtesave të vlefshme si një mundësi për njohjen e vlerave të tyre;
- Vendosja e sinjalistikës së përshtatshme;
- Kërkimi në IMK për implementimin e fondeve për restaurimin dhe konsolidimin e mureve ekzistuese;
- Kërkimi në ASHA për fondeve për ekspedita gjurmimi në zonë;
- Organizimi periodik i ngjarjeve folklorike, aktivitete kulturore dhe sportive për promovimin e këtyre monumenteve dhe mjediseve të tyre rrethuese;
- Organizimi i guidave me turistë të ndryshëm vendas dhe të huaj.

2.2.9 Infrastruktura

2.2.9.1 Mënyrat e transportit

Bashkia Vau-Dejës ka tri mënyra të transportit: transportin rrugor, atë hekurudhor dhe të brendshëm ujor.

Rrjeti rrugor (automjetesh) në Bashkinë Vau-Dejës ka lloje të ndryshme rrugësh. Këtu gjejmë rrugët kryesore të lidhjes, dytësore, lokale etj. Këto rrugë janë të sheshta, kodrinore dhe malore. Ndahen gjithashtu në rrugë të asfaltuara dhe të shtruara. Në përgjithësi, gjendja e tyre teknike është e mirë në shumicën e segmenteve kyçe, por pjesa tjetër ka nevojë për rikonstrukcion. Duke marrë parasysh kushtet e rrugëve në secilën prej njësive administrative, njësia administrative Vau-Dejës dhe Bushat kanë një rrjet të transportit rrugor relativisht në gjendje të mirë. Këto dy njësi gjithashtu kanë një lidhje të mirë me transport rrugor. Në njësinë Hajmel vërehet një gjendje mesatare e sistemit të transportit rrugor. Ka rrugë që lidhin zonat rezidenciale, por jo në të gjitha rastet këto rrugë janë në gjendje të mirë. Në Vig-Mnelë vërehet një sistem i dobët i transportit rrugor. Ekziston një rrugë kryesore që aksesohet pjesërisht nga njësia, por rrjeti i brendshëm rrugor nuk është në gjendje të mirë.

Në gjendje të rënduar është sistemi rrugor në njësinë Shllak. Kjo njësi arrihet vetëm nga Bashkia e Shkodrës me një rrugë në gjendje të keqe. I tillë duket edhe rrjeti i brendshëm i njësisë. Gjithashtu Temali arrihet përmes një rruge të vetme Vau-Dejës – Koman, që duket në gjendje të keqe. Sistemi i brendshëm rrugor është shumë i dobët në këtë njësi.

Hekurudha kombëtare Durrës-Hani Hoti kalon nëpër Bashkinë Vau-Dejës. Kjo linjë kalon nëpër dy njësi, Hajmel dhe Vau-Dejës. Në këto njësi janë dy stacione, respektivisht në Hajmel dhe Mjedë, duke e bërë këtë lloj transporti të dobishëm për ta.

Transporti i brendshëm ujor funksionon kryesisht në këto njësi: Vau-Dejës, Shllak dhe Temal përmes liqeneve artificiale Vau-Dejës dhe Koman. Në liqenin Vau-Dejës (njësitë administrative Vau-Dejës dhe Shllak) vërehet ky lloj transporti, por jo në formë të organizuar përmes vijave të duhura për lëvizjen e banorëve, turistëve apo mallrave, siç shihet në

liqenin e Komanit (njësia administrative Temal). Njësia Shllak përdor këtë mënyrë transporti për lëvizjet e brendshme, por nuk ka linja të rregullta. Ndërsa njësia administrative Temal përdor këtë mënyrë transporti si mënyra e vetme për t'u lidhur me njësitë e tjera ose me bashkitë e tjera, meqë llojet e tjera të lidhjeve mungojnë.

I gjithë sistemi rrugor (automjetesh) nuk ka nevojë vetëm për rikonstruksion, por gjithashtu ka nevojë për pasurimin me segmente të tjera rrugore si në aspektin e ndërlidhjes midis njësive administrative ashtu edhe segmente të tjera të karakterit bujqësor që do të lidhin parcelat bujqësore duke lehtësuar në këtë mënyrë transportin e produkteve bujqësore.

Në aspektin e transportit ujor kërkohet një formalizim i këtij transporti duke përmirësuar kapacitetet e mjeteve dhe infrastrukturën portuale (mol), me linja të rregullta dhe të shpeshta të komunikimit.

2.2.9.2 Sistemi elektrik

Vau Dejës furnizohet me energji elektrike nga nënstacioni 220/110/ 6KV. Shërbimi dhe furnizimi është i vazhdueshëm 24 orë për qytetarët dhe bizneset.

Ky nënstacion furnizohet nga Hidrocentrali Vau-Dejës. Hidrocentrali dhe nënstacioni i tij kanë qenë shpesh me përmirësime të vogla. Nuk janë bërë ndryshime në kapacitetin prodhues dhe transmetimin tek konsumatorët.

Situata aktuale e transmetimit të furnizimit me energji elektrike në zonë po ndryshon. Këtu përfshihet rinovimi i linjës së re të kabllove të rrjetit 20KV në Bushat.

Përsa i përket zonave të tjera, Vig-Mnelë, Hajmel, Temal, Shllak, rrjeti ekzistues i tensionit të mesëm është në të njëjtën situatë si më parë. Rrjeti i furnizimit me energji elektrike për këtë zonë përbëhet nga linja ajrore 6KV, të cilat janë ndërtuar mbi 25 vjet më parë.

Po kështu, problemet e mësipërme kanë anë negative ekonomike, humbjet e energjisë të rrjetit të tyre teknik. Gjendja aktuale e linjës së energjisë elektrike është jashtë çdo rekomandimi sigurie dhe teknik sipas normave të IEC.

Njësoj si rrjeti i tensionit të mesëm duhet të jetë edhe rrjeti i tensionit të ulët. Në këtë pjesë të rrjetit mund të gjejmë një larmishmëri të madhe të produkteve që përbëjnë rrjetin e shpërndarjes, duke filluar nga standardi shqiptar (instalimet para 1990-ës), produktet standarde nga Evropa Lindore dhe produktet e KE.

Prespektiva

Hidrocentrali rezervon hapësirën e nevojshme dhe mundësinë për të rritur produktivitetin dhe kapacitetin prodhues. Rezervat specifike bazohen në kapacitetin e përpunimit të rezervave hidrologjike dhe në mundësinë e përmirësimit të hidrogjeneratorëve ekzistues.

Përsa i përket perspektivave për ndërtimin e hidrocentraleve të reja, sipas studimeve të divizionit të prodhimit KESH, mes hidrocentraleve Ashta 1 dhe 2 nuk është e mundur për arsye teknike. Shtimi i HEC-eve të tjera do të ndërhyjë në regjimin e punës Ashta 1 dhe 2, për shkak të devijimit dhe kushtëzimit të kapacitetit hidrik.

Rekomandime

Përmirësimi i nënstacionit të Shkodrës në linjën sekondare nga 6-10kV në 20kV jep mundësinë që e gjithë zona e Vau-Dejës të furnizohet nga ky NS me linjën e re të energjisë

20kV. E njëjta situatë mund të arrihet nga NS Vau-Dejës, por më parë, është e nevojshme që të përmirësohet tensioni i pjesës dytësore nga 6KV në 20KV.

Investimet duhet të jenë në të njëjtin nivel si për prodhimin, ashtu edhe për transmetimin.

Së fundi, si rezultat i sa më sipër, është urgjent përmirësimi i pjesës më të madhe të kabinave elektrike për shkak të mungesës së kapacitetit dhe amortizimit.

2.3 Përdorimi i tokës dhe 5 Sistemet

Sipas legjislacionit në fuqi, për qëllime planifikimi, territori i bashkisë klasifikohet në 5 sisteme bazë (urban, infrastrukturë, bujqësi, ujqor dhe natyrë). Në Bashkinë Vau Dejës sistemi natyror përbën pjesën kryesore të territorit duke u shtrirë në rreth 66% të tij. Ai ndiqet nga sistemi bujqësor me 23.6%. Sistemi urban dhe ai ujqor janë në peshë thuhet të barabartë me përkatësisht 6.1% dhe 4.4%. Këto raporte përcaktojnë dhe karakterin e territorit të lidhur fort me natyrën dhe bujqësinë, me sipërfaqe ujore të shumta e me zhvillim urban relativisht të ulët. Në vijim do të paraqiten të përmbledhura karakteristikat aktuale dhe orientimet e zhvillimit të përcaktuara nga PPK për çdo sistem.

2.3.1 Sistemi Urban

PPK ka në qendër të vëmendjes hierarkizimin e qendrave urbane, profilizimin e tyre, zhvillimin ekonomik në përputhje me potencialet ekzistuese si dhe rajonalizimin. Ndërhyrjet në këtë sistem duhet të kenë karakter konsolidues, rigjenerues dhe fuqizues për qendrat urbane. Zhvillimi policentrik, frenimi i ekspansionit, promovimi i densifikimit, aksesit në infrastrukturën multimodale, funksionet mikse dhe komplementare, menaxhimi i ekosistemit, ruajtja dhe rivlerësimi i burimeve natyrore dhe trashëgimisë janë disa nga orientimet e përgjithshme për sistemin urban.

Konkretisht për qytetin Vau-Dejës si qendër terciare, PPK nxit krijimin dhe zhvillimin e funksioneve bazë si: ekonomi, banim, tregti me pakicë, kulturë dhe rekreacion, administrim, arsim, shëndetësi, kujdes social. Qendrat e tjera të bashkisë konsiderohen lokalitete dhe kanë kryesisht zhvillim me karakter rural.

Qendrat rurale janë zhvilluar kryesisht sipas aksesit në bujqësi. Ato ndodhen kryesisht në zonën fushore ku toka është pjellore dhe lidhja me infrastrukturën më e lehtë. Karakteristikë për 20 vitet e fundit është zhvillimi urban përgjatë akseve rrugore. Gjithashtu informaliteti dhe përhapja e ndërtimeve në toka bujqësore janë fenomene mjaft të përhapura.

Qendrat e banuara përbëhen nga 47 fshatra dhe 1 qytet (Vau-Dejës) që administrohen nga 6 njësi (Bushat, Vau-Dejës, Hajmel, Temal, Shllak, Vig-Mnelë). Më të zhvilluarat paraqiten qendrat e banuara në Bushat dhe Vau-Dejës ku ndodhet edhe përqëndrimi më i madh i popullsisë. Gjithashtu edhe Hajmeli paraqet një territor me potenciale të mira zhvillimi. Njësitë e tjera administrative kanë popullsi dhe zhvillim urban më të ulët, fakt ky që lidhet me terrenin malor dhe mungesën e infrastrukturës.

Shërbimet publike janë kryesisht të pranishme në gjithë territorin, paçka se shpeshherë në kushte të papërshtatshme dhe shpërndarje johomogjene. Në fshatrat e thella vihet re një mungesë e aksesit në shërbimet arsimore. Gjithashtu në territor janë të pranishme aktivitete ekonomike dhe industriale që lidhen kryesisht me bujqësinë, produktet

ushqimore dhe prodhimin. Këto biznese janë kryesisht në trajtën e bizneseve të vegjël apo familjare dhe paraqesin një potencial zhvillimi në të ardhmen.

Lidhja me infrastrukturën është një ndër elementët që ka modeluar karakteristikat urbane të zonave dhe që ka promovuar zhvillimin. Bashkia është e lidhur mirë me infrastrukturën kombëtare, por paraqet problematika në shtrirjen në zonat e thella të rrjeteve të infrastrukturës. Aksesin në disa fshatra bëhet nëpërmjet transportit të alternuar rrugë-ujë.

2.3.2 Sistemi Natyror

PPK stimulon politika për rritjen e zonave të mbrojtura dhe atyre natyrore si dhe promovimin e aksesit në to. Këto politika duhet të nxisin zhvillimin e qëndrueshëm dhe duhet të bazohen në mirëadministrim. Rritja e rolit të mjedisit në cilësinë e jetës urbane dhe në zhvillimin ekonomik janë disa nga aspektet ku duhet të fokusohet PPV. Udhëzimet që burojnë nga PPK lidhen me: frenimin e zgjerimit të zonave urbane, pyllëzimin e tokave bujqësore të pafrytshme, mbrojtjen e peizazhit, promovimin dhe aksesin në zonat natyrore për rritjen e cilësisë së jetës urbane, përdorimin e aseteve natyrore për sport, turizëm mjedisor dhe prodhimin e energjive të rinovueshme.

Gjithashtu rekomandohet kthimi në atraksione mjedisore i luginave të lumenjve ku padyshim lugina e Drinit ka potenciale mjaft të larta, krijimi i rrjetit kombëtar të biçikletave, si dhe rikuperimi dhe rigjenerimi i zonave të degraduara. Aktualisht janë tre monumente të natyrës dhe një peizazh i mbrojtur brenda territorit të bashkisë (Lumi Buna-Velipojë)

Aktualisht bashkia ka tre monumente natyre dhe një peizazh të mbrojtur (Lumi Buna-Velipojë). Sistemi natyror paraqet një seri elementësh natyrorë dhe peizazhistikë të jashtëzakonshëm, që duhen rivlerësuar për statusin e tyre. Këtu duhet veçuar lugina e Drinit dhe liqenet artificiale të Vau-Dejës dhe Komanit si ndër zonat peizazhistike më interesante në rang vendi për zhvillimin e turizmit. Shtimi i zonave të mbrojtura është një ndër objektivat primarë për sistemin natyror, por edhe për PPV në tërësi.

2.3.3 Sistemi Bujqësor

PPK parashikon zhvillimin e një sektor eficient dhe konkures bujqësor. Objektivat kryesore që burojnë nga ky plan janë ruajtja e tokës bujqësore, konsolidimi dhe modernizimi i sektorit. Gjithashtu vlerësohet e rëndësishme vendosja e një zinxhiri ekonomik prodhim-grumbullim-përpunim-tregtim, me qëllim rritjen e prodhimit dhe vlerës së produkteve. Prioritare paraqitet edhe mirëmbajtja dhe zhvillimi i infrastrukturës bujqësore të vaditjes dhe kullimit. Rritja cilësore e bujqësisë duhet kërkuar edhe në ndërthurjen me sektorë të tjerë ku potencial të veçantë paraqet turizmi. Produkti vendas dhe brandimi i tij janë një orientim drejt një tregu të specializuar dhe të qëndrueshëm.

Problemet kryesore të sistemit bujqësor janë të lidhura me problemet e përmbytjeve që veçanërisht vitet e fundit kanë shkaktuar shumë dëmtime. Investimet e munguara dhe kushtet e këqija fizike të infrastrukturës ekzistuese janë shkaqet kryesore të përmbytjeve. Nevojitet gjithashtu një model i decentralizuar për menaxhimin e territoreve që kanë probleme të diferencuara.

Zhvillimin kryesor bujqësia e ka në territorin e Bushatit, Vau-Dejës dhe Hajmelit, njësi këto që favorizohen nga terreni fushor dhe burimet e bollshme hidrike. Territori që përkon me fushat e Zadrimes përgjithësisht është mjaft pjellor dhe favorizon kultivimin e një game të

gjërë kulturash. Brenda territorit ka filluar edhe specializimi i zonave në kultivimin e kulturave të caktuara, duke evoluar njohjen dhe teknologjinë bujqësore si dhe duke rritur rendimentin.

2.3.4 Sistemi Ujor

Territori i Vau-Dejës është mjaft i pasur me burime hidrike të cilat janë një potencial i jashtëzakonshëm për zhvillimin e bujqësisë, sektorit energjetik, peshkimit dhe turizmit. Rekomandimet e PPK për këtë sistem fokusohen në: shfrytëzimi racional dhe i kontrolluar i ujërave mbi dhe nëntokësore, eliminimi i ndotjeve, ruajtja e ujëmbledhësve etj. Mbrojtja e vijës ujore, krijimi i koridoreve natyrore përgjatë luginave, ndalimi i shfrytëzimit të inerteve në brigjet e lumenjve, frenimi i depozitimit të mbetjeve urbane dhe shmangja e ndotësve nga industria, janë disa nga veprimet e propozuara për ruajtjen e sistemit ujor.

Territori përshkohet nga rrjedha e Drinit dhe Gjadrit dhe nga liqenet artificiale të fashës energjetike Vau-Dejës-Koman-Fierzë. Me gjithë burimet e shumta ujore, sfidë mbetet disiplinimi i tyre për shmangien e përmytjeve.

Shpallja zonë e mbrojtur e një pjese të territorit përgjatë vijës ujore të liqenit të Vau-Dejës, do të ndihmonte në ruajtjen dhe menaxhimin jo vetëm të sistemit ujor por edhe të peizazhit dhe ekosistemit, duke krijuar mundësi për zhvillimin e një turizmi të lidhur fort me natyrën, ujin dhe bujqësinë. Gjithashtu, ndërthurja e sistemit ujor me atë të infrastrukturës së transportit dhe prodhimit të energjisë e kthen këtë sistem në një ndër pikat parësore të perspektivës së zhvillimit me interes jo vetëm lokal, por edhe rajonal e kombëtar.

2.3.5 Sistemi i Infrastrukturës

Objektivi i PPKT lidhet me rritjen e aksesueshmërisë dhe shpërndarjen e balancuar të flukseve. Krijimi i koridoreve të integruara të flukseve të infrastrukturës dhe hierarkizimi i qendrave urbane janë politikat që propozohen për këtë sistem. Zhvillimi i transportit multimodal dhe miqësor ndaj mjedisit është një tjetër objektivi drejtpërdrejt i lidhur edhe me karakterin e veçantë të territorit në Bashkinë Vau-Dejës.

Transporti rrugor bazohet në një rrjet mbi 300 km të gjatë të rrugëve të kategorive të ndryshme. Gjendja e tyre është relativisht e mirë në njësinë administrative Bushat dhe në një pjesë të territorit fushor të bashkisë. Në zonat e thella dhe territorin malor, cilësia e tyre lë mjaft për të dëshiruar dhe shpeshherë aksesimi është thuajse i pamundur me mjete të zakonshme. Një rëndësi të veçantë do të kishte reabilitimi i rrugës Vau-Dejës – Koman që do të nxiste fluksin turistik për shfrytëzimin e aksit ujor Koman-Fierzë, si një ofertë e integruar turistike me parkun e Valbonës.

Transporti ujor mbetet një nga potencialet më interesante të zhvillimit të ekonomisë dhe turizmit, sidomos për njësitë administrative Vau-Dejës, Temal e Shllak. Sot lundrimi është një shërbim spontan e i paadministruar, por me një kërkesë në rritje dhe me potencial të lartë zhvillimi. Transporti Koman-Fierzë është e vetmja formë e rregulluar transporti me një regjim të programuar. Vendosja e transportit publik ujor mendohet të jetë një katalizator për rritjen e interesit mbi zonën dhe për nxitjen e sipërmarrjes. Itineraret ujore Ishulli i Bojanës – Liqeni i Shkodrës – Vau i Dejës – Koman – Fierzë mund të ofrojnë një sistem ekonomik dhe turistik të lidhur drejtpërdrejtë me mobilitetin.

Reabilitimi i rrjetit hekurudhor do të ndihmonte në ndërlidhjen dhe zhvillimin e territorit të njësive Vau-Dejës dhe Hajmel që përshkohen nga aksi kombëtar. Gjithashtu reabilitimi i stacioneve do të ishte një shans i mirë për rijetëzimin e fshatrave Mjedë dhe Hajmel.

Vau-Dejës është një ndër zonat me rëndësi të veçantë përse i përket infrastrukturës energjetike, pasi në të ndodhen HEC Ashta1, Ashta2, Vau-Dejës dhe Koman. Pikërisht këto vepra energjetike janë edhe një burim mjaft i rëndësishëm për punësimin dhe mund të shndërrohen edhe në atraksione për ofertën turistike të rajonit.

Përse i përket rrjeteve të infrastrukturës mbetet e domosdoshme të investohet në rrjetin e kanalizimeve, përmirësimin e shtrirjes dhe cilësisë në rrjetin e ujësjellësit si dhe në kontrollin dhe minimizimin e impaktit ambientale të landfillit të Bushatit.

2.4 Popullsia, lëvizjet demografike dhe strehimi (stoku i banesave)

Popullsia e bashkisë paraqitet me dy të dhëna kontradiktore dhe me diferencë të konsiderueshme mes tyre. Sipas të dhënave të Censurit 2011, popullsia është 30.438 banorë, ndërsa në regjistrin e gjendjes civile në vitin 2015 rezultojnë 49.399 banorë. Dendësia e popullsisë, referuar këtyre shifrave, varion nga 65-105.6 banorë/km². Kjo mospërputhje shifrash vjen kryesisht nga fenomeni i emigrimit të popullsisë në vendet e huaja apo në rajone më të zhvilluara brenda vendit, por pa u çregjistruar nga vendbanimi i tyre fillestar. Popullsia është përqëndruar kryesisht në Bushat dhe Vau-Dejës (73%), duke bërë që katër njësitë e tjera administrative të kenë një numër mjaft të ulët banorësh.

Duke filluar nga vitet '90, popullsia ka patur rënie të vazhdueshme me tendencë ngadalësimi në vitet e fundit. Ky fakt dëshmon se territori po shkon drejt konsolidimit dhe balancave të qëndrueshme ekonomike. Pritshmëria është që vitet në vijim të kemi një ruajtje të numrit të popullsisë dhe balancim mes ardhjeve dhe largimeve.

Në hartimin e projeksioneve të popullsisë u zhvillua një analizë e hollësishme e të dhënave të disponueshme (shih raportin e zgjëruar) dhe u vlerësuan skenarët e mundshëm që lidhen me zhvillimin ekonomik të bashkisë dhe rajonit. Në rastin e një rritjeje ekonomike në vitet e ardhshme, popullsia e bashkisë ka prirjen të mbetet konstante ose të pësojë një rritje të lehtë. Në rast regresi të ekonomisë, do të përballemi me fenomenin e tkurrjes së popullsisë përmes zhvendosjes, që ka shoqëruar territorin për mbi 25 vite.

Sipas një skenari pozitiv për 15 vitet e ardhshme, projeksioni i popullsisë me një rritje mesatare prej 0.15% në vit mendohet real, i qëndrueshëm dhe pjesë e një modeli të besueshëm. Sipas këtij parashikimi, popullsia e bashkisë në vitin 2030 do të jetë mes 31.200 dhe 50.500 banorëve, me një mesatare të pranueshme prej 41.000 banorësh.

Referuar në të dhënat e INSTAT, popullsia në masën 97.1% strehohet në banesa njëfamiljare. Sipërfaqja e banimit për banor rezulton rreth 14.4 m²/banor dhe është dukshëm nën standardet e pritshme (mbi 25 m²/banor). Numri i dhomave për banor është 0.8.

23.4% e banesave janë të pabanuara për shkak të braktisjes, amortizimit apo përdorimit të përkohshëm.

34.9% e banesave janë ndërtuar përpara vitit 1991. Këto ndërtesa përgjithësisht shfaqin trajta amortizimi apo degradimi. Pjesa tjetër e ndërtimeve (65.1% të ndërtuara në

periudhën 1991-2011) kanë shfrytëzuar kryesisht territorin bujqësor, duke shkaktuar një dëm të ndjeshëm të ekonomisë dhe peizazhit rural.

Një problem real për strehimin, janë banesat në kapanonet e HEC Vau-Dejës, në veri të qytetit, ku janë shpërngulur një numër i konsiderueshëm familjesh nga zonat që u përmbytën nga liqeni i hidrocentralit dhe ku kushtet e jetesës janë mjaft problematike. Mbulesat e këtyre kapanoneve janë prej eterniti, material me përbërje amianti, i klasifikuar si mjaft i dëmshëm për shëndetin.

Analiza e nevojave për strehim bazohet në të dhënat mbi banesat, kushtet e tyre fizike, moshën e ndërtesave, projeksionin e popullsisë, standardet kombëtare dhe ndërkombëtare etj. Sipas supozimeve analitike të kryera, mbështetur në projeksionin e popullsisë, rezulton se deri në vitin 2030, për të normalizuar kushtet dhe situatën e banimit, do të duhet ndërtimi i 2300 – 3000 banesave të reja. Gjithashtu, gjatë periudhës së planifikuar, rreth 10% e stokut aktual të banesave do të amortizohen krejtësisht, ndërsa 20% do të kenë nevojë për rinovim.

2.5 Aspektet ekonomike dhe sociale

Konteksti ekonomik i bashkisë përfaqësohet nga një ekonomi e përzier e drejtuar në disa sektorë të tillë si bujqësia, pylltaria, shërbimet dhe industria e energjisë. Megjithatë, ekonomia lokale dominohet nga bujqësia dhe është një ekonomi tipike rurale. Në sektorin e bujqësisë janë të përfshirë 65-85% të të punësuarve, ndërsa sektori i energjisë punëson rreth 5% të fuqisë punëtore. Këta sektorë aktualisht përfaqësojnë burimin kryesor të të ardhurave. Përveç këtyre sektorëve, është e rëndësishme të përmendet turizmi si një potencial.

Përsa i përket bujqësisë dhe bagëtisë, shfaqet një zhvillim i mundshëm i në rajonin e Zadrimës ku njësia administrative e Bushatit kryeson për shkak të vendndodhjes gjeografike të saj. Ajo luan rolin e lokomotivës ekonomike në Bashkinë Vau-Dejës dhe shfrytëzimi i saj hapësinor është zhvilluar në nivele të konsiderueshme. Siç e shohim në hartat shoqëruese të raportit, pothuajse të gjitha hapësirat e sheshta përdoren për bujqësinë edhe pse ndarja e tepruar e bën të pamundur të fitosh nga ekonomitë e shkallës. Megjithatë, shfrytëzimi i hapësirës nuk është i lidhur me shfrytëzimin ekonomik për shkak të mungesës në aspektin e strukturave mbështetëse për të bërë ekonominë e kësaj zone të mjaftueshme për të konkurruar me rajonet e tjera ku bujqësia është sektori më i zhvilluar. Ndërhyrjet në infrastrukturë janë shumë të rëndësishme dhe do të rrisnin ndjeshëm produktivitetin bujqësor si dhe shfrytëzimin e tij ekonomik duke ndihmuar në krijimin e një marke të prodhimeve bujqësore ku përdorimi i eksportit në vendet fqinje do të rriste nivelin ekonomik në terma afatgjatë. Aktualisht njësia administrative e Bushatit eksporton jashtë vendit rreth 15% të produkteve bujqësore, ndërsa ajo e Hajmelit rreth 10%. Krijimi i kushteve më të mira të prodhimit dhe infrastrukturave organizative do të rriste ndjeshëm konkurrencën në tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

Terreni malor në njësitë administrative Temal dhe Shllak janë një burim tjetër për zhvillimin e blegtorisë, pasi përdorimi i terrenit për kullota është një nga mundësitë më të rëndësishme për zhvillimin e zonës. Aktualisht përdorimi për këtë qëllim është në nivele mesatare dhe potenciali ende nuk është shfrytëzuar. Rreth 25% e tokës është shfrytëzuar për shkak se një hapësirë e konsiderueshme tokësore është e zhveshur. Zhvendosja e

sektorit ka hasur pengesa të mëdha nga mungesa e një politike subvencionale ekonomike, informacionit dhe vetëdijes, por edhe në mungesën e infrastrukturës rrugore që e bën të pamundur përdorimin e të gjithë prodhueseve potencialë të zhvillimit që ka qenë më i ngadaltë se në shumë zonat të tjera të tipit të ngjashëm. Ekziston edhe mungesa e një marke të produkteve lokale edhe pse për të njëjtën sasi absolute të prodhimit rajonet e tjera kanë arritur ta krijojnë atë duke përdorur njohuritë dhe tregjet dinamike brenda dhe jashtë vendit. Prodhimi aktual blegtoral është i destinuar kryesisht për nevojat e brendshme të Bashkisë Vau-Dejës dhe një pjesë minimale shkon në tregje të tjera jashtë vendit. Karakteristikat fizike të produkteve blegtorale dhe mungesa e strukturave profesionale të prodhimit, përpunimi dhe rrjeti i transportit e vështirësojnë eksportin. Kjo përbën një kufizim të tanishëm por një sfidë për të ardhmen afatshkurtër për të arritur krijimin e një infrastrukture ekonomike për të informuar, promovuar, subvencionuar dhe mbështetur operatorët lokalë, për të forcuar në aspektin e mjeteve dhe njohurive, për të përfituar nga potenciali i konsiderueshëm i bagëtisë në cilësi dhe terma sasiorë.

Sektori i energjisë, pavarësisht nga burimet e të pasura natyrore kryesisht në njësinë administrative të Vau-Dejës, ende nuk është në nivelet e pritura. Sektori sërish duhet të bëhet i dobishëm për shkak të faktit se pjesa e më e madhe të ardhurave nga hidrocentralet shkon për nivelin e qeverisjes qendrore dhe në nivele të ulëta për njësitë vendore, kjoedhe për shkak të mungesës së një planifikimi dhe zbatimi konkret të projekteve të mbetura në letër për arsye financiare dhe burokratike.

Një sektor i rëndësishëm i Bashkisë Vau-Dejës është edhe turizmi. Shfrytëzimi aktual i burimeve natyrore për qëllime turistike është në nivele minimale për arsye të ndryshme. Një nga arsyet është ruajtja e mjedisit të pacënuar nga ndërhyrjet spontane të çorganizuar, qëllimi i të cilëve është një përfitim ekonomik afatshkurtër. Një arsye tjetër e rëndësishme është mungesa e njohurive dhe përvojës. Themelimi i zonave të mbrojtura është një nga hapat e ndërmarrë për të arritur ndalimin e forcave shkatërruese nga një iniciativë ekonomike e padisiplinuar individuale. Themelimi i zonave të mbrojtura, megjithatë nuk e zvogëlon shfrytëzimin e burimeve potenciale për qëllime turistike, por e rrit atë në aspektin kohor. Aktualisht, të ardhurat nga turizmi janë në nivele minimale pasi ky sektor është në periudhën e fillimit në këtë fushë. Numri i ndërmarrjeve të regjistruara që operojnë në këtë sektor është afërsisht 5% e totalit të bashkisë. I njëjti raport reflektohet edhe në aspektin e të ardhurave.

Peizazhet panoramike të tilla si kodrat dhe malet me një bukuri unike natyrore, shëtitje me varkë në liqen ose plazhet në liqenin e fshatrave të vendosura në kodrat e bukura dhe në zonën e butë, ushqimet organike lokale dhe gatimet tradicionale e kthejnë Vau-Dejën në një zonë të përshtatshme për destinacionin e agroturizmit. Sfida kryesore është krijimi i emrit të markës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe arritja e krijimit të një lloji turizmi që është një alternativë e rëndësishme ndaj asaj bregdetare.

Të ardhurat dhe shpenzimet lokale

Edhe pse në vitet e fundit po rriten ngadalë, të ardhurat lokale janë pothuajse të mjaftueshme për kostot operative dhe mirëmbajtjen. Ato përbëhen në pjesën më të madhe nga grantet e fituara nga financat e qeverisë qendrore dhe një përqindje të ulët (rreth 25%) të taksave vendore. Përsa i përket shpenzimeve, ato përbëjnë rreth 80% të shpenzimeve kapitale dhe 20% të atyre të mirëmbajtjes. Mungesa e investimeve të rëndësishme

strukturore e bën të pamundur përfitimin nga injektimi i një burimi financiar me ndikime pozitive afatmesme në ekonominë lokale. Situata bëhet më e vështirë për shkak të përdorimit joefikas të burimeve të pakta financiare të disponueshme dhe nivelit të lartë të informalitetit. Treguesi i performancës së ulët të ekonomisë është numri i madh i familjeve që marrin asistencë sociale, rreth 50% në tri njësi administrative të Shllakut, Temalit dhe Vig-Mnelës (60.8 % e fondit).

Hartimi i projekt-buxhetit për vitet 2018-2020, është bërë nga Bashkia Vau-Dejës bazuar në ligjin Nr.139/2015, ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, udhëzimin nr.23 datë 22.11.2016 “ *Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*”.

Sipas kërkesave të përcaktuara në Udhëzimin Plotësues 10/1 datë 28.2.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”, buxheti i Bashkisë Vau-Dejës është planifikuar:

Për vitin 2018	1,914,762,000 lekë, ndër të cilat 154,565,000 lekë (8%) nga të ardhurat e veta, 206,698,000lekë (11%) transfertë e pakushtëzuar, 74,957,000 lekë (4%) transfertë specifike dhe 1,478,542,000 lekë (77%) transfertë e kushtëzuar.
Për vitin 2019	2,287,689,000 lekë, ndër të cilat 163,175,000 lekë (7%) nga të ardhurat e veta, 217,860,000 lekë (10%) transfertë e pakushtëzuar, 740,957,000 lekë (3%) transfertë specifike dhe 1,831,697,000 lekë (80%) transfertë e kushtëzuar.
Për vitin 2020	1,940,660,000 lekë, ndër të cilat 174,115,000 lekë (9%) nga të ardhurat e veta, 240,300,000lekë (12%) transfertë e pakushtëzuar, 80,278,000lekë (4%) transfertë specifike dhe 1,445,967,000 lekë (75%) transfertë e kushtëzuar.

Disa tregues të rëndësishëm për buxhetin

- Të ardhurat nga taksat për vitin 2018-2020 zënë mesatarisht 40.6% të totalit të të ardhurave nga burimet e veta vendore.
- Të ardhurat nga tarifatat vendore për vitin 2018-2020 zënë mesatarisht 38.3% të totalit të të ardhurave nga burimet e veta vendore.
- Të ardhurat nga burime të tjera në vitin 2018-2020 zënë mesatarisht 21% të totalit të të ardhurave nga burimet e veta vendore.
- Totali i shpenzimeve kapitale për vitin 2018 është planifikuar 1,374,750,000 lekë dhe zë 67% të totalit të shpenzimeve, për vitin 2019 është planifikuar 1,364,109,000 lekë dhe zë 66% të totalit të shpenzimeve dhe në vitin 2020 është planifikuar 1,335,737,000 lekë dhe zë 65% të totalit të shpenzimeve.

Tabela 4: Planifikimi për vitin 2018-2020 sipas programeve buxhetore (lekë)

PROGRAMI	TOTALI I SHPENZIMEVE		
	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Planifikim Manaxhim Administrim	160,298,000	167,197,000	184,377,000
Planifikimi urban	39,850,000	24,400,000	18,150,000
Infrastruktura rrugore	821,082,000	781,089,000	397,993,000
Programi i Shërbimeve Publike	56,429,000	64,701,000	69,007,000
Mjedisi dhe mbrojtja e Pyjeve e kullotave	91,458,000	67,458,000	82,159,000
Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit	100,100,000	100,050,000	79,250,000
Bujqësia dhe zhvillimi rural	57,947,000	44,268,000	46,608,000
Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi	11,108,000	11,108,000	11,896,000
Arsimi dhe kultura	348,370,000	286,493,000	643,404,000
Shërbimet sociale	355,427,000	507,230,000	504,622,000
Fond rezerve	3,193,000	3,194,000	3,194,000
TOTALI	2,045,262,000	2,057,188,000	2,040,660,000

Tabela 5: Planifikimi i buxhetit sipas klasifikimit ekonomik (lekë)

VITI	PAGA + SIGURIME	SHPENZIME OPERATIVE	TRANSFERTA	INVESTIME	TOTALI
Viti 2018	255,141,000	131,578,000	283,793,000	1,374,750,000	2,045,262,000
Viti 2019	251,020,000	146,865,000	295,194,000	1,364,109,000	2,057,188,000
Viti 2020	265,566,000	144,163,000	295,194,000	1,335,737,000	2,040,660,000

Sipas nenit 34 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pika 3 dhe 4, njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifatat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga qeverisja qendrore dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt atyre nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacione, si dhe burime të tjera të parashikuara në ligj. Njësitë vendore u garantohet me ligj e drejta për krijimin e të ardhurave në mënyrë të pavarur.

Tëardhurat e përgjithshme të Bashkisë Vau-Dejës, nga gjithë burimet e financimit parashikohen të jenë: për vitin 2018 në shumën 1,914,762,000 lekë, për vitin 2019 në shumën 2,287,689,000 lekë dhe për vitin 2020 në shumën 1,940,660,000 lekë.

Këto të ardhura, sipas ligjit të mësipërm, vijnë nga dy burime të ardhurash si më poshtë:

- A. **Nga burimet e veta vendore**, ku përfshihen të ardhurat tatimore (nga taksat vendore), jo tatimore (nga tarifat për shërbimet publike që ofrojnë dhe të ardhurat e tjera vendore), donacione.
- B. **Nga burimet qendrore**, ku përfshihet transferta e pakushtëzuar, transferta specifike për funksionet e reja, të cilat i janë transferuar bashkisë dhe transferta e kushtëzuar.

Bashkia Vau-Dejës, për vitet 2018-2020, duke përfshirë transfertën e pakushtëzuar, të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, të ardhura të tjera, parashikon për vitin 2018 rreth 361,263,000 lekë të ardhura të veta, për vitin 2019 rreth 381,035,000 lekë dhe në vitin 2020 rreth 414,415,000 lekë.

Tabela e mëposhtme paraqet të ardhurat e vetë bashkisë Vau-Dejës dhe transfertën e pakushtëzuar për vitet 2018-2020, për të cilat është autoriteti i përdorimit sipas prioriteteve që përcaktohen në PPV.

Tabela 6: Të ardhurat e bashkisë dhe transferta e pakushtëzuar 2018-2020 (lekë)				
NR.	TË ARDHURAT	PLAN 2018	PLAN 2019	PLAN 2020
A	Të ardhurat e veta			
1	Nga burimet e veta vendore	154 565,000	163 175,000	174 115,000
2	Të ardhurat tatimore/taksat	63 765,000	66 000,000	69 295,000
3	Të ardhurat nga tarifat	60 100,000	62 570,000	66 500,000
4	Të ardhura të tjera	30 700,000	34 605,000	38 230,000
B	Nga burimet qendrore			
1	Transferta e pakushtëzuar	206 698,000	217 860,000	240 300,000
	TOTALI	361 263,000	381 035,000	414 415,000

Të ardhurat nga burimet qendrore përfshijnë të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar, transferta specifike, transferta e kushtëzuar.

Tabela 7: Të ardhurat nga burimet qendrore (lekë)			
BURIMET E FINANCIMIT	VITI 2018	VITI 2019	VITI 2020
Transferta e pakushtëzuar	206,698,000	217,860,000	240,300,000
Transferta specifike	74,957,000	74,957,000	80,278,000
Transferta e kushtëzuar	1,478,542,000	1,831,697,000	1,445,967,000
TOTALI	1,760,197,000	2,124,514,000	1,766,545,000

Përmbledhje

Vështirësitë aktuale ekonomike Bashkinë Vau-Dejës si në pjesën më të madhe të zonave përreth janë të prekshme dhe të thella. Kjo nuk duhet të dekurajojë iniciativat individuale dhe politikat e investimit pasi potenciali i burimeve njerëzore dhe natyrore nuk mungon. Një planifikim afatgjatë, bazuar në sektorët e bujqësisë/fermave, energjisë dhe turizmit, së bashku me mbështetjen e fortë të vendosur në logjistikë dhe vullnetin për të arritur, do të

krijonte një themel të fortë në ekonominë lokale dhe në konkurrencën e operatorëve ekonomikë në nivel lokal dhe rajonal duke rritur mirëqënien ekonomike dhe sociale.

2.6 Arsimi dhe shëndetësia

2.6.1 Arsimi

Përsa i përket shërbimeve themelore siç janë arsimi, shëndetësia dhe aktivitetet sociale, aktivitetet kulturore, lëvizja e popullsisë për t'i aksesuar ato është e orientuar drejt dy qendrave kryesore të bashkisë: Vau-Dejës dhe Bushat. Vau-Dejës ka dy shkolla të mesme, ndërsa Bushati ka tri, duke përfshirë një shkollë të mesme profesionale. Të rinjtë nga Temali, Shllaku dhe Vig-Mnelë udhëtojnë në këto shkolla për shkak të mungesës së shkollave të mesme në këto njësi.

Përsa i përket shkollave të mesme, ato nuk paraqesin problem në lidhje me shpërndarjen e tyre në territor, por në lidhje me infrastrukturën fizike, e cila në disa raste vlerësohet si një ndërhyrje emergjente. Përmirësimi i infrastrukturës fizike në shkolla dhe kopshte, ku prioritet është ngrohja, transporti i nxënësve nga zonat e largëta dhe lirimi i hapësirave publike në oborret e shkollave, të cilat mbeten çështjet më kritike për t'u adresuar.

2.6.2 Shëndetësia

Shërbimi spitalor në Bashkinë Vau-Dejës mbulohet nga Spitali Rajonal i Shkodrës, sepse në bashki nuk ekziston një strukturë e tillë. Problemi kryesor për mbulimin e këtij shërbimi mbeten njësitë Temal dhe Shllak. Problemet e emergjencës kryesisht trajtohen në qendrat shëndetësore dhe në disa raste nga mjekët privatë që janë në zonë. Në Bashkinë Vau-Dejës shërbimi shëndetësor ofrohet nga 30 qendra shëndetësore dhe ambulanca të shpërndara në njësitë administrative. Zgjërimi i këtij shërbimi nuk është uniform, i përqëndruar kryesisht në njësitë Bushat dhe Vau-Dejës dhe situata më problematike shfaqet në njësinë Vig Mnelë ku nuk ka funksion të tillë si qendra e kujdesit shëndetësor.

Mbulimi me shërbim shëndetësor në njësinë Bushat është në gjëndje më të mirë. Aktualisht, shëndetësia sigurohet përmes 10 qendrave shëndetësore në fshatrat Bushat, Rranxa, Melgushë, Stajkë, Kosmaç, Barbullush, Mali i Jushit, Shkjezë, Ashtë dhe Hoten. Numri i përgjithshëm i mjekëve që shërbejnë në këto qendra është 8 dhe infermierë janë 38, kështu që ky shërbim i kujdesit mjekësor mundëson një mjek për 2977 banorë. Ky standard është 3.4 herë më i ulët se standardi kombëtar. Përsa i përket këtij sektori, në bashki nuk ka një bazë të dhënash të mirëfillta dhe gjetjet kryesore janë bërë duke u bazuar në komunikimin me banorët dhe stafin e qendrave shëndetësore. Ndër dobësitë e qendrave të shërbimit shëndetësor të cilat kërkojnë vëmendje dhe investime serioze, theksojmë:

- Përshtatja e qendrave për pacientët me aftësi të kufizuara;
- Reabilitimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit (telefon, kompjuter dhe sisteme të internetit);
- Rritja e numrit të mjekëve dhe infermierëve që shërbejnë në këto qendra;
- Sigurimi i ambulancave për të mbuluar shërbimin në territor;
- Rritja e orëve të shërbimit në qendrat shëndetësore;
- Krijimi i një baze elektronike të të dhënave që do të përmirësojë shërbimin dhe do të sigurojë një komunikim të qëndrueshëm ndërmjet pacientëve dhe stafit mjekësor;

- Sigurimi, në qendrat kryesore të kujdesit shëndetësor, pajisjet e lindjes për të ndërhyrë në rast emergjence ose gjatë transportit të grave shtatzëna nga zonat rurale në spitalin më të afërt;
- Përsa i përket përmirësimit të këtyre sistemeve, investimi duhet të jetë jo vetëm në kuadrin e mbështetjes teknike, por edhe investim për trajnimin e duhur të stafit mjekësor dhe infermierëve.

2.7 Aspektet sociale

Duke pasur parasysh burimet e të ardhurave familjare, Bashkia Vau-Dejës karakterizohet nga një përqindje e lartë e ndihmës sociale dhe remitancave. Indeksi për këtë tregues është 20.8% për asistencën sociale dhe 8.9% për dërgesat.

Në skemën e asistencës sociale trajtohen rreth 1559 familje, nga 13.656 familje që ka kjo bashki. Ky numër i familjeve përfaqëson 11% të totalit të ekonomive familjare. Njësia Vig-Mnelë ka përqindjen më të lartë të popullsisë të përfshirë në këtë skemë, 61% e familjeve. Madje njësitë malore, Temal dhe Shllak, kanë përqindje të lartë të familjeve të përfshira në skemën e ndihmës sociale.

Megjithëse nga treguesit duket se bashkia ka një fuqi punëtore të moshës së re, në të vërtetë papunësia përbën një nga problemet kryesore të popullsisë lokale. Shkalla e papunësisë për bashkinë duket shumë më e lartë se papunësia mesatare në vendin tonë.

Papunësia e lartë shpjegohet gjithashtu me numrin e ulët të bizneseve.

2.8 Përgatitja e bazës së të dhënave të sistemit të informacionit gjeografik (GIS).

Një sistem informacioni gjeografik (GIS) është një sistem i dizajnuar për të kapur, ruajtur, përpunuar, analizuar, menaxhuar dhe paraqitur të dhëna hapësinore ose gjeografike. Baza e të dhënave GIS që do të ndërtohet për PPV do të japë informacione gjeohapësinore për: gjendjen ekzistuese të territorit; rrjetin e infrastrukturës; zonat e mbrojtura dhe pjesët e territorit ku zbatohet ligji specifik etj. Burimet për informacionin e përdorur për krijimin e të dhënave të GIS janë AKPT (Agjensia Kombëtare e Planifikimit të Territorit) dhe <http://planifikimi.gov.al/> dhe ASIG (Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapsinor) <http://geoportal.asig.gov.al> informacioni i të cilit është i pranueshëm si të dhëna raster nga serverët WMS dhe WMTS. Informacioni i marrë pastaj përpunohet në zyrë për korigjime (psh toka e përdorur nga projekti CORINE), krijimi (psh lumenjtë, liqenet), azhurnimi (psh rrugët), shtimi i informacionit nga terreni (psh numri i kateve për ndërtesa), dixhitalizimi (psh harta gjeologjike). Të gjitha të dhënat ruhen në mënyrë që mbulesa e informacionit të shapfile të mbizotërojë (konfirmojë) me njëri-tjetrin. Të dhënat e përditësuara parashikohen në EPSG: WGS84 utm 34N dhe kontrollohen për gabime si mbivendosje, duke pasur mangësi, në kundërshtim me të dhënat e tjera. Më pas, formati GIS është përgatitur në përputhje me VKM Nr. 671, dt. 29.07.2015 dhe është dorëzuar në formatin ESRI (shapfile) dhe Geography Markup Language (GML). Të gjithë skedarët kanë skedarin përkatës të metadatave që jep informacion të detajuar për të gjitha të dhënat në skedar. Kjo do t'u shërbejë përdoruesve me të gjithë informacionin e nevojshëm si mënyra se si janë marrë të dhënat dhe për çfarë qëllimi duhet të përdoret.

3 STRATEGJIA TERRITORIALE

3.1 Vizioni strategjik

3.1.1 Vizioni në shkallë të ndryshme

Strategjia Territoriale është pjesa më e rëndësishme e PPV, pasi në këtë dokument parashikohen të gjitha aspektet "zhvillimore" të bashkisë për 10-15 vitet e ardhshme. Duhet patur parasysh që Strategjia Territoriale bazohet në fakte dhe informacione që vijnë nga analiza dhe vlerësimi i territorit të bashkisë (hartuar në fazën e parë). Si rrjedhim, koherenca dhe qëndrueshmëria e propozimeve strategjike janë në një farë mënyrë të lidhura direkt me cilësinë e vlerësimit dhe sasinë e të dhënave të vëna në dispozicion për t'u analizuar.

Në mënyrë që PPV të jetë një instrument efikas për zhvillimin e territorit, ai duhet (i) të qartësojë synimet ekonomiko-sociale të komunitetit në nivel strategjik; (ii) të evidentojë veprimet strategjike që mund të realizohen në një kohë të shkurtër me anë të resurseve të disponueshme; (iii) të përcaktojë objektiva konkrete dhe afatet kohore të tyre;

Transformimi i PPV në një instrument zhvillimi, nënkupton shpjegimin e atyre ideve që mund t'i shtojnë planit mundësi të reja zhvillimi konkrete dhe të menjëhershme.

Në përputhje me një vizion të përbashkët në shkallë territoriale, PPV-ja duhet të marrë përsipër detyrën e parashikimit të "mundësive taktike" që bëjnë realitet zgjedhjet strategjike. Pra duhen parashikuar të gjithë elementët domethënës, që kanë aftësinë ta transformojnë në një projekt të zbatueshëm, që të mund të garantojë realizueshmërinë e strategjive të evidentuara në shkallë territoriale, si edhe sigurinë e shpejtësinë procedurale për realizimin e këtyre parashikimeve të bëra.

Një PPV mund të kthehet në projekt zhvillimi pavarësisht nga shkalla e aplikimit. Përcaktimi i një konfigurimi të dëshiruar hapësinor dhe evidentimi i bashkësive të veprimeve që duhen vënë në funksion për arritjen e tij është një operacion që mund të bëhet në çfarëdo shkalle, për të rindërtuar një qytet, por edhe për të realizuar një sistem objektesh të vogla me karakter shërbimi të shpërndara në territor ose një rrjet të organizuar për menaxhimin e një fluksi mallrash apo njerëzish.

Politikat e zhvillimit ekonomik janë akoma shumë të shkëputura nga politikat e qeverisjes së transformimeve të hapësirës territoriale dhe urbane. Ndërsa lidhja funksionale mes projektimit të hapësirës së urbanizuar dhe strategjive të zhvillimit të kontekstit është e fortë dhe e ndërsjellët. Zgjedhjet hapësinore, në shkallë territoriale dhe urbane, mund të kenë ndikim mbi dinamikat ekonomike kontekstuale, ashtu si zgjedhjet strategjike të sistemit mund të përftojnë mundësi të reja zhvillimi.

Veprimi i bashkërenduar i planifikimit të territorit dhe i projektimit të hapësirave urbane duhet të përcaktojë kushtet e kontekstit që favorizojnë tërheqjen e investimeve, të cilat nuk janë më të lidhura vetëm me shërbimet ndaj prodhimit (zonat ekonomike – industriale), por edhe me shërbimet e integruara me njeriun (sisteme urbane).

3.1.2 Koncepti i zhvillimit territorial

Planifikimi urban me karakter strategjik bazohet shpesh në përdorimin e një koncepti territorial në fazën e tij fillestare. Koncepti territorial është një ideogramë që qëndron në bazë të procesit të hartimit të vizionit, me qëllimin e dyfishtë të:

- Qartësimi për palët, në procesin e planifikimit, se cilat janë zgjedhjet strategjike të vëna në themel të programit të zhvillimit;
- Nisjes së një ballafaqimi të mundshëm me bashkëbiseduesit dhe grupet e interesit duke u nisur nga një ide sintetike për organizimin e hapësirës territoriale.

Për rastin në fjalë, territori i Bashkisë Vau-Dejës, mund të interpretohet si i përbërë nga dy zona homogjene të dallueshme qartë: zona fushore, e karakterizuar nga aktivitet bujqësor me vendbanime urbane të përhapura dhe tjetra malore, e karakterizuar nga një përdorim i ulët njerëzor i territorit.

Zona fushore përshkohet nga infrastruktura kryesore me karakter kombëtar (rruga Tiranë-Shkodër dhe hekurudha) dhe akomodon qendrat kryesore urbane (Vau-Dejës, Bushat, Hajmel, Barbullush). Zona malore mbizotërohet nga prania e liqeneve artificiale dhe infrastrukturat e hidrocentraleve.




Fig. 7: Koncepti i Vizionit Hapësinor

Nga pikëpamja e potencialit të zhvillimit të territorit (resurset e pranishme dhe ndjeshmëria e sistemit lokal) është e padiskutueshme se zona fushore është e prirur për riorganizimin e aktivitetit bujqësor dhe ajo malore për zhvillimin e turizmit mjedisor. Por, në rastin e parë zhvillimi i bujqësisë duhet të krijojë një marrëdhënie të dyanshme dhe sinergjike me fuqizimin e qendrave urbane. Në rastin e dytë, zhvillimi turistik duhet të gjejë forma bashkëjetese inovative me shfrytëzimin energjetik të resurseve ujore. Pra, mundemi të sintetizojmë si vijon konceptin territorial që do të shërbejë si bazë e vizionit strategjik të PPV-së.

Në zonën fushore:

- Riorganizimi dhe zhvillimi i aktivitetit bujqësor, nëpërmjet vlerësimit të resursit terren dhe implementimit të resursit punë;
- Përforcimi i qendrave urbane, që kanë intensitet në aktivitetin urban, por që mund të transformohen edhe në pole për ofrimin e shërbimeve për territorin përreth;
- Marrëdhënie sinergjike ndërmjet sistemit infrastrukturor dhe aktivitetit prodhues, si bujqësor ashtu edhe turistik.

Në zonën malore:

- Krijimi i një koridori lumor plurimodal dhe multi funksional, si rrugë lidhëse me Parkun e Alpeve, me qëllime turistike si dhe lidhjeje territoriale të komuniteteve lokale.
- Mbrojtja e mjedisit dhe peizazhit përgjatë sistemit lumor për të lidhur zonën e mbrojtur të Valbonës (në pjesën e sipërme) me zonën e mbrojtur të Velipojës;
- Rigjallërimi dhe specializimi i rolit funksional të vendbanimeve të pranishme përgjatë koridorit lumor dhe integrimi i resurseve të ndryshme të disponueshme (natyrore, kulturore, historike, arkeologjike, etj.).




Fig. 8: Vizioni Strategjik i Zhvillimit

Ky koncept i thjeshtë strategjik, përveç identifikimit të sistemit të organizimit të hapësirave dhe funksioneve territoriale, lejon që realiteteve të ndryshme urbane që përbëjnë Bashkinë e Vau-Dejës, t'u përcaktohen role specifike në brendësi të vizionit të zhvillimit:

- Qendra territoriale dhe rilindje urbane në njësitë admin. Vau-Dejës, Bushat, Hajmel;
- Qendra lokale me veçori turistike në njësitë admin. Vig-Mnelë, Shllak dhe Temal.

Transformimi i konceptit territorial në vizionin strategjik është hapi i radhës i cili, mbi bazën analizave dhe udhëzimeve nga komuniteti lokal, do të çojë në përcaktimin e hollësishëm të programit të zhvillimit nga pikëpamja e “objektivave” “programeve” dhe “projekteve”.

3.1.3 Objektivat dhe ndërhyrjet strategjike

Procesi i planifikimit të PPV-së aktuale vepron nëpërmjet identifikimit të “objektivave” strategjike, që shtjellohen në “programe” dhe “projekte”. Objektivat strategjike janë ato që përbëjnë dhe përcaktojnë vizionin e zhvillimit, në bazë të rakordimit mes potencialit të identifikuar nga tregu dhe mundësive të vërteta që paraqet territori. Vizioni i zhvillimit të Vau-Dejës përbëhet nga “objektivat strategjike” vijuese:

1 PAJISJA ME SHËRBIMET BAZË

Përfshin ato veprime të nevojshme për të pajisur territorin me kushtet minimale të strukturimit dhe funksionimit për të ndërmarrë rrugën e zhvillimit. Bëhet fjalë për veprime që kryhen për të garantuar infrastrukturën bazë, shërbimet sociale thelbësore, sigurinë dhe gjallërinë.

2 LËVIZJA ME MËNYRA TË NDRYSHME

Përmban veprime të nevojshme në përmirësimin e lëvizjes, edhe nëpërmjet formave të përshtatshme të integritimit të modaliteteve të ndryshme.

3 QENDRAT URBANE

Synon të ndjekë objektivin për të realizuar në territor pole urbane, të afta për të ofruar funksionet komplekse të sistemit urban. Duke qenë përballë një situatë në të cilën zhvillimi i vendbanimeve ka ndjekur trende spontane dhe jo të udhëhequra, ky objektivi kërkon të krijojë një hierarki funksionale të qendrave të banuara, i konsideruar si kusht thelbësor që struktura urbane të kryejë një funksion aktiv në mbështetje të zhvillimit të komunitetit lokal.

4 TURIZMI

Paraqet elemente të zhvillimit socio-ekonomik bazuar në mundësinë e përdorimit për qëllime turistike të burimeve të rinovueshme në territor. Bëhet fjalë për veprime që ndërmerren për t'i dhënë vlera potencialeve natyrore dhe kulturore që ekzistojnë në territor.

5 BUJQËSIA, BLEGTORIA DHE KULTIVIMI I PESHKUT

Ka tendencë të zhvillojë potencialin e lidhur me prodhimin primar, të lidhur pikërisht me aktivitetin bujqësor, blegtoral dhe me kultivimin e peshkut.

6 ENERGJIA

Bëhet fjalë për veprime të ndërmarra për të zhvilluar prodhimin e energjisë nga burime të rinovueshme, edhe nëpërmjet diferencimit të cikleve të saj prodhuese.

Me poshtë janë paraqitur 6 objektivat strategjike të cilat ndahen në 16 programe strategjike.

Tabela 8: Objektivat dhe ndërhyrjet strategjike

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE	NDËRHJRJET STRATEGJIKE
1. Pajisja me shërbimet bazë	1.1 Përmirësimi i rrjeteve teknike
	1.2 Ruajtja e peizazhit dhe siguria e territorit
	1.3 Shërbimet publike
2. Lëvizja me mënyra të ndryshme	2.1 Rrugët automobilistike
	2.2 Korridori lumor
	2.3 Ndërhyrje të tjera për lëvizjen
3. Qendrat urbane	3.1 Pole shërbimesh për territorin përreth
	3.2 Zhvillimi i qendrave lokale
	3.3 Rikualifikimi urban
4. Turizmi	4.1 Turizmi mjedisor
	4.2 Turizmi kulturor
	4.3 Ndërhyrje të tjera për zhvillimin e turizmit
5. Bujqësia, blegtoria dhe kultivimi i peshkut	5.1 Strukturat e shërbimit
	5.2 Rritja e prodhimitarisë
6. Energjia	6.1 Zhvillimi i prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme
	6.2 Diferencimi i prodhimit të energjisë

Lista e objektiveve dhe ndërhyrjeve strategjike të identifikuara konsiderohen si të përshtatshme për përcaktimin e vizionit të zhvillimit i cili mund të udhëzojë komunitetin lokal në rrugën e rritjes ekonomike të bazuar në efektin përshkallëzues të projekteve individuale.




Fig. 9: Koncepti i korridorit lumor

3.2 Projektet dhe programet e zhvillimit

3.2.1 Projektet e ndërhyrjes

- 1 PAJISJA ME SHËRBIMET BAZË
 - 1.1 Përmirësimi i rrjeteve teknike:
 - 1.1.1 *Përmirësimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale;*
 - 1.1.2 *Mirëmbajtja dhe zhvillimi i rrjetit të furnizimit me ujë;*
 - 1.1.3 *Përmirësimi dhe zhvillimi i sistemit të kanalizimeve;*
 - 1.1.4 *Sistemi i pastrimit të ujërave të zeza me gropa septike në zonat periferike.*
 - 1.2 Ruajtja e peizazhit dhe siguria e territorit:
 - 1.2.1 *Sistemi për mbledhjen e mbetjeve të ngurta urbane;*
 - 1.2.2 *Sistemi i pastrimit të rrugëve të qytetit;*
 - 1.2.3 *Realizimi i veprave për mbrojtjen e qendrave të banuara nga përmytjet.*
 - 1.3 Shërbimet publike:
 - 1.3.1 *Shërbimet bazë (kopshte, shkolla fillore, qendrat shëndetësore bazë, kujdesi për të moshuarit);*
 - 1.3.2 *Shërbimi i autobusëve shkollorë;*
 - 1.3.3 *Përmirësimi i shërbimeve administrative të ofruara;*
 - 1.3.4 *Qyteti mik i fëmijëve.*
- 2 LËVIZJA ME MËNYRA TË NDRYSHME
 - 2.1 Rrugët automobilistike:
 - 2.1.1 *Përmirësim i rrugës Shkodër – Pukë – Kukës;*
 - 2.1.2 *Përmirësimi i rrugës përgjatë rrëzës së maleve;*
 - 2.1.3 *Përmirësimi i rrugës Vau-Dejës – Bushat-Velipojë – Shëngjin;*
 - 2.1.4 *Përmirësim i rrugës Vau-Dejës-Koman;*
 - 2.1.5 *Përmirësim i rrugës Vau-Dejës-Vig;*
 - 2.1.6 *Përmirësim i rrugës Koman-Uk Bibaj;*
 - 2.1.7 *Ndërtimi i rrugës Hajmel-Nënshatë.*
 - 2.2 Koridori lumor:
 - 2.2.1 *Realizimi i linjës së transportit uhor Vau-Dejës – Koman;*
 - 2.2.2 *Lidhja rrugore e stacioneve të tragetit me fshatrat;*
 - 2.2.3 *Kalimi i lumit me zgjidhje të ndryshme në pika të ndryshme.*
 - 2.3 Ndërhyrje të tjera për lëvizjen:
 - 2.3.1 *Stacion shkëmbimi intermodal në Vau-Dejës dhe Mjedë;*
 - 2.3.2 *Përmirësim i dy stacioneve hekurudhore në Mjedë dhe Hajmel;*
 - 2.3.3 *Sistemi i transportit publik Vau-Dejës, Bushat, Barbullush, Hajmel;*
 - 2.3.4 *Realizim i pistave të biçikletave.*
- 3 QENDRAT URBANE
 - 3.1 Pole shërbimesh për territorin përreth:
 - 3.1.1 *Pol për shërbime turistike, ekonomike, kulturore, shoqërore shëndetësore dhe teknike (Vau-Dejës/Mjedë);*
 - 3.1.2 *Pol për shërbime të ndihmës teknike, logjistike dhe organizative për bujqësinë (Bushat/Rranxë).*
 - 3.2 Zhvillimi i qendrave urbane lokale:
 - 3.2.1 *Zhvillim i qendrës urbane Vau-Dejës;*
 - 3.2.2 *Zhvillim i qendrës urbane Mjedë;*

- 3.2.3 *Zhvillim i qendrës urbane Bushat;*
- 3.2.4 *Zhvillim i qendrës urbane Rranxë;*
- 3.2.5 *Zhvillim i qendrës urbane Barbullush;*
- 3.2.6 *Zhvillim i qendrës urbane Koman;*
- 3.2.7 *Zhvillim i qendrës urbane Hajmel;*
- 3.2.8 *Zhvillim i qendrës urbane Nënshatë;*
- 3.2.9 *Zhvillim i qendrës urbane Ashtë;*
- 3.2.10 *Zhvillim i qendrës urbane Kosmaç;*
- 3.2.11 *Zhvillim i qendrës urbane Vig;*
- 3.2.12 *Zhvillim i qendrës urbane Benë.*
- 3.3 Rikualifikimi urban:
 - 3.3.1 *Rikualifikim i qendrës urbane Vau-Dejës.*
- 4 TURIZMI
 - 4.1 Turizmi mjedisor:
 - 4.1.1 *Park lumor rajonal: krijimi i një koridori të mbrojtur mjedisor mes zonave të mbrojtura të Alpeve dhe Bunës/Velipojës për realizimin e një itinerari turistik*
 - 4.1.2 *Lidhje funksionale me Alpet e Shqipërisë (Parku Kombëtar i Valbonës);*
 - 4.1.3 *Zhvillimi i plazheve dhe rekreacionit përgjatë liqenit;*
 - 4.1.4 *Realizimi i një koridori të gjelbërt në lumin Gjadër;*
 - 4.1.5 *Zhvillimi dhe promovim i vlerave turistike të Fushës së Liqethit.*
 - 4.2 Turizmi kulturor:
 - 4.2.1 *Realizim i një itinerari për turizmin kulturor Sapë – Danjë – Sardë – Koman;*
 - 4.2.2 *Promovim i vlerave arkeologjike të Komanit;*
 - 4.2.3 *Realizim i një itinerari për turizmin energjetik;*
 - 4.2.4 *Projekt për rehabilitimin dhe ruajtjen e ndërtesave tradicionale (kullat) dhe ansambleve urbane (fshati i ri);*
 - 4.2.5 *Projekt ndriçimi skenografik i kështjellës Sardë dhe digave të Vau-Dejës dhe Komanit;*
 - 4.2.6 *Krijimi i një tregu artizanal dhe etnografik për rajonin e Zadrimës, në Vau-Dejës.*
 - 4.3 Ndërhyrje të tjera për zhvillimin e turizmit:
 - 4.3.1 *Realizim qendrash për agro - turizëm dhe turizëm eno – gastronomike;*
 - 4.3.2 *Projekt për pyllëzimin mjedisor të kodrës së Zefjanës;*
 - 4.3.3 *Projekt përçertifikimin dhe brandimin e prodhimeve lokale me markën e zonës (p.sh. ‘Zadrima’).*
- 5 BUJQËSIA, BLEGTORIA DHE KULTIVIMI I PESHKUT
 - 5.1 Strukturat e shërbimit:
 - 5.1.1 *Realizimi i tri qendrave agro-ushqimore për grumbullimin dheevadimin e prodhimit bujqësor në Bushat, Hajmel e Mjedë (projekt pilot);*
 - 5.1.2 *Zona tregtare me prodhime me km zero;*
 - 5.1.3 *Përmirësim dhe zhvillim i rritjes të kanaleve ujitëse dhe kulluese;*
 - 5.1.4 *Organizimi i degës për qëllimin e prodhimit bujqësor dhe blegtoral pranë bashkisë;*
 - 5.1.5 *Nxitja e shoqërizimit të punës për rritjen e prodhimit bujqësor;*
 - 5.1.6 *Qendër përpunimi, standardizimi dhe magazinimi për gështenjën dhe eterovajoret në Shllak dhe Temal.*

5.2 Rritja e prodhimtarisë:

- 5.2.1 *Zhvillimi i kultivimit të orizit në fshatrat Barbullush, Kukël dhe Dheu i Lehtë;*
- 5.2.2 *Zhvillimi i komplekseve blegtorale në Bushat dhe Vau-Dejës;*
- 5.2.3 *Zhvillimi i peshkimit dhe rezervateve në Vau-Dejës;*
- 5.2.4 *Zhvillimi i serave të kultivimit të perimeve në Kosmaç dhe në fshatra të tjera të bashkisë;*
- 5.2.5 *Zhvillimi i baxhove në Hajmel dhe Vig-Mnelë;*
- 5.2.6 *Zhvillimi i vreshtave në Hajmel, Bushat, Vau-Dejës, Vig –Mnelë;*
- 5.2.7 *Asistencë Part-Time e veçantë teknike me specialistë të profilizuar për dy asete me rëndësi të bashkisë (bujqësi dhe vreshtari);*
- 5.2.8 *Zbatimi i projektit për mbjelljen e 150 ha shege në zona kodrinore, në 6-të fshatra me nga 25 ha në bllok;*
- 5.2.9 *Park bletësh në Shllak dhe Temal.*

6 ENERGJIA

6.1 Zhvillimi i prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme:

- 6.1.1 *Zhvillimi i impianteve për prodhimin e energjisë fotovoltaike;*
- 6.1.2 *Zhvillimi i impianteve për prodhimin e energjisë së biomasës.*

6.2 Diferencimi i prodhimit të energjisë:

- 6.2.1 *Modernizim i landfillit të Bushatit nëpërmjet ndërhyrjeve për ripërdorimin, riciklimin, prodhimin e biogazit dhe pyllëzimin e kurorës;*
- 6.2.2 *Program për nxitjen e realizimit të impianteve për vetëkonsum energjetik.*

3.2.2 Përcaktimi i prioriteteve

Një listë shumë e gjërë e projekteve për zhvillim nuk përfaqëson një zgjedhje strategjike. Nëse një plan propozon të gjitha ndërhyrjet e mundshme që teorikisht përputhen me qëllimet e supozuara pa dhënë një zgjedhje të prioriteteve, nuk mund të konsiderohet si një plan strategjik. “Të bësh strategji” do të thotë të zgjedhësh, dmthtë vendosësh (me vetëdije dhe kolektivisht) se cilat veprime janë më të dobishme në terma të kapacitetit dhe efektshmërisë në arritjen e objektivave. Në rastin tonë objektivat që përbëjnë vizionin strategjik janë gjashtë:

- 1 PAJISJA ME SHËRBIMET BAZË
- 2 LËVIZJA ME MËNYRA të NDRYSHME
- 3 QENDRAT URBANE
- 4 TURIZMI
- 5 BUJQËSIA, BLEGTORIA DHE KULTIVIMI I PESHKUT
- 6 ENERGJIA

Ndër këta, nuk ka dyshim që i pari (“Pajisja me shërbimet bazë”), për vetë natyrën e tij specifike që përfshin të gjitha projektet që kanë si synim arritjen e para-kushteve të cilat janë thelbësore për nisjen e zhvillimin e territorit, është ai më urgjenti dhe më i nevojshmi.


Objektivat që, sipas gjykimit tonë, duhet të konsiderohen prioritare për nisjen e strategjisë së zhvillimit janë, sipas radhës: (i) qendrat urbane (ndërhyrjet për zhvillimin e qyteteve); (ii) bujqësia (ndërhyrje për zhvillimin e aktivitetit produktiv); (iii) turizmi (ndërhyrje për vlerësimin e koridorit lumor).


Me fjalë të tjera jemi të bindur se territori në shqyrtim, përveç një parapërgatitjeje të veçantë për zgjidhjen e mangësive bazike, ka nevojë të themelojë projektin e vet të zhvillimit në një ngritje të fuqishme të aftësive të sistemit urban për të luajtur rolin e “qendrës” për territorin përreth, në kuptimin social (hapësira urbane) dhe ekonomike (pole shërbimi), dhe më pas të synojë zhvillimin e sektorëve të prodhimit bujqësor dhe turizmit.

Sipas kësaj logjike duhen konsideruar “projekte strategjike prioritare” (pra që futen në programin afat shkurtër) ndërhyrjet e mëposhtme, që shfaqin koherencë me objektivat e parashtruara:


Tabela 9: Projekte strategjike prioritare		
QENDRAT URBANE	3.2.1	Zhvillim i qendrës urbane Vau-Dejës
	3.3.1	Rikualifikim i qendrës urbane Vau-Dejës
	3.2.3	Zhvillim i qendrës urbane Bushat
BUJQËSIA	5.1.1	Realizimi i qendrave agro - ushqimore në Bushat për grumbullimin, magazinimin dhe shpërndarjen e prodhimit
	3.1.2	Pol për shërbime të ndihmës teknike, logjistike dhe organizative për bujqësinë
	5.2.8	Zbatimi i projektit për mbjelljen e 150 ha shege në zona kodrinore, në 6-te fshatra me nga 25 ha në bllok.
TURIZMI	2.2.1	Realizimi i linjës së transportit ujor Vau-Dejës – Koman
	2.1.4	Përmirësim i rrugës Vau-Dejës-Koman
	4.2.1	Realizim i itinerarit turistik kulturor Sapë-Danja-Sardë-Koman


Tabela 10: Projektet pilot

Tabela 10: Projektet pilot		
2	OBJEKTIVI	LËVIZJA ME MËNYRA TË NDRYSHME
2.1	PROGRAMI	RRUGËT AUTOMOBILISTIKE
2.1.4	EMËRTIMI I PROJEKTIT	PËRMIRËSIM I RRUGËS VAU-DEJËS-KOMAN (PROJEKT PILOT)
Përshkrimi i projekti		Projekti parashikon përmirësimin e lëvizjes së makinave të rrugës së brendshme që lidh Vau-Dejën me Komanin, nëpërmjet sistemimit të veprave të artit shtesë dhe shtresës sipërfaqësore të rrugës. Do të kryhen punime për përmirësimin dhe zgjerimin e karrexhatës, modernizimin, zëvendësimin dhe/ose realizimin e veprave të artit shtesë (ura, mure mbajtëse, kanale drenazhimi etj.) si dhe zëvendësimi i plotë i shtresës së asfaltit.
Rezultatet e pritshme		Reduktimi i kohës mesatare të udhëtimit në aksin e konsideruar, reduktimi i aksidenteve rrugore dhe i rrezikut, reduktimi i trafikut në rrugët alternative, shtimi i emetimeve të ndotura në tokat bujqësore në të cilat kalon rruga për të cilat duhen marrë masa zbutëse (kanale mbledhëse dhe trajtimi i ujërave të shiut, barriera me pemë dhe bimë); rritja e zhurmave në territoret ku kalon rruga, të cilat duhet të kompensohen me barriera kundër zhurmave.
Interesa publike Interesa private		Reduktimi i kostove sociale të aksidenteve rrugore dhe të ndotjes; reduktimi i kohës dhe kostos së transportit privat.
Vlera e projektit		Rrugë me dy korsi dhe një karrexhatë, gjerësi 9m, gjatësi 33 km: Kosto 7 000 000 euro Modernizimi dhe zëvendësimi i veprave të artit – Për t’u vlerësuar pas studimit të fizibilitetit
Burime të mundshme financimi		Ndihma ndërkombëtare: i) fonde të ardhura nga Programi për Rrugët Dytësore dhe Lokale të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, financuar nga Banka Botërore. ii) fonde nga programi IPA II që, për periudhën 2014-2020, në pikën 4, Transporti, parashikon ndihma për përmirësimin e infrastrukturës dhe lidhjes rajonale.
Projekte të ngjashme		
Prioriteti		Afatshkurtër (Projekt Pilot) Raporti me Axhendën e OKB 2030: Objektivi 9: Ndërtimi i një infrastrukture elastike dhe promovimi i risive dhe një industrializim i barabartë, i përgjegjshëm dhe i qëndrueshëm.



2.1.4 Përmirësimi i rrugës Vau-Dejës - Koman


2	OBJEKTIVI	LËVIZJA ME MËNYRA TË NDRYSHME
2.2	PROGRAMI	KORRIDORI LUMOR
2.2.1	EMËRTIMI I PROJEKTIT	REALIZIMI I LINJËS SË TRANSPORTIT UJOR VAU-DEJËS - KOMAN (PROJEKT PILOT)
Përshkrimi i projektit	<p>Projekti parashikon vendosjen e një linje të re trageti për transportin e njerëzve dhe mallrave me nisje nga Vau-Dejës për në Koman, i cili plotëson natyrshëm linjën lumore e cila tashmë ekziston ndërmjet Komanit dhe Fierzës.</p> <p>Projekti bazohet në ndërtimin e një moli për nisjen/mbërritjen e trageteve në Vau-Dejës dhe Koman, si dhe ndërtimin e stacioneve të ankorimit përgjatë itinerarit lumor. Stacionet e ankorimit do të ndërtohen në pika strategjike dhe afër komuniteteve lokale bujqësore që ndodhen në afërsi të liqenit; ato do të kenë funksionin e pikave të reja të nisjes për turistët që synojnë të vizitojnë fshatrat bujqësorë dhe resurset natyrore në brendësi të territorit (mole ankorimi, shërbime dyqani dhe restoranti, plazhe për banjo dielli etj.).</p> <p>Projekti ka për qëllim realizimin e infrastrukturave publike kryesore ndërkohë që funksionimin e linjës dhe shërbimet synon t’ia besojë operatorëve privatë.</p>	
Rezultatet e pritshme	Rikuperimi dhe stabilizim i kushteve të jetesës dhe të aktiviteteve ekonomike të komuniteteve rurale.	
Interesa publike Interesa private	Lidhja me banimet e brendshme dhe malore të arritshme me shtigje të reja; Mundësi përfitimi, të ardhura dhe punësim për ekonomitë e mundshme të induktuara të strukturës (restorante, agro-turizëm, dyqane artizanale që mund të realizohen në stacionet kryesore, dhe me vëmendje të madhe në cilësinë e peizazhit dhe mjedisore të trajektores së brendshme, në pikat e ndryshme të ndalimit, me rritjen e punësimit dhe nxitjen e prodhimit të të mirave materiale dhe shërbimeve.	
Vlera e projektit	<p>Realizimi i një moli për ankorimin e trageteve për nisje / mbërritje = 1.000.000 euro</p> <p>Realizimi i një moli të vogël ankorimi për stacionet e ndërmjetme = 250.000 euro</p> <p>Sistemim i plazhit = 50.000 euro</p> <p>Realizimi i shërbimeve të dyqanit dhe restorantit = 150.000 euro</p> <p>Realizimi i linjës së tragetit = 300.000 euro</p>	
Burime të mundshme financimi	Ndihma Ndërkombëtare nga programi IPA II, që për periudhën 2014-2020, në pikën 4, Transporti, parashikon fonde që synojnë përmirësimin e infrastrukturës dhe lidhjes rajonale. Në rast se ndihmat ndërkombëtare nuk do të jenë të mjaftueshme, do të duhet një bashkë-financim i Fondit të Zhvillimit Rajonal të qeverisë Shqiptare.	
Projekte të ngjashme		
Prioriteti	<p>Afatshkurtër – Afatmesëm (Projekt Pilot)</p> <p>Raporti me Axhendën e OKB 2030:</p> <p>Objektivi 8. Nxitja e një rritje ekonomike jetëgjatë, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, një punësim i plotë e produktiv dhe një punë të denjë për të gjithë.</p> <p>Objektivi 9. Ndërtimi i një infrastrukture elastike dhe nxitja e inovacionit dhe e një industrializimi të barabartë, i përgjegjshëm dhe i qëndrueshëm.</p>	



2.2.1 Realizimi i linjës së transportit uhor Vau-Dejës - Koman

Raport i Përmbledhur


3	OBJEKTIVI	QENDRAT URBANE
3.1	PROGRAMI	POL SHËRBIMESH PËR TERRITORIN PËRRETH
3.1.2	EMËRTIMI I PROJEKTIT	POL PËR SHËRBIME TË NDIHMËS TEKNIKE, LOGJISTIKE DHE ORGANIZATIVE PËR BUJQËSINË (BUSHAT/RRANXË) (PROJEKT PILOT)
Përshkrimi i projektit		Projekti parashikon realizimin një poli të integruar për shërbimet e asistencës teknike për bujqësinë. Ndërhyrja bazohet (nga pikëpamja e veprave) në krijimin e godine të re për zyrat në të cilën do të duhet të kryhen aktivitetet e përkrahjes teknike dhe trajnimit profesional për punonjësit në aktivitetit bujqësor të zonës (që nuk janë përgjegjës për projektin). Qendra gjithashtu do të pajiset me një kaponon të vogël për pajisjet teknike.
Rezultatet e pritshme		Përmirësimi i kushteve të shërbimit dhe aksesit ndaj shërbimeve bazë nga popullsia lokale (shoqërore-sanitare, kulturore, ekonomia dhe shërbime administrative)
Interesi publik Interesi privat		Përmirësimi i ofertës së shërbimeve publike Rritja e të ardhurave urbane dhe imobiliare
Vlera e projektit		Realizimi i një godine të re për zyrat = 1.000.000 euro Realizimi i një kapononi për pajisjet teknike = 1.000.000 euro
Burime të mundshme financimi		Ndihma Ndërkombëtare i) fonde nga programi IPA II që për përdhën 2014-2020, në pikën 7, Bujqësia dhe zhvillimi rural, parashikon ndihmë për përmirësimin e konkurrencës në sektorin agro-ushqimor; ii) fonde nga Qeveria Italiane nëpërmjet Agjencisë së Bashkëpunimit Italian për Zhvillimin, që përfshin programe në mbështetje të rritjes së makro-sektorëve vijues: 'Zhvillimi Ekonomik' dhe 'Bujqësia dhe Zhvillimi Rural'; iii) fonde nga programi IPATECH i financuar nga Bashkimi European nëpërmjet Programit IPA Adriatic Transnational Cooperation.
Projekte të ngjashme		
Prioriteti		Afatshkurtër (Projekt Pilot) Raporti me Axhendën e OKB-së 2030 Objektivi 11 Krijimi i qyteteve dhe vendbanimeve njerëzore gjithëpërfshirëse, të sigurta, jetëgjata dhe të qëndrueshme Objektivi 12. Garantimi i modeleve të qëndrueshme për prodhimin dhe konsumin




3.1.2 Pol për shërbime të ndihmës teknike, logjistike dhe organizative për bujqësinë (Bushat/Rranxë)



Raport i Përmbledhur


3	OBJEKTIVI	QENDRAT URBANE
3.2	PROGRAMI	ZHVILLIMI I QENDRAVE LOKALE
3.2.1	EMËRTIMI I PROJEKTIT	ZHVILLIM I QENDRËS URBANE VAU-DEJËS (PROJEKT PILOT)
Përshkrimi i projektit	<p>Projekti parashikon përforcimin e qendrave urbane të Vau-Dejës, në përputhje me veprat që janë në fazë realizimi, në lidhje me krijimin e hapësirave të reja publike dhe objekteve kolektive dhe private (hapësira tregtare dhe shërbime private); qëllimi i këtij projekti është që të krijojë një aks të ri urban / shëtitore publike që në lidhje me objektivat kryesorë, të synojë lidhjen e zonave qendrore të qytetit me stacionin e ri të propozuar të transportit lumor drejt digës së Komanit, duke i dhënë zgjidhje disa zonave të afërta në degradim urban.</p> <p>Projekti synon të kontribuojë në krijimin e një “efekti urban” në pjesën më qendrore të strukturës ekzistuese të banimit, nëpërmjet realizimit të hapësirave publike e pajisur me cilësitë e duhura për jetën sociale dhe për aktivitetet kulturore dhe rekreative. Gjatë hartimit të projektit duhet të merret parasysh prania e disa burimeve dhe kanaleve ujore në afërsi të qendrës së qytetit të cilat mund të integrohen në forma të ndryshme në hapësirat e reja publike që do të realizohen (shatërvanë, ujëvara, kanale ujore, etj.)</p>	
Rezultatet e pritshme	Përmirësimi i kushteve të shërbimit dhe aksesit ndaj shërbimeve bazë nga popullsia lokale (shoqërore-sanitare, kulturore, ekonomia dhe shërbime administrative).	
Interesi publik Interesi privat	Përmirësimi i ofertës së shërbimeve publike. Rritja e të ardhurave urbane dhe imobiliare.	
Vlera e projektit	<p>Realizimi i një trotuari në zonat e këmbësorëve = 800.000 euro</p> <p>Realizimi i një zone të sistemuar dhe të gjelbër = 200.000 euro</p> <p>Mbjellje pemësh = 100.000 euro</p> <p>Realizimi i ndriçimit publik = 500.000 euro</p> <p>Furnizimi dhe vendosja në vepër e arredimit urban = 100.000 euro</p>	
Burime të mundshme financimi	Fondet nga Qeveria Italiane, nëpërmjet Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim: kapitulli 2 i Protokollit të Marrëveshjes ndërmjet Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim dhe Qeverisë Shqiptare përmban Veprime në favor të zhvillimit shoqëror, të burimeve njerëzore, të përfshirjes dhe kohezionit territorial. Në rastin kur ndihma nga Qeveria Italiane nuk do jetë e mjaftueshme, do të duhet një bashkë-financim i Fondit Rajonal të Zhvillimit i Qeverisë Shqiptare.	
Projekte të ngjashme		
Prioriteti	<p>Afatshkurtër (Projekt Pilot)</p> <p>Raporti me Axfordën e OKB-së 2030.</p> <p>Objektivi 11 Krijimi i qyteteve dhe vendbanimeve njerëzore gjithëpërfshirëse, të sigurta, jetëgjata dhe të qëndrueshme.</p>	



3.2.1 Zhvillimi i qendrës urbane Vau-Dejës

Raport i Përmbledhur


3	OBJEKTIVI	QENDRAT URBANE
3.2	PROGRAMI	ZHVILLIMI I QENDRAVE LOKALE
3.2.3	EMËRTIMI I PROJEKTIT	ZHVILLIM I QENDRËS URBANE BUSHAT (PROJEKT PILOT)
Përshkrimi i projektit	<p>Projekti parashikon ndërtimin e një qendre urbane lokale në fshatin Bushat, e kuptuar si një përqendrim i funksioneve të tipit kolektiv dhe të shërbimit për popullsinë vendase (shërbime administrative të decentralizuara, shërbime sanitare bazë, qendra kulturore, shërbime tregtare, hapësira për fëmijë).</p> <p>Projekti synon të kontribuojë në krijimin e një “efekti urban” në pjesën më qendrore të strukturës ekzistuese të banimit, nëpërmjet realizimit të hapësirave publike e pajisur me cilësitë e duhura për jetën sociale dhe për aktivitetet kulturore dhe rekreative.</p> <p>Ndërhyrja bazohet në sistemimin e organizuar të hapësirave publike, nëpërmjet realizimit të vendeve për shëtitje, për pushim dhe për jetën e përbashkët.</p>	
Rezultatet e pritshme	Përmirësimi i kushteve të jetës urbane, rritja e standardit të jetesës, cilësi më e lartë e hapësirave publike.	
Interesi publik Interesi privat	Përmirësimi i ofertës së shërbimeve publike. Rritja e të ardhurave urbane dhe imobiliare.	
Vlera e projektit	<p>Realizimi i një trotuari në zonat e këmbësorëve = 800.000 euro</p> <p>Realizimi i një zone të sistemuar dhe të gjelbër =200.000 euro</p> <p>Realizimi i rreshtave me pemë = 100.000 euro</p> <p>Realizimi i ndriçimit publik= 500.000 euro</p> <p>Furnizimi dhe vendosja në vepër e arredimit urban = 100.000 euro</p>	
Burime të mundshme financimi	Fondet nga Qeveria Italiane, nëpërmjet Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim: kapitulli 2 I Protokollit të Marrëveshjes ndërmjet Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim dhe Qeverisë Shqiptare përmban Veprime në favor të zhvillimit shoqëror, të burimeve njerëzore, të përfshirjes dhe kohezionit territorial. Në rastin kur ndihma nga Qeveria Italiane nuk do jetë e mjaftueshme, do të duhet një bashkë-financim i Fondit Rajonal të Zhvillimit i Qeverisë Shqiptare.	
Shembull		
Prioriteti	<p>Afatshkurtër (Projekt Pilot)</p> <p>Raporti me Axhendën e OKB-së 2030</p> <p>Objektivi 11 Krijimi i qyteteve dhe vendbanimeve njerëzore gjithëpërfshirëse, të sigurta, jetëgjata dhe të qëndrueshme.</p>	



3.2.3 Zhvillimi i qendrës urbane Bushat

Raport i Përmbledhur

3	OBJEKTIVI	QENDRAT URBANE
3.3	PROGRAMI	RIKUALIFIKIMI URBAN
3.3.1	EMËRTIMI I PROJEKTIT	RIKUALIFIKIM I QENDRËS URBANE VAU-DEJËS (PROJEKT PILOT)
Përshkrimi i projektit	Projekti parashikon një ndërhyrje për rikuperimin dhe përmirësimin e kushteve të banimit të lagjeve me shtëpi të përkohshme, që presin zgjidhje prej vitesh. Ndërhyrja bazohet në rikuperimin dhe rikonstruksionin e ndërtesave ekzistuese për të sjellë në nivelet bashkëkohore standardin e banimit, por edhe për sistemimin urbanistik të zonës në të cilën ndodhen banesat (rrugët lokale, hapësirat publike, arredimi urban etj.)	
Rezultatet e pritshme	Përmirësimi i kushteve të jetës urbane, rritja e standardit të jetesës, cilësi më e lartë e hapësirave publike.	
Interesi publik Interesi privat	Rikuperimi i ndërtesave publike	
Vlera e projektit	Rinovimi i godinave ekzistuese = 1.000.000 euro Realizimi i një trotuari të ri në zonat e këmbësorëve = 500.000 euro Realizimi i një zone të sistemuar e të gjelbër = 200.000 euro Realizimi i ndriçimit publik = 500.000 euro	
Fonde të mundshme financimi	Fondet nga Qeveria Italiane, nëpërmjet Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim: kapitulli 2 i Protokollit të Marrëveshjes ndërmjet Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim dhe Qeverisë Shqiptare përmban Veprime në favor të zhvillimit shoqëror, të burimeve njerëzore, të përfshirjes dhe kohezionit territorial. Në rastin kur ndihma nga Qeveria Italiane nuk do jetë e mjaftueshme, do të duhet një bashkë-financim i Fondit Rajonal të Zhvillimit i Qeverisë Shqiptare.	
She		
Prioriteti	Afatshkurtër (Projekt Pilot) Raporti me Axfordën e OKB-së 2030 Objektivi 11 Krijimi i qyteteve dhe vendbanimeve njerëzore gjithëpërfshirëse, të sigurta, jetëgjata dhe të qëndrueshme	




3.2.3 Rikualifikim i qendrës urbane Vau-Dejës



Raport i Përmbledhur


4	OBJEKTIVI	TURIZMI
4.2	PROGRAMI	TURIZMI KULTUROR
4.2.1	EMËRTIMI I PROJEKTIT	REALIZIM I NJË ITINERARI PËR TURIZMIN KULTUROR SAPË - DANJË – SARDË – KOMAN (PROJEKT PILOT)
Përshkrimi i projektit	<p>Projekti parashikon realizimin e një itinerari turistik kulturor mes destinacioneve kulturore Sapë- Danjë-Sardë-Koman, atraksione kryesore turistike arkeologjike dhe kulturore.</p> <p>Secili destinacion ka nevojë për një përmirësim në rrugët e aksesit. I gjithë itinerari do të përbëhet nga rrugë për biçikleta, për këmbësorët dhe itinerare lumore. Në çdo destinacion, do të realizohen hapësira të vogla pushimi të pajisura me struktura në mbështetje të vizitës turistike. Është e dëshirueshme që projekti të ecë njëkohësisht me aktivitetet studimore dhe ruajtëse të vendeve të tilla të rëndësishme kulturore.</p>	
Rezultatet e pritshme	Mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore vendase, zhvillimi i qëndrueshëm i ekonomisë vendase, kontrolli dhe mbrojtja e aktivitetit të zhvillimit turistik në zonë, mirëqenia dhe argëtimi i popullsisë vendase	
Interesi publik Interesi privat	Mbrojtja mjedisore	
Vlera e projektit	<p>Përmirësimi i mundësisë së arritjes së vendeve për t'u vizituar = 1.000.000 euro</p> <p>Realizimi i një zone pushimi në vendet që vizitohen = 250.000 euro</p> <p>Realizimi i sinjalistikës turistike = 50.000 euro</p> <p>Krijimi i një fushate të përshtatshme për reklama dhe marketing = 250.000 euro</p>	
Fonde të mundshme financimi	<p>Ndihma Ndërkombëtare: i) fonde nga programi për Rrugët Lokale dhe Dytësore të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, i financuar nga Banka Botërore. ii) fonde nga programi IPA II që për periudhën 2004-2020, në pikën 4, Transporti, parashikon ndihmë për përmirësimin e infrastrukturës dhe lidhjes rajonale dhe në pikën 5, Konkurrenca dhe Inovacioni, parashikon ndihmë për zhvillimin e turizmit.</p>	
Projekte të ngjashme		
Prioriteti	<p>Afatshkurtër - Afatmesëm - Afatgjatë (Projekt Pilot)</p> <p>Raporti me Axhendën e OKB-së 2030</p> <p>Objektivi 12. Garantimi i modeleve të qëndrueshme për prodhimin dhe konsumin</p>	



4.2.1 Realizimi i një itnerari për turizmin kulturor Sapë-Danjë-Sardë-Koman

Raport i Përmbledhur

5	OBJEKTIVI	BUJQËSIA DHE KULTIVIMI I PESHKUT
5.1	PROGRAMI	STRUKTURAT E SHËRBIMIT
5.1.1	EMËRTIMI I PROJEKTIT	REALIZIMI I TRE QENDRAVE AGRO-USHQIMORE PËR GRUMBULLIMIN DHE EVADIMIN E PRODHIMIT NË BUSHAT, HAJMEL DHE MJEDË (PROJEKT PILOT)
Përshkrimi i projektit		Projekti parashikon krijimin e tre qendrave të mbledhjes dhe klasifikimit të prodhimit bujqësor në zonën e Bushatit, Hajmelit dhe Mjedës, të dedikuara për mbledhjen e grurit dhe kulturave industriale, frutave dhe perimeve, produkteve të bulmetit etj. Qendrat do të jenë të specializuara sipas vendndodhjes së tyre. Ajo e Bushatit do të ketë në fokus prodhimet fushore dhe ato të serave, ajo e Hajmelit, prodhimet e vreshtave dhe ullishtave ndërsa qendra e Mjedës do të shërbejë për ndërlidhjen me transportin hekurudhor për shpërndarjen e prodhimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Tri qendrat e mbledhjes dhe klasifikimit duhet të jenë të lidhura me njëra tjetrën dhe me sistemin e shitjes së produkteve. Secila nga qendrat do të përbëhet nga një ambient për klasifikimin e mjeteve të transportit, disa kapanone për magazinimin e përkohshëm të produkteve, një zyrë për menaxhimin e flukseve.
Rezultatet e pritshme		Rritja e përfitimit bujqësor për sipërmarrjet e vogla dhe të mesme në këtë sektor, përmirësimin dhe specializimin e prodhimit të ushqimit bujqësor.
Interesa publike Interesa private		Mundësi për të ardhura dhe punësim për banorët vendas. Këto qendra mund të menaxhohen nga Bashkia ose nga konsorciumet e operatorëve privatë.
Vlera e projektit		Realizimi i shesheve të asfaltuara = 50.000 euro Ndërtimi i kapanoneve për magazinimin e produkteve bujqësore = 1.000.000 euro Ndërtimi i kapanoneve frigoriferike për konservimin e produkteve = 1.000.000 euro Realizimi i një godine për zyrat = 200.000 euro
Burime të mundshme financimi		Ndihma Ndërkombëtare: i) fonde nga programi IPA II që për periudhën 2014-2020, në pikën 5, Konkurrenca dhe Inovacioni, parashikon ndihmë për konkurrencën dhe integrimin në ekonominë e tregut, dhe në pikën 7, Bujqësia dhe zhvillimi rural, parashikon ndërhyrje që synojnë përmirësimin e konkurrencës në sektorin agro-ushqimor. ii) fonde nga Qeveria Italiane nëpërmjet Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim, që përmban programe në mbështetje të rritjes së makro-sektorëve vijues: 'Zhvillimi Ekonomik' dhe ' Bujqësia dhe Zhvillimi Rural'; iii) fonde nga programi IPATECH i financuar nga Bashkimi Europian nëpërmjet Programit IPA Adriatic Transnational Cooperation.
Projekte të ngjashme		
Prioriteti		Afatshkurtër (Projekt Pilot) Raporti me Axhendën e OKB-së 2030: Objektivi 8. Nxitja e një rritjeje të qëndrueshme ekonomike, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësimi i plotë dhe produktiv dhe punë e denjë për të gjithë Objektivi 9. Ndërtimi i një infrastrukturës elastike dhe promovimi i inovacionit dhe industrializimit të barabartë, të përgjegjshëm dhe të qëndrueshëm Objektivi 12. Garantimi i modeleve të qëndrueshëm të prodhimit dhe konsumit




5.1.1 Realizimi i tri qendrave agro-ushqimore në Bushat, Mjedë dhe Hajmel për grumbullimin dhe evadimin e prodhimit.



Raport i Përmbledhur

5	OBJEKTIVI	BUJQËSIA DHE KULTIVIMI I PESHKUT
5.2	PROGRAMI	RRITJA E PRODHIMTARISË
5.2.8	EMËRTIMI I PROJEKTIT	ZBATIMI I PROJEKTIT PËR MBJELLJEN E 150 HA SHEGË NË ZONA KODRINORE, NË 6-TË FSHATRA ME NGA 25 HA NË BLOK (PROJEKT PILOT)
Përshkrimi i projektit		<p>Projekti parashikon mbjelljen e 150 hektarë shegë në zonat kodrinore në gjashtë blloqe prej 25 hektarë për t'u realizuar në dy fshatra të njësisë Vig-Mnelë (Mnelë e Vogël dhe Vig) dhe katër fshatra të njësisë Hajmel (Hajmel, Nënshat, Paçram dhe Pistull).</p> <p>Shega është një produkt që mund të kultivohet mirë në zonë, me kërkesë në rritje të produkteve të freskëta dhe atyre të përpunuara. Ky projekt është hartuar më parë nga DBU Shkodër në bashkëpunim me K.Q Shkodër në kuadër të planit strategjik të komunës Hajmel.</p> <p>Projekti të mund të zbatohet në harkun kohor të 15 viteve duke realizuar 10 hektarë në vit.</p>
Rezultatet e pritshme		<p>Kualifikimi i peizazhit bujqësor lokal, në kontrast me degradimin dhe ekspozimin ndaj rrezikut hidrogeologjik të shpateve në kushtet e paqëndrueshmërisë aktuale ose të mundshme.</p> <p>Zhvillimi dhe shumëllojshmëria e prodhimit të verës vendase, rritja e kushteve të punës, të ardhura dhe fitime; rritja dhe përmirësimi cilësor i prodhimeve të sektorit</p>
Interesi publik Interesi privat		<p>Të ardhura më të mëdha për bashkinë</p> <p>Mundësi të ardhurash, fitimi dhe punësimi për sipërmarrjet e këtij sektori</p>
Vlera e projektit		610.000 euro në 10 vite (61.000 euro në vit)
Burime të mundshme financimi		<p>Kapital i ofruar nga individë në formë toke ose në formë kapitali financiar. Ndiha ndërkombëtare: i) fonde nga programi IPA II që për periudhën 2014-2020, në pikën 5, Konkurrenca dhe inovacioni, parashikon ndihmë për konkurrencën dhe integrimin në ekonominë e tregut, dhe në pikën 7, Bujqësia dhe zhvillimi rural, parashikon ndërhyrje për përmirësimin e konkurrencës në sektorin agro ushqimor. ii) fonde nga Qeveria Italiane, përmes Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim, që përfshin programe në mbështetje të rritjes në makro-sektorët vijues: "Zhvillimi Ekonomik" dhe 'Bujqësia dhe Zhvillimi Rural'; iii) fonde nga programi IPATECH I financiar nga Bashkimi Europian përmes Programit IPA Transnacional Adriatik.</p>
Projekte të ngjashme		
Prioriteti		<p>Afatshkurtër - Afatmesëm (Projekt Pilot)</p> <p>Raporti me Axfordën e OKB-së 2030</p> <p>Objektivi 12. Garantimi i modeleve të qëndrueshme për prodhimin dhe konsumin</p>



5.2.8 Zbatimi i projektit për mbjelljen e 150 ha shegë në zona kodrinore, në 6-të fshatra me nga 25 ha në bllok.

3.3 Plani i Investimeve Kapitale dhe lidhja me PBA

Plani financiar (Plani i Investimeve Kapitale) i investimeve i hartuar për PPV të Bashkisë Vau-Dejës ka këto tre objektiva:

- Identifikimi i kërkesës financiare për realizimin e propozimeve, pra shuma e kapitalit të nevojshëm për zbatimin e investimeve të parashikuara;
- Përcaktimi i burimeve të mundshme të financimit;
- Vlerësimi ekonomik i projekteve, me qëllim verifikimin që vlera aktuale neto e projekteve të financuara të jetë pozitive.

PIK është një plan shumëvjeçar i projekteve kapitale, të kategorizuara sipas prioriteteve dhe i fazuar, që identifikon pasurinë/asetin që do të rehabilitohet, vitin kur do të fillojë të zbatohet dhe kohëzgjatjen e investimit, koston që do të kërkojë realizimi, si dhe mënyrën e propozuar të financimit të investimit. PIK prezantohet si një pasqyrë përmbledhëse që përfshin shpenzimet për investimet kapitale për çdo vit, të detajuara sipas objektivave strategjike dhe programeve që përmbushin, si dhe mënyrës së financimit të tyre.

3.3.1 Burimet financiare

Zbatimi i PPV të Bashkisë Vau Dejës është një proces që kërkon mbështetje financiare të konsiderueshme. Përveç iniciativave private që mbështeten direkt nga biznesi i interesuar, propozimet në lidhje me shërbimet publike/infrastrukturat e ndryshme do mbështeten në:

- Buxhetin lokal;
- Fondet e Qeverisë Shqiptare;
- Donatorët e huaj;
- Partneritet publik privat.

Pavarësisht lidhjes së PPV me PBA e 2018-2020, dhe angazhimin konkret të bashkisë për të mbështetur propozimet e PPV duhet të pranojmë faktin që ka mjaft projekte që duhen mbështetur nga Qeveria Qëndrore apo donatorë të huaj. Kjo, jo vetëm për arsyen e kufizimeve të konsiderueshme që ka bashkia në financimin e projekteve të ndryshme, por edhe për vetë faktin që mjaft prej propozimeve kanë karakter rajonal/kombëtar dhe si të tillë kanë një impakt që kalon kufinjtë e Bashkisë Vau Dejës.

Duhet të kemi parasysh që propozimet e karakterit kombëtar nuk janë një e mbetë e planit lokal. Ato shpesh herë vijnë ose direkt nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar ose nga evidentimi i mundësive zhvillimore që kanë impakt rajonal apo kombëtar.

Gjithashtu duhet vlerësuar fakti që në qershor të vitit 2014, Shqipëria mori statusin e vendit “kandidat” për në BE. Duke u mbështetur në këtë status, Shqipëria mund të marrë financimet e parashikuara nga Plani i Ndërhyrjeve për fazën e dytë, ajo e Para-Pranimit (IPA II - Instrument for Pre-accession Assistance). Ky plan, që bën pjesë në politikën e pranimit në Bashkimin Evropian, përfshin periudhën 2014-2020 dhe vë në dispozicion një buxhet prej 11.7 miliardë euro për ndërhyrjet në pesë nga fushat e mëposhtme:

- Mbështetje dhe përforsim të institucioneve nëpërmjet reformave të administrimit publik;
- Bashkëpunim ndërkufitar ndërmjet shteteve pjesëtare të UE dhe vendeve të tjera të pranueshme në IPA (FYROM, Turqi, Shqipëri, Mal i Zi, Serbi, BiH, Kosovë);

- Zhvillim rajonal, në aspektin e zhvillimit ekonomik, të transportit dhe të mbrojtjes së mjedisit;
- Zhvillimi i burimeve njerëzore dhe luftë kundër përjashtimit dhe varfërisë;
- Zhvillimi rural dhe i sistemeve bujqësore.

Në dhjetor të vitit 2014 Bashkimi Europian ka lëshuar një dokument që përditëson udhëzimet për Analizat Kosto-Përfitim (CBA – Cost Benefit Analysis), të përcaktuara më parë nga BE në 2003 dhe në 2008 duke iu referuar IPA-s së parë, të cilat janë kërkesa për të hyrë në bashkë-financimin e Programeve Operative të Fondit Europian për Zhvillim Rajonal (ERDF – European Regional Development Fund) dhe Fondin e Kohezionit. Metodot e analizës financiare dhe ekonomike të Analizave Kosto-Përfitim (CBA) të përcaktuara në këto udhëzime, janë ato të cilave në do t'u përmbahemi në analizën financiare dhe ekonomike të projekteve, pjesë e planit të veprimit të kësaj PPV-je.

3.3.2 Plani i veprimit

Plani i veprimit shpалoset përgjatë udhëzimeve që rrjedhin nga gjashtë "akset strategjike" që përbëjnë strategjinë e PPV-së. Secili nga këto akse përcakton një sërë "programesh strategjike", të cilët, më pas, shtjellohen në "projekte".

Tre objektivat e para (pajisja me shërbimet bazë, lëvizja me mënyra të ndryshme dhe qendrat urbane) përbëhen nga investime infrastrukturore dhe veprime që synojnë t'i ofrojnë territorit disa infrastruktura publike bazë siç janë rrugët, kanalizimet, ujësjellësat, menaxhimi i mbetjeve etj.

Këto të mira publike janë një premisë e domosdoshme për zhvillimin ekonomik të bashkisë dhe për zbatimin e PPV-së, prandaj projektet përkatëse janë vendosur në fazën e parë dhe të dytë të zbatimit. Duke parë mungesën e infrastrukturave moderne në vend, është e qartë që këto investime infrastrukturore do të gjenerojnë kthime ekonomike më shumë sesa investimet e bëra, si në periudhën afatshkurtër dhe afatgjatë.

Në aspektin teknik, këto janë shpenzime publike që zakonisht prodhojnë rritje endogjene, dmth janë investime të afta për të nisur proceset e rritjes së virtytshme që bëhen të vetëfinansueshëm me kalimin e kohës. Shumica e projekteve të paraqitura në këto tre akse mund të financohen me fonde publike nga autoritetet lokale dhe kombëtare, ose duke u mbështetur edhe tek Fondi për Zhvillim Rajonal.

Për më tepër, këto investime përbushin kushtet për aplikim për kontributet e programeve ndërkombëtare, si Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH), Banka Botërore dhe fondet e Instrumentit për Ndihmën e Para-aderimit II (IPA II) të ofruara nga Bashkimi Europian. Në veçanti, projektet për qendrat urbane përfshihen në kuadër të marrëveshjes ndërmjet Agjencisë Italiane për Zhvillim dhe Qeverisë Shqiptare dhe për këtë arsye mund të përfitohet nga këto kontribute.

Një pjesë e kostove të ndërhyrjeve në Rrjetin Rrugor (pika 2.1) mund të mbulohet nga dy linja të ndihmës së huaj: (i) Programi i rrugëve dytësore dhe lokale të financuara nga Banka Botërore nëpërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit; (ii) programi IPA II, i cili siguron fonde për të "përmirësuar infrastrukturën rajonale dhe lidhjen".

Objektivi i katërt (Turizmi) përbëhet nga projekte që synojnë të zhvillojnë dhe promovojnë burimet e shumta turistike mjedisore dhe kulturore të territorit. Ndër më të rëndësishmit,

për zhvillimin e turizmit në bashki, është krijimi i një Parku Rajonal, pra një koridor për mbrojtjen e mjedisit përgjatë lumit Drin, i cili do të lidhë zonën e mbrojtur të Alpeve me peizazhin e mbrojtur të Bunës dhe Velipojës. Ky operacion do të jetë një nxitës i ndërhyrjeve të tjera në mbështetje të zhvillimit turistik, si itineraret kulturore dhe agroturizmi. Ky bosht strategjik përbëhet kryesisht nga ndërhyrje publike, si Parku Rajonal Lumor dhe realizimi i një itinerari kulturor Sapë-Danjë-Sardë-Koman (pika 4.2.1). Nga ana tjetër, ndërhyrjet në lidhje me shfrytëzimin e burimeve turistike nga sipërmarrje private, siç janë shërbimet e trageteve lumore nga Vau-Dejës deri në Koman (pika 2.2.1), mund të kryhen me projekt-financing përmes koncesioneve.

Masat e tjera që duhet të zbatohen me investime private, siç është realizimi i agroturizmit dhe turizmit të verës, mund të nxiten me anë të lehtësimit të taksave.

Objektivi i pestë strategjik (Bujqësia, Blegtoaria dhe Peshkimi) përqëndrohet në zhvillimin e burimeve bujqësore, agro-industriale dhe agro-turizmit. Bashkia ka një potencial të madh të zhvillimit bujqësor, për shkak të pozicionit gjeografik, pasurive të mëdha ujore, moshës së re të fermerëve dhe, së fundmi, por jo për nga rëndësia, rritjes (aktuale dhe potenciale) të sektorit të turizmit. Në planin afatshkurtër, ky objektivi paraqet disa projekte për të përmirësuar dukshëm efikasitetin e sektorit bujqësor lokal, ndërsa në planin afat-gjatë ka disa propozime që synojnë tejkalimin e mungesës së efikasitetit për shkak të dimensioneve të vogla të pronave bujqësore dhe ndërmarrjeve të agroindustrisë.

Këto ndërhyrje të shumta ndahen në dy linja veprimi: ndërhyrjet infrastrukturore (pika 5.1, Strukturat e Shërbimeve) që duhet të zbatohen nga autoritetet publike dhe ndërhyrjet që synojnë modernizimin e teknologjive të përdorura në sektorin e bujqësisë (pika 5.2, Rritja e Prodhimit), që do të ndërmerren nga investitorët privatë, të mbështetur nga lehtësimi i taksave dhe kreditë e subvencionuara. Përveç kësaj, investimet bujqësore dhe agroindustriale në teknologji dhe shkëmbimi i njohurive do të përfitojnë nga programi IPATECH i financuar nga BE nëpërmjet IPA Adriatic Transnational Cooperation Program.

Për më tepër, ndërhyrjet e financuara nga investimet private, në sektorin e turizmit dhe agroturizmit, si dhe në sektorin bujqësor dhe agro-ushqimor, kanë të drejtë të marrin kredi bankare me norma dhe subvencione të subvencionuara (përmes Fondit të Donacioneve për Asistencë Teknike) falë Programit të Qeverisë Italiane për Zhvillimin e Sektorit Privat në Shqipëri (PRODAPS). Projektet e renditura në këtë objektivi, të menduara për të krijuar kushtet e domosdoshme për transformimin e sistemit bujqësor lokal, duhet të kryhen paralelisht me promovimin turistik të Parkut Rajonal Lumor (pika 4.1.1). Zhvillimi turistik dhe agro-turistik i kësaj zone do të rrisë tregun e brendshëm dhe të jashtëm për produktet bujqësore vendase me vlerë të shtuar.

Së fundmi, PPV gjithashtu parashikon zhvillimin e prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme (pika 6.1). Duke marrë parasysh disponueshmërinë me çmim të ulët të energjisë elektrike nga burimet hidroenergjetike, kjo ndërhyrje është vendosur në fazën e tretë dhe të fundit të zbatimit të planit.

3.3.2.1 Fazimi i zhvillimit dhe projektet prioritare

Në këtë plan projektet strategjike janë ndarë në dy kategori: projektet bazë dhe projektet e zhvillimit. "Projektet bazë" janë ato projekte të cilat janë të domosdoshme për t'i krijuar sistemit lokal kushtet fillestare për zhvillimin e mëtejshëm dhe kanë të bëjnë me plotësimin

e kushteve minimale për efikasitetin e sistemit territorial. Nga ana tjetër, “projektet e zhvillimit” janë ato projekte të cilave plani u ngarkon detyrën për dhënien e shkëndijës së parë të proceseve të zhvillimit të sistemit territorial dhe social-ekonomik.

Projektet ndahen në tri fasha kohore:

1. Projekte të realizueshme në një periudhë kohore të shkurtër (afat-shkurtër);
2. Projekte të realizueshme në një periudhë kohore të mesme (afat-mesëm);
3. Projekte të realizueshme në një periudhë kohore të gjatë (afat-gjatë).

Duke konsideruar afatin për të cilin hartohet PPV (15 vjet), periudha “afat-shkurtër” nënkupton nga 1 deri në 5 vite, “afat-mesëm” nga 6 nga në 10 vite dhe “afat-gjatë” me shumë se 10 vite.

Projekteve të zhvillimit afatshkurtër mund edhe t’iu jepet roli i “projekteve pilot” (përveç rolit “prioritar”).

Zhvillimi afatshkurtër në 5 vitet e para do të përqëndrohet në të gjitha ato zona që:

- Kanë dendësinë më të lartë të popullsisë;
- Qendrat e banimit kryesore (Vau-Dejës, Bushat);
- Poli i zhvillimit bujqësor Bushat – Rranxë;
- Zona me potenciale të larta të zhvillimit turistik (itinerari turistik Sapë – Danjë – Sardë - Koman);
- Zonat e prekura nga projektet pilot/prioritare;
- Infrastrukturen primare.

Zhvillimi afat-mesëm në 5-vjeçarin e dytë do të përqëndrohet në:

- Lokalitetet kryesore (Mjedë, Rranxë, Hajmel, Nënshatë, Barbullush, Koman, Ashtë, Kosmaç, Mnelë e Madhe, Benë);
- Zonat e zhvillimit ekonomik: Bushat dhe Mjedë;
- Poli i zhvillimit të transportit multimodal Vau-Dejës – Mjedë;
- Intensifikimin e shërbimeve në qendrat kryesore rurale;
- Infrastrukturën sekondare.

Zhvillimi afat-gjatë do të përfshijë të gjitha zonat e tjera duke synuar kryesisht:

- Realizimin e objektivave strategjike të PPV;
- Realizimin e projekteve të zhvillimit;
- Pajisjen përfundimtare me infrastrukturë e shërbime të qendrave urbane dhe rurale;
- Zhvillimin e turizmit dhe ekonomisë.

3.3.2.2 Kërkesa financiare për projektet pilot:

Ndër projektet e propozuara në këtë plan, tërësia e “projekteve pilot”, të përcaktuar në fazën e dytë, shfaq një kërkesë financiare relativisht të kufizuar. Nëntë projektet pilot të përcaktuar për Bashkinë Vau-Dejës janë si më poshtë:

- Përmirësimi i rrugës Vau-Dejës-Koman, kosto e llogaritur: 7.000.000 euro;
- Realizimi i linjës së transportit ujor Vau-Dejës - Koman, kosto e llogaritur: 1.500.000 euro;

- Pol për shërbime të ndihmës teknike, logjistike dhe organizative për bujqësinë (Bushat/Rranxë), kosto e llogaritur: 2.000.000 euro;
- Zhvillimi i qendrës urbane Vau-Dejës, kosto e llogaritur: 1.900.000 euro;
- Zhvillimi i qendrës urbane Bushat, kosto e llogaritur: 1.900.000 euro;
- Rikualifikim i qendrës urbane Vau-Dejës, kosto e llogaritur: 2.200.000 euro;
- Realizim i një itinerari për turizmin kulturor Sapë – Danjë – Sardë – Koman, kosto e llogaritur: 1.350.000 euro;
- Realizimi i tri qendrave agro-ushqimore për grumbullimin dhe evadimin e prodhimit në Bushat, Hajmel dhe Mjedë, kosto e llogaritur: 2.250.000 euro;
- Zbatimi i projektit për mbjelljen e 150 ha shegë në zona kodrinore, në 6-të fshatra me nga 25 ha në bllok, kosto: 610.000 euro investime private, 20.000 euro shpenzime të bashkisë.

Kërkesa financiare që lind për realizimin e këtyre veprave arrin deri në një total të barabartë me 20.710.000 euro. Ky shpenzim mund të mbulohet vetëm pjesërisht nga fondet e disponueshme të bashkisë.

Parashikimi i buxhetit për dyvjeçarin e ardhshëm tregon një rritje të lehtë të këtyre fondeve, dhe supozohet që një rritje e tillë të konfirmohet për pesëvjeçarin e ardhshëm dhe në vitet e mëpasme. Natyrisht, do të jetë bashkia ajo që vendos sasinë e këtyre fondeve që do të shkojnë për realizimin e projekteve pilot.

Në tabelat në vijim paraqitet Plani i Veprimit i PPV të bashkisë Vau Dejës:

Raport i Përmbledhur

Tabela 11: Plani i veprimit, Projektet e zhvillimi

PLANI I VEPRIMIT - PROJEKTET E ZHVILLIMIT – BASHKIA VAU-DEJËS										
OBJEKTIVI STRATEGJIK NR.1: PAJISJA ME SHËRBIMET BAZË										
Nr.	Emërtimi i Projektit	Territori që preket. Njësitë administrative	Grupet (komuniteti) që preken	Vlera e projektit	Vlera e parashikuar në PBA (2018-20)	Burimet e mundshme të Financimit	Tregues vlerësimi (monitorimi)	Përgjegjës për zbatimin e projektit	Fazat e zbatimit	
Programi: 1.1 Përmirësimi i rrjeteve teknike										
1.1.1	Përmirësimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale	Të gjitha njësitë administrative	Komuniteti vendor Turistët Operatorët tregtarë Sipërmarrje bujqësore Sipërmarrje turistike	15.350.000 euro	8.061.207 euro	Fondet e bashkisë Kontribute nga programet e ndihmave ndërkombëtare FSHZH, IPA II dhe AICS	Fazat e realizimit të punimeve Aksesueshmëria numri i automjeteve në transit Cilësia e ujërave	Bashkia Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës ARRSH Ministria e Zhvillimit Urban		
1.1.2	Mirëmbajtja dhe zhvillimi i rrjetit të furnizimit me ujë	Të gjitha njësitë administrative		1.400.000 euro	68.076 euro					
1.1.3	Përmirësimi dhe zhvillimi i sistemit të kanalizimeve	Bushat, Vau-Dejës, Hajmel		600.000 euro	-					
1.1.4	Sistemi i pastrimit të ujërave të zeza me gropa septike në zonat periferike	Shllak, Temal, Vig-Mnelë		250.000 euro	184.615 euro					
Programi: 1.2 Ruajtja e peizazhit dhe siguria e territorit										
1.2.1	Sistemi për mbledhjen e mbejeve të ngurta urbane	Të gjitha njësitë administrative	Komuniteti vendor Turistët Operatorët tregtarë Sipërmarrje bujqësore Sipërmarrje turistike	250.000 euro në vit	-	Fondet e bashkisë AZHR1 Kontribute nga programet e ndihmave ndërkombëtare FSHZH, IPA II dhe AICS	Fazat e realizimit të punimeve Niveli i ndotjes së ambientit Cilësia e ujërave	Bashkia Ministria e Zhvillimit Urban		
1.2.2	Pastrimit të rrugëve të qytetit	Bushat, Vau-Dejës, Hajmel		150.000 euro në vit	352.000 euro					
1.2.3	Realizimi i veprave për mbrojtjen e qendrave të banuara nga përmytjet dhe erozioni	Vig-Mnelë, Bushat, Hajmel, Vau-Dejës		350.000 euro	-					
Programi: 1.3 Shërbimet publike										
1.3.1	Shërbimet bazë (kopshte, shkolla fillore, qendrat shëndetësore bazë, kujdesi për të moshuarit)	Të gjitha njësitë administrative	Komuniteti vendor	11.000.000 euro	8.282.538 euro	Fondet e bashkisë AZHR1 Kontribute nga programet e ndihmave ndërkombëtare FSHZH, IPA II dhe AICS	Fazat e realizimit të punimeve Sondazhe të qytetarëve	Bashkia Ministria e Zhvillimit Urban		
1.3.2	Shërbimi i autobusëve shkollor	Të gjitha njësitë administrative		100.000 euro në vit	-					
1.3.3	Përmirësimi i shërbimeve administrative të ofruara	Të gjitha njësitë administrative		1.000.000 euro në vit	3.432.563 euro					
1.3.4	Qyteti mik i fëmijëve	Të gjitha njësitë administrative		80.000 euro në vit	270.931 euro					

Raport i Përmbledhur

OBJEKTIVI STRATEGJIK NR.2: LËVIZJA ME MËNYRA TË NDRYSHME										
Nr.	Emërtimi i Projektit	Territori që preket. Njësitë administrative	Grupet (komuniteti) që preken	Vlera e projektit	Vlera e parashikuar në PBA	Burimet e mundshme të Financimit	Tregues vlerësimi (monitorimi)	Përgjegjës për zbatimin e projektit	Fazat e zbatimit	
Programi: 2.1 Rrugët automobilistike										
2.1.1	Përmirësimi i rrugës Shkodër-Pukë-Kukës	Vau-Dejës, Vig-Mnelë, Bashkitë Pukë, Shkodër	Komuniteti lokal Turistët Operatorët tregtarë Sipërmarrje bujqësore Sipërmarrje turistike Sipërmarrjet e minierave	8.000.000 euro	-	Fondet e bashkisë AZHR 1 Kontribute nga programet e ndihmave ndërkombëtarë FSHZH, (programi rrugë sekondare dhe lokale), IPA II dhe AICS	Fazat e realizimit të punimeve Numri i automjeteve në transit	Bashkia Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës ARRSH		
2.1.2	Përmirësimi i rrugës përgjatë rrezës së maleve	Vau-Dejës, Hajmel		1.000.000 euro	-					
249	P10.F2.O1.A1	Ndërrim i çatave të shtëpive me eternity	3,031	3.3.1
250	P10.F2.O1.A2	Pallate sociale Vau-Dejës	3,006,185	-
251	P10.F3.O1.A1	Ndërtim i poliklinikës në qytetin e Vau-Dejës me shërbim 24 orë	410,000	1.3.1
252	P10.F3.O1.A2	Rikonstruksion i Qendrës shëndetësorë në Pleshë	36,154	1.3.1
253	P10.F3.O1.A3	Rikonstruksion i Qendrës shëndetësorë në Bushat	36,154	1.3.1
254	P10.F3.O1.A4	Rikonstruksion i Qendrës shëndetësorë në Hajmel	50,769	1.3.1
255	P10.F3.O1.A5	Rikonstruksion i Qendrës shëndetësorë në Nenshat	43,077	1.3.1
256	P10.F3.O1.A6	Ndërtim i qendrës shëndetësorë në Benë	16,923	1.3.1
257	P10.F3.O1.A7	Rikonstruksion i Qendrës shëndetësorë në Melgushe	20,000	1.3.1
258	P10.F3.O1.A8	Rikonstruksion i Qendrës shëndetësorë në Koman	15,385	1.3.1
259	P10.F3.O1.A9	Rikonstruksion i Qendrës shëndetësorë në Paçram	20,000	1.3.1
260	P10.F3.O1.A10	Rikonstruksion i Qendrës shëndetësorë në Pistull	16,923	1.3.1
261	P10.F3.O1.A11	Rikonstruksion i Qendrës shëndetësorë në Naraç	17,692	1.3.1
262	P10.F3.O1.A12	Rikonstruksion i Qendrës shëndetësorë në Kosmaç	23,077	1.3.1
263	P10.F3.O1.A13	Rikonstruksion i Qendrës shëndetësorë në Stajkë	37,692	1.3.1
264	P10.F3.O1.A14	Përmirësim i kushteve dhe pajisja me mjete në Qendrën shëndetësore Vig-Mnelë	7,692	1.3.1

4 PLANI I ZHVILLIMIT

4.1 Plani i propozimeve territoriale

4.1.1 Ndarja e territorit sipas 5 sistemeve bazë

Strategjia territoriale ka për qëllim zhvillimin e qëndrueshëm dhe të balancuar të territorit të Bashkisë Vau-Dejës. Objektivat strategjike të përcaktuara në aksin e prioriteteve dhe politikave, sipas radhës, përkthehen në projekte dhe ndërhyrje specifike. Ndërhyrjet e propozuara mund të shoqërohen me ndryshime në masën dhe gjendjen e sistemeve ekzistuese territoriale. Në shumicën e rasteve, ndryshimet në sistemet territoriale korrespondojnë direkt me objektivin e ndërhyrjes dhe mund të shërbejnë:

- Në ruajtjen / mbrojtjen e mëtejshme të sistemit territorial;
- Zgjidhjen e “konflikteve” midis sistemeve territoriale;
- Sigurimin e pajtueshmërisë/plotësueshmërisë midis sistemeve territoriale.

Tabela 13: Ndikimi i PPV në 5 sistemet bazë territoriale

SISTEMI I PËRDORIMIT TË TOKËS	Sipërfaqja ekzistuese(në %)	Sipërfaqja e vlerësuar pas aplikimit të projekteve të propozuara (në %)
Sistemi Natyror	68.89%	69.27%
Sistemi Ujor	5.1%	5.1%
Sistemi Bujqësor	19.52%	21.33%
Sistemi Urban	5.95%	3.72%
Sistemi territorial infrastrukturor	0.52%	0.56%
Total	100%	100%

Ndryshimet, si në territorin natyror dhe atë bujqësor kanë ardhur kryesisht nga tendenca për të sistemuar sipërfaqen e Sistemit Urban të bazuar fillimisht në Vendimin Nr. 5 të KKT, Datë 29.12.2014 dhe për ta përshtatur shpërhapjen urbane me konceptin e hedhur në Strategjinë Territoriale.

Sipërfaqja e territorit urban është reduktuar ndjeshëm, duke shmangur shtrirjen e panevojshme në territor dhe duke propozuar struktura të përqëndruara të mirëpajisura me infrastrukturë. Ky fakt ndihmon edhe në ruajtjen e tokës bujqësore dhe natyrës.

4.1.2 Ndarja e territorit në njësi zhvillimi

4.1.2.1 Morfologjitë urbane

Në zona urbane sipas vendimitnr.5 i datës 29.12.2014 i Këshillit Kombëtar të Territorit, gjenden lloje të ndryshme morfologjishë urbane, të cilat mund të jenë objekt i politikave të përshtatshme të ndërhyrjeve, të diferencuara sipas mjedisit në të cilin ndodhen. Me fjalë të tjera, nga mbivendosja e llojeve të ndryshme të tipologjive urbane me pesë sistemet bazë, do të jetë i mundur artikulimi i rregullave të administrimit për zona të veçanta.

Bazuar në karakteristikat morfologjike të sistemit urban si dhe në peizazhin përkatës, ndërhyrjet kryesore të PPV bazohen në klasifikimin e mëposhtëm:

URB

Njohje e karakterit qendror urban, mundësi për dendësim të ndërtimit, përshtatje e rrjeteve teknike, përshtatje dhe zhvillim i shërbimeve urbane dytësore dhe tretësore. Identifikohen tri nënzona me tregues të ndryshëm zhvillimi:

- URB.01dendësim intensiv (qendrat kryesore: Bushat, Vau-Dejës);
- URB.02dendësim mesatar (qendrat dytësore: Hajmel, Mjedë, Barbullush, etj.);
- URB.03dendësim i ulët (qendrat tretësore: Ashtë, Paçram, etj.).

ESP

Njohje e karakterit periferik urban, mundësi ristrukturimi urbanistik, përshtatje e rrjeteve teknike dhe pajisjen me shërbime urbane bazë.

- ESP.01 Zgjerim intensiv (zgjerimi i qendrave kryesore).

RUR

Njohje e kushteve rurale të jetesës (larg qendrave urbane) dhe mungesë e shërbimeve urbane dytësore, mundësi ndërtimi me tregues mesatarë dhe të ulët zhvillimi dhe ristrukturim/zgjerim për ndërtesat ekzistuese, përshtatje e rrjeteve teknike dhe pajisjen me shërbime urbane bazë. Identifikohen dy nënzona:

- RUR.01Vendbanim rural mesatarisht i përqëndruar dhe zgjerimi i fshatrave kryesore, me tregues mesatar zhvillimi;
- RUR.02Vendbanim rural i shpërhapur me tregues të ulët zhvillimi.

AGR

Njohje e vendbanimeve tradicionale në zona kodrinore dhe malore në territor bujqësor. Lejohet ndërtimi i banesave individuale/një-familjare, për qëllime primare strehimi, me tregues shumë të ulët zhvillimi si dhe mirëmbajtja e zakonshme dhe e jashtëzakonshme e objekteve ekzistuese. Lejohet edhe ndërtimi i objekte në funksion të prodhimit, ruajtjes dhe përpunimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale.

- AGR.01 Ndërtime në zona kodrinore dhe malore të realizuara në tokë bujqësore .

IND

Njohje e vendosjeve industriale ekzistuese, përshtatje e rrjeteve infrastrukturore dhe ndërhyrje për racionalizimin dhe organizimin urbanistik.

- IND.01 Industri e lehtë, e mesme dhe e rëndë

Këto përcaktime janë përdorur edhe për ndarjen e territorit në zona e më pas në njësi strukturore.

4.1.3 Rrjeti i infrastrukturave

Vau-Dejës dhe Bushat, janë qendrat më me peshë në lidhje me vendbanimet e tjera, të cilat kanë një endje urbane të dallueshme. Një rol të ngjashëm luajnë edhe fshatrat Hajmel, Barbullush, Nënshatë, Rranxë e Mjedë. Barbullushi është aktualisht fshati më i madh i territorit. Mjeda përkon me stacionin hekurudhor, që do të shndërrohet në një kryesore të zhvillimit të lëvizjes multimodale në territor. Hajmeli e Nënshati përkrijnë me një territor me aktivitet bujqësor intensiv, shtrirë përgjatë aksit historik të komunikimit Shkodër – Lezhë (rruga rrëzëmalore) si dhe me vlera të trashëgimisë historike e kulturore.

Kuptohet, më i rëndësishmi mbetet qyteti i Vau-Dejës si qendër urbane dhe historike me rëndësi të veçantë, ku dhe janë vendosur zyrat e bashkisë dhe shërbimet kryesore. Gjithësesi edhe Bushati është një qendër mjaft e rëndësishme si për nga numri i popullsisë, ashtu edhe për nga aktiviteti ekonomik.

4.1.4 Zonat e rëndësisë kombëtare

Duke konsideruar pozicionin strategjik të Bashkisë Vau-Dejës, kemi prani të një numri të konsiderueshëm zonash me rëndësi kombëtare:

- Rruga nacionale Lezhë – Shkodër;
- Rruga nacionale Pukë – Shkodër;
- Aksi hekurudhor Lezhë – Shkodër;
- Itinerari i lundrueshëm Koman – Fierzë (Liqeni i Komanit);
- Centrali Hidro-Elektrik i Vau-Dejës;
- Centrali Hidro-Elektrik i Komanit;
- Centralet Hidro-Elektrike të Ashtës (Ashta 1 dhe 2);
- Zona arkeologjike e Komanit;
- Peizazhi i mbrojtur Lumi Buna – Velipojë;
- Monumentet e natyrës;
- Monumentet e kulturës.

PPV parashikon ruajtjen e zonave me rëndësi kombëtare, zgjerimin e tyre si dhe identifikimin dhe shpalljen si të tilla të zonave të reja. Konkretisht për territorin e Bashkisë Vau-Dejës propozohet:

- Ruajtja e të gjitha zonave me rëndësi kombëtare ekzistuese;
- Zhvillimi i parkut arkeologjik në Koman;
- Krijimi i parkut natyror rajonal i luginës së Drinit (Shtrirje tokësore 10.000 ha);
- Mbrojtje e korridoreve të gjelbërta përgjatë rrjedhave ujore, sipas përcaktimeve të PPV;
- Zhvendosja e pjesshme dhe zhvillimi i aksit rrugor Lezhë – Shkodër;
- Reabilitimi i rrjetit hekurudhor.

4.1.5 Zonat prioritare të zhvillimit ekonomik dhe urban

Territori i Bashkisë Vau-Dejës, në përputhje edhe me vizionin strategjik, është parë si një territor, që i duhet rikthyer traditave ekonomike të mira dhe solide, duke ruajtur karakteristikën e tij si territor tranzitimi, marrëdhëniesh, lëvizjesh dhe shkëmbimesh. Kjo duke u mbështetur tek aktivitetet që prodhojnë punësim dhe të ardhura, por njëkohësisht sigurojnë zhvillim të qëndrueshëm të resurseve lokale.

Rol vendimtar në realizimin e vizionit dhe zbatimin e objektivave strategjike luajnë zonat kryesore ekonomike dhe të banimit. Në to janë përqëndruar pjesa më e madhe e popullsisë dhe aktiviteteve ekonomike. Propozohet që këto zona të jenë të shumëllojshme, me karakter dhe intensitet të ndryshëm, që të sigurohet një zhvillim sa më fleksibël që i përshkruan sfidave të së ardhmes duke qenë elastike ndaj ndryshimeve të mëdha të mundshme.

Në përputhje me prioritetet e PPV, zonat prioritare të zhvillimit ekonomik dhe urban janë:

- Qendrat e zonave urbane Vau-Dejës, Bushat, Hajmel, Barbullush;
- Zonat që preken nga projektet pilot/prioritare;
- Poli i transportit multimodal Vau-Dejës – Mjedë;
- Poli i shërbimeve bujqësore Bushat – Rranxë;
- Zona ekonomike në Bushat (përgjatë aksit të sotëm rrugor Lezhë – Shkodër);
- Zona arkeologjike e Komanit;
- Itinerari turistik Sapë – Danjë – Sardë – Koman;
- Itinerari vozitës Ishulli i Bojanës – Lumi Buna – Vau-Dejës – Koman – Fierzë.

Pikërisht këto prioritete i përkasin edhe zhvillimit ekonomik-urban të bashkisë në vitet e ardhshme, duke konkretizuar vendimet strategjike të PPV.

4.1.6 Planet e detajuara vendore (PDV)

Në Bashkinë Vau-Dejës, objektivi kryesor i hartimit të PDV është zhvillimi cilësor i hapësirës urbane, me ndjeshmëri të lartë kundrejt kontekstit dhe me vizion të qëndrueshëm për të ardhmen. Kryesisht PDV do të jenë instrumente zhvillimi në:

- Zona të trashëgimisë historike dhe kulturore;
- Zona me asete ambientale dhe peizazhistike;
- Zona të ekspansionit turistik;
- Zonat e reja urbane të ekspansionit;
- Zonat informale;
- Zonat që preken nga infrastrukturat e rëndësishme kombëtare.

Gjithashtu, njësitë për të cilat hartohet PDV-ja janë ato në të cilat është i nevojshëm organizimi i hapësirave dhe sigurimi i infrastrukturave të nevojshme që sipas PPV-së parashikohet të kenë:

- Zhvillim dhe/ose rihvillim;
- Ndryshim të përdorimit të tokës dhe kushteve të zhvillimit;
- Investime publike që ndikojnë në ndryshimin ose rishpërndarjen e treguesve të zhvillimit;
- Programe të transferimit të së drejtës për zhvillim dhe të intensitetit me kushte.

Zhvillimi përmes Planit të Detajuar Vendor lidhet me njësi të cilat i përkasin dy zonave me orientime të ndryshme: zona ekonomike dhe zona të zhvillimit të banimit. Këto të fundit ndodhen kryesisht në vazhdim të qendrave të qyteteve dhe në zonat e parashikuara për ndërtime sociale.

4.1.7 Shpërndarja e popullsisë në territor

Aktualisht lëvizjet e popullsisë nga zonat rurale apo të largëta drejt qytetit dhe zonave fushore brenda bashkisë së re të Vau-Dejës, duket se janë stabilizuar; edhe pjesa më e madhe e zonave të banuara tregojnë tendencë drejt konsolidimit.

Parashikimi i popullsisë i propozuar nga ky studim, tenton një rrugë të mesme mes të dhënave të INSTAT dhe atyre të regjistrit të Gjendjes Civile të Vau-Dejës. Pavarësisht të dhënave kundërshtuese mbi popullsinë në dispozicion, përfundimisht shfaqet i pritshëm një skenar zhvillimi i aftë për të garantuar një rritje të popullsisë prej 0,15% në vit.

Për rrjedhojë, popullsia e Vau-Dejës është e parashikueshme, për vitin 2032, midis një vlere prej 31.200 deri në 50.500 banorë, me një mesatare të pranueshme prej 41.000 persona.

Tabela 14: Projektioni i popullsisë sipas njësive administrative

Njësia administrative	Bushat	Hajmel	Shllak	Temal	Vau-Dejës	Vig Mnele	Total
CENSUS INSTAT 2011	14149	4430	671	1562	8117	1509	30.438
Të dhënat e zyrës së regjistrimit 2015	23.834	6300	1899	2520	12669	2177	49399
Parashikimet e rritjes në 2030	19.059	5967	904	2104	10.934	2033	41.000
Variacioni neto INSTAT 2011	4910	1537	233	542	2817	524	10562
Variacioni neto sipas zyrës së regjistrimit 2015	-4.775	-333	-995	-416	-1735	-144	-8.399

4.1.8 Plani i strehimit

Popullsia e konsideruar për strehim është 41.000 banorë, të cilët shpërndahen në gjithë territorin sipas projeksioneve të popullsisë. Këtu përfshihet strehimi në banesa private si dhe strehimi social.

Në Bashkinë Vau-Dejës rreth 23.4% e banesave janë të pabanuara; nga këto 7.3% janë shtëpi të dyta ose me përdorim të përkohëshëm, si shtëpi pushimi veror ose malor. Gjithësesi shifrat për sipërfaqen e ndërtuar janë ende larg parashikimeve të planit (14.4 m²/banor nga 25 m²/banor të planifikuara). Në këtë kuadër, shtimi i numrit të banesave është një domosdoshmëri për vitet e ardhëshme në funksion të rritjes së cilësisë së jetës.

Në tërësinë e tij, stoku i banesave në Bashkinë Vau-Dejës ka nevojë për një riaftësim të ndërtesave, qoftë në aspektin ndërtimor ashtu edhe në aspektet estetike, teknologjike dhe në performancën e energjisë.

Në zonat e ekspansionit të qytetit janë planifikuar zona për ndërtimin e banesave sociale që do të mundësojnë strehimin e personave në pamundësi ekonomike. Këto zona do të zhvillohen në terrene kryesisht me pronësi publike, duke krijuar mundësinë e kostove të

reduktuara të ndërtimit për banesat sociale. Gjithashtu, do të shihet mundësia e përshtatjes së ndërtesave publike të braktisura (rast pas rasti) dhe shndërrimi i tyre në banesa sociale.

Njëkohësisht në terrenet në pronësi publike në qendrat kryesore të bashkisë, do të kryhet transferimi i banorëve nga zonat me rrezik të lartë përmbajtjeje nëpërmjet *transferimit të së drejtës për zhvillim*.

4.2 Plani i shërbimeve dhe infrastrukturave publike

4.2.1 Infrastruktura publike

Si ndërhyrje të rëndësishme në infrastrukturë vlen të përmendim stacionin multimodal të Mjedës, që është ndër projektet më ambicioze dhe me impakt më të lartë. Objektivi i këtij projekti është realizimi i një qendre logjistike të integruar, që përmbledh tipologji të ndryshme transportesh, e tillë që të optimizojë grumbullimin dhe shpërndarjen e mallrave në hyrje dhe dalje. Ky projekt mund të financohet me fonde private (Project Financing) dhe publike (Ministria e Infrastrukturës) me mundësi bashkëfinancimi me BE, Programi IPA II.

Stacioni do të përfshijë aksesin nëpërmjet infrastrukturës hekurudhore dhe rrugore si dhe parashikon mundësinë e lidhjes me transportin lumor përgjatë lumenjve Drin dhe Buna nëpërmjet porteve lumore në Vau-Dejës dhe Ashtë. Nëpërmjet këtij projekti, poli urban Vau-Dejës - Mjedë kthehet në një nyje të rëndësishme të rajonit ekonomik Shkodër – Lezhë, duke shfrytëzuar më së miri pozicionin strategjik dhe aksesin në infrastrukturë.

Një tjetër pjesë me rëndësi e ndërhyrjeve në infrastrukturë është propozimi strategjik për krijimin e koridorit lundruar lumor si një mënyrë e lidhjes së territorit përgjatë lumit Drin, në mënyrë të kujdesshme ndaj mjedisit dhe duke i dhënë theksin morfologjik propozimeve konkrete për menaxhimin e territorit.

Funksioni i këtij koridori është të rrisë lidhjen ekologjike midis Parkut të Alpeve dhe Peizazhit të Mbrojtur të Bunës, duke e shoqëruar këtë funksion kryesor me ndërtimin e një sistemi transporti lokal me impakt të ulët, për të siguruar aksesin në vendbanimet malore dhe në destinacionet kryesore turistike në zonë.

Një tjetër projekt i rëndësishëm, megjithëse jo imediat, është trajtimi biologjik i ujërave të zeza të fshatrave në zonat e thella malore të Vig-Mnelës, Shllakut dhe Temalit, të cilët aktualisht kanë mungese totale kanalizimesh, që është zgjidhur me gropa septike individuale, të hapura shpesh pa kriter.

4.2.1.1 Infrastruktura e transportit dhe transporti publik

Në Bashkinë Vau-Dejës propozohet kthimi i rrugës Tiranë – Hani Hotit në rrugë të kategorisë A, duke e devijuar si segment në zonën nga kryqëzimi i Bushatit në drejtim të kufirit me Shkodrën. Me devijimin e kësaj pjese, segmenti egzistues do funksionojë kryesisht si rrugë shërbimesh për zonën industriale të formuar në dy anët e tij. Në të dy anët e rrugës ekzistuese propozohet të shtohen, breza të gjelbëruar me gjerësi 10m, trotuare nga 2m dhe një pistë biçikletash me gjerësi 3m. Këto përmirësime do të shërbejnë për të aksesuar më lehtë zonën industriale në të dy krahët e rrugës.



Fig. 10: Rruga industriale nga kryqëzimi i Bushati drejt kufirit me Shkodrën

Gjithashtu, devijime të rrugëve (bypass), me qëllim evitim të kalimit tranzit përmes qendrave urbane, propozohen edhe në Vau-Dejës, Bushat, Mjedë, Barbullush dhe Rranxë.

Plani i përgjithshëm vendor për Bashkinë Vau-Dejës, synon të promovojë lëvizjen e qëndrueshme dhe në harmoni më mjedisin. Në funksion të kësaj është propozuar dhe lidhje e territorit me pista biçikletash si dhe realizimi i një koridori të gjelbër në Bashkinë Vau-Dejës përgjatë lumit Gjadër. Më poshtë jepen disa prerje tipike:




Fig. 11: Korridor i gjelbër




Fig. 12: Pista për biçikleta

Përsa i përket lëvizjes së banorëve, sugjerohet përdorimi i transportit publik nëpërmjet disa linjave të propozuara urbane. Konkretisht:

- Linja 1 (Vau-Dejës – Hajmel – Pistull – Bushat – Stajkë – Mjedë – Vau-Dejës);
- Linja 2 (Bushat – Barbullush – Kukël – Fshat i Ri – Rranxë – Melgushë – Ashtë – Bushat);
- Linja 3 (Fillon në Nënshatë – Hajmel - Vau-Dejës – Karmë dhe përfundon në Koman);
- Linja 4 (Vau-Dejës – Mnelë e Madhe - Vig);
- Linja 5 (Koman – Ukbibaj);
- Linja e tragetit Vau-Dejës – Koman;
- Linja e tragetit Koman – Fierzë.

4.2.2 Shërbimet sociale, tipologjia dhe rrezet e mbulimit

Në shpërndarjen e shërbimeve sipas PPV, është synuar mjaftueshmëria e strukturave të dobisë dhe përdorimit të përbashkët që do t'ju shërbejnë sa më shumë vendbanimeve si dhe përmirësimit të nivelit të shërbimeve sociale.

Rrezet e mbulimit

Për çerdhet përcaktohet rrezja 200-300 m, për kopshtet 250-350m (zonat urbane) dhe 500-600m (zonat rurale), për shkollat 9-vjeçare 500-600m (zonat urbane) dhe 1000-1500 m (zonat rurale) dhe për shkollat e mesme 1000-1500m (zonat urbane) dhe 2000-4500m (zonat rurale).

Është e qartë që në kushtet e shpërhapjes urbane me dendësi shumë të ulët, rrezet e shërbimit funksionojnë mirëfillti vetëm në qendrat urbane, kurse për territoret me intensitet të ulët numri i objekteve të shërbimit është në bazë popullsie ekzistuese dhe të parashikuar.

4.3 Monitorimi dhe rishikimi i planit të zhvillimit

Drejtoritë specifike pranë Bashkisë Vau-Dejës kanë përgjegjësinë për zbatimin e politikave të përcaktuara në dokumentin e Strategjisë së Zhvillimit. Njëkohësisht, në mënyrë sistematike duhet bërë monitorimi i zbatimit të strategjisë dhe të planit prej vetë bashkisë.

Bashkitë kanë detyrim ligjor të hartojnë një raport vjetor në lidhje me zhvillimin e territorit. Në varësi të rezultateve të monitorimit, mund që më pas të bëhet ndryshimi dhe alternimi i politikave dhe programeve për t'iu përgjigjur dinamikave të reja.

PPV ndryshon kur ka ndryshime të paparashikuara demografike, sociale dhe ekonomike, ndryshime të shkaktuara nga kriza sektoriale apo nga forca madhore, si dhe në rastet kur lind nevoja e harmonizimit me dokumente të një niveli më të lartë planifikimi.

PPV është një mekanizëm zhvillimi fleksibël, i cili ka për qëllim orientimin e politikave të përgjithshme të zhvillimit. Në këtë optikë, PPV mund të pësojë ndryshime dhe rishikime gjatë kohës në përshtatje me nevojat e zhvillimit dhe me kushtet e paraqitura në momentin e kërkesës për rishikim. Rastet kryesore kur lind nevoja për rishikimin e PPV janë:

- Rishikim për interesa madhore apo kombëtare;
- Rishikim për mospërputhje me legjislacionin;
- Rishikim në kuadër të ndryshimeve në PPKT, Planeve Kombëtare Sektoriale si dhe strategjive kombëtare të zhvillimit;
- Rishikim si pasojë e ndryshimit të kufinjve administrativë të bashkisë;
- Rishikim në kushte të jashtëzakonshme (fatkeqësi natyrore, emergjenca civile);
- Rishikim në raste të tjera të paparashikuara që krijojnë një problem madhor në zbatimin e strategjisë territoriale dhe të zhvillimit.

Në çdo rast, rishikimi i planit nuk është i mundur nëse:

- Bie në kundërshtim me objektivat e zhvillimit dhe ato strategjike si dhe me konceptet bazë të përcaktuara në dokumentin e Strategjisë Territoriale;
- Ndërhyn duke bërë ndryshime në zona ku shtrihet mbi 10 % e territorit apo ku vendoset mbi 10 % e popullsisë.

Në rast se ndërhyrje të tilla janë të nevojshme, atëherë nevojitet hartimi i një PPV të ri, i cili i përgjigjet nevojave të reja për zhvillimin e territorit dhe të ekonomisë në Bashkinë Vau-Dejës.

Çdo rishikim i PPV bëhet pasi dokumentohet nevoja për rishikim, pasi realizohen dëgjesa publike dhe pasi konsultohen ekspertë të fushave përkatëse. Mbështetur në këtë proces, kryetari i bashkisë mund të iniciojë rishikimin e PPV, duke ndjekur të gjitha hapat ligjore të nevojshme.

5 RREGULLORJA VENDORE

Rregullorja Vendore hartohet paralelisht me Planin e Zhvillimit, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe rregulla specifike lokale. Ky dokument përmban të gjitha rregullat teknike mbi mënyrën se si do të zhvillohet territori i bashkisë në përputhje me parashikimet e planit.

Rregullorja është një dokument integral i cili, nga momenti i miratimit, do të ketë vlerë ligjore dhe si i tillë duhet konsideruar në tërësinë e tij. Më poshtë janë listuar disa nga parashikimet më të rëndësishme të rregullores që vlen të përmenden në këtë raport përmbledhës.

5.1 Treguesit e zhvillimit

5.1.1 Intensiteti i ndërtimit

Intensiteti i ndërtimit (**I**) i përcaktuar për çdo njësi/zonë, për çdo nënkategori përdorimi, i aplikueshëm për çdo parcelë që bën pjesë në këtë njësi është i barabartë me raportin e sipërfaqes së përgjithshme të pritshme të ndërtimit në parcelë me sipërfaqen e parcelës së ndërtueshme, ose:

$$I = \frac{S_n}{S_p}$$

ku S_n është sipërfaqja e ndërtimit të një objekti i dhe është e barabartë me shumën e sipërfaqeve të ndërtuara në çdo kat mbi tokë të ndërtimit;

S_p është sipërfaqja e parcelës së ndërtueshme.

Për njësitë të cilat nuk do t'i nënshtrohen PDV-së, intensiteti i ndërtimit për parcelë (**I**) është i njëjtë me intensitetin e ndërtimit për njësi. Ai përcaktohet nga raporti i gjithë sipërfaqes së ndërtimit në një **parcelë të ndërtueshme** me sipërfaqen e parcelës së ndërtueshme. Për njësinë/grup-njësitë/zonën që do t'i nënshtrohen hartimit të PDV-së, intensiteti në nivel njësie/zone jepet në PPV. Ndërkohë, hartimi i PDV-së do të riorganizojë parcelat e ndërtueshme brenda njësisë/zonës dhe për pasojë intensiteti në nivel parcele të ndërtueshme jepen në dokumentin e PDV-së.

5.1.2 Kufizime sektoriale

Burimet Ujore: sipas legjislacionit të posaçëm për menaxhimin e integruar të ujërave¹

Zonat e mbrojtura: Distanca bazuar në ligjet sektoriale për zonat e mbrojtura dhe në planin e menaxhimit të zonave të mbrojtura;

Zonat arkeologjike: 200m;

Qendrave Historike: 20m;

Varreza: 300 m;

Zona Industriale: Kategoria I=700m; Kategoria II=500m; Kategoria III=300m; Kategoria IV=100m; Kategoria V=50m;

¹Ligji 111/2012, datë 15.11.2012 dhe aktet nënligjore përkatëse.

Linjat Elektrike²: 6-10kv=2m; 35-110kv=4m; 150kv=5m; 220kv=6m; 330kv=8m; 400kv=10m;

Gjithsesi, në zonat që bien brënda kufizimeve sektoriale mund të lejohen këto ndërhyrje:

- Rugëkalime për këmbësorët dhe korsi për bicikletat;
- Gjelbërimi publik ose privat;
- Vend – parkimet;
- Shërbime ambulante;
- Sipërfaqet e hapura sportive.

Në parcelat që janë pjesërisht të përfshira në zonat me kufizime do të jetë e ndërtueshme vetëm ajo pjesë e cila nuk përfshihet në zonën e kufizuar (nëse kjo pjesë ka sipërfaqe më të madhe se sa sipërfaqja minimale e kërkuar për një parcelë). Intensiteti i ndërtimit llogaritet vetëm për pjesën e ndërtueshme.

5.2 Rregulla të përbashkëta për ndërtimet

5.2.1 Qendrat urbane

Ndërtimet e reja, rikonstruksionet dhe ndërhyrjet në infrastrukturën publike duhet të kenë në qendër të vëmendjes ruajtjen e elementeve urbane dhe arkitektonike përfaqësues të zonës urbane/rurale ku ndodhen si dhe mbrojtjen e peizazhit. Në qendrat e qyteteve si dhe në zona me rëndësi të veçantë, propozimet arkitektonike këshillohet t'i nënshtrohen konkursit, në mënyrë që të përzgjidhen propozimet më të mira për zhvillimet e reja.

Sistemet teknike të ndërtesës (instalime elektrike, depozita uji, kondicionerë, panelet diellore etj.) duhet të jenë të integruara në brendësi të ndërtesës, duke mos u ekspozuar në fasadë.

5.2.2 Efikasiteti energjetik

Projektimi dhe zbatimi i ndërtimeve të reja duhet të konsiderojë detajet arkitektonike të përshtatshme për ruajtjen e energjisë në ndërtesa. Këtu, kujdes i veçantë duhet pasur për orientimin e ndërtesave, termoizolimimin e tyre dhe ventilimin natyror.

5.2.3 Monumentet e kulturës dhe ato historike

Mbrojtja e monumenteve është e nevojshme për trashëgiminë historike dhe arkitektonike të Bashkisë Vau-Dejës. Mbrojtja e monumenteve bëhet në përputhje me ligjin Nr. 9048, datë 07.04, 2003 "Për trashëgiminë kulturore". Të gjitha ndërhyrjet (ndryshime, mirëmbajtje apo restaurime) të objekteve të trashëgimisë duhet të bëhen pasi të jetë marrë leja nga autoritetet kompetente me përgjegjësi ligjore për këto ndërhyrje.

Njësitë që kanë në brendësi të tyre monumente kulturore, apo që ndodhen në një distancë më të vogël se 100 m nga to, janë të përcaktuara në pasaportat përkatëse dhe mënyra e ndërhyrjes në këto njësi përcaktohet në Rregulloren Lokale. Të gjitha ndërhyrjet në njësi duhet të paraprihen nga hartimi i PDV-së, në të cilën duhet të përcaktohet zona e mbrojtjes së monumentit.

² Nuk lejohen në mënyrë kategorike ndërtimi i objekteve nën linjën e transmetimit elektrik ajror

5.2.4 Bimësia në zonat urbane

Ruajtja, zhvillimi dhe shpërndarja e bimësisë, si në pronat private dhe në ato publike, njihen si faktorë kualifikues urban-mjedisor. Bashkia mund të detyrojë mbjelljen e pemëve, shkurreve, gardheve dhe/ose krijimin e sipërfaqeve të pyllëzuara në pronat private që kufizohen me hapësirat publike.

5.2.5 Hapësira dhe përmirësimi i standardeve mjedisore

Njësitë të cilat do t'i nënshtrohen ndërhyrjes rizhvillim/konsolidim/dendësim nëpërmjet PDV-së ose jo, duhet të mbajnë parasysh përcaktimet e legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe raportin e VSM-së që shoqëron PPV-në. VSM sugjeron veprime konkrete për shtimin e hapësirave të gjelbërta dhe përmirësimin e mjedisit, të cilat duhet të merren parasysh gjatë ndërhyrjeve në territor.

Hartimi i PDV-ve do të shoqërohet dhe mbështetet në raportin e VNM-së të hartuar si dokument përbërës i saj. Në lidhje me përmirësimin e standardeve mjedisore, duhet të merren në konsideratë masat e mëposhtme:

- Krijimi i parqeve të reja periferike;
- Krijimi i korridoreve të reja të gjelbra dhe përmirësimi i kushteve ekologjike në korridoret ekzistuese;
- Krijimi i lulishteve qendrore të reja dhe përmirësimi i atyre ekzistuese;
- Shtim gjelbërimi brenda blloqeve ekzistuese të banimit dhe në ato që do të krijohen;
- Gjëlberim i maksimizuar brenda parcelave të ndërtueshme;
- Gjëlberimi me pemë dhe shkurre dekorative përgjatë rrugëve dhe trotuareve.

5.3 Pasaportat e njësive

Pasaporta e çdo njësie territoriale përcakton në mënyrë të plotë dhe eksplicite rregullat e zhvillimit dhe planin e përdorimit të tokës. Çdo parametër/përcaktim i pasaportave është në përputhje me përcaktimet e kuadrit ligjor për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Përcaktimet në secilën pasaportë vlejën vetëm për njësinë territoriale së cilës i përket kjo pasaportë. Pasaporta përkatëse e çdo njësie përcaktohet/identifikohet nga kodi unik i njësisë, i cili formohet sipas mënyrës së mëposhtme:

- Kufiza e parë i korrespondon dy germave të emrit të njësisë administrative VD: Vau-Dejës, BU: Bushat, SH – Shllak, VM: Vig-Mnelë, TE: Temal; HA: Hajmel;
- Kufiza e dytë i korrespondon kodit të sistemit (UB-urban, B-bujqësor, IN-infrastrukturor, N-natyror, U-ujor);
- Kufiza e tretë korrespondon me numrin rendor të njësisë.

Konkretisht, nëse flasim për njësinë që i përket njësisë administrative Bushat, ndodhet në sistemin urban dhe ka numër rendor 25, kodi përkatës është BU-UB-025.

Pasaporta përcakton në mënyrë të qartë funksionet e lejuara si dhe treguesit e zhvillimit të njësisë për ndërtimet e reja, p.sh. për njësitë ku lejohet ndërtimi jepet:

- Madhësia minimale e parcelës – përcakton madhësinë minimale të pronës për të cilën aplikohet për leje zhvillimi;
- Hapësira minimale e nevojshme publike – përcaktohet si shumë e KSHR dhe KSHP. Produkti i kësaj shume me sipërfaqen bruto të parcelës/pronës jep sipërfaqen e parcelës së ndërtueshme;
- Kufizime sektoriale nëse ka;
- Mënyra e ndërhyrjes – PDV/Leje zhvillimi.

Parametrat e zhvillimit

Në pasaportat e njësive jepen të gjithë parametrat të nevojshëm për zhvillim si:

- Koeficienti i shfrytëzimit të truallit – përcakton raportin ndërmjet gjurmës maksimale të ndërtimit me sipërfaqen e parcelës së ndërtueshme;
- Intensiteti – përcakton raportin ndërmjet sipërfaqes maksimale të ndërtimit me parcelën e ndërtueshme;
- Lartësia maksimale e objektit – në kate dhe metra.

Aplikimi i treguesve të zhvillimit bëhet sipas përcaktimeve në Rregulloren Vendore

1	PËRSHKRIMI	Njësi urbane qendrore me përdorim kryesisht banim, ku lejohen edhe shërbimet, hapësirat rekreative, shëndetësia, institucionet dhe arsimit. Ndërhyrjet duhet të respektojnë karakterin ekzistues, të konsolidojë indin urban të njësisë dhe të përmirësojnë cilësinë e hapësirave publike.	
4	KODI I NJËSISË STRUKTURE	VD-UB-162	
5	SIPËRFAQE	2.1 ha	
6	KOORDINATA GJEOGRAFIKE	19° 38' 16.784 ; 42° 0' 21.439	
7	ZONA		
8	BANORË / DENDËSI	378 / 179.68 banorë për hektar	
9	KATEGORIA KRYESORE	A	
10	KATEGORI TË TJERA PËRDORIMI	S SH IS AS AR IN	
11	NËNKATEGORI	A2 S1 S2 S3 SH1 SH2 IS2 IS3 IS5 IS6 AS1 AS2 AS3 AR1 AR2 AR3	
12	KUSHTËZIME LIGJORE	Zhvillimet e reja në njësi duhet të respektojnë: Zonën e mbrojtur të monumenteve të natyrës sipas Ligjit 9048 viti 2003. Përcaktimet për zonat informale.	
13	INSTRUMENTET E DREJTIMIT TË ZHVILLIMIT	-	
14	LLOJI I NDËRHYRJES NË TERRITOR	Dendesim	
15	INTENSITETI I LEJUAR	2.2 2.2 2.2 2.2 2.2 2.2 2.2 2.2 2.2 2.2 2.2 2.2 2.2 2.2 2.2	
16	KSHT	70% 70% 70% 70% 70% 70% 70% 70% 70% 70% 70% 70% 70% 70% 70%	
17	SIPËRFAQE MINIMALE PARCELE (M ²)	0 0 0 0 0 0 0 0 0 0 0 0 0 0 0	
18	LARTËSIA E NDËRTESAVE	KATE	4 4 4 4 4 4 4 4 4 4 4 4 4 4 4
19		METRA	15.5 15.5 15.5 15.5 15.5 15.5 15.5 15.5 15.5 15.5 15.5 15.5 15.5 15.5
20	TREGUESIT E DISTANCAVE	DISTANCAT NDËRMJET NDËRTESAVE	Sipas pikës 1 neni 37 të rregullores.
21		DISTANCA NGA RRUGA	Sipas pikës 3 neni 37 të rregullores.
22	KSHR	15% 15% 15% 15% 15% 15% 15% 15% 15% 15% 15% 15% 15% 15% 15%	
23	KSHP	15% 15% 15% 15% 15% 15% 15% 15% 15% 15% 15% 15% 15% 15% 15%	
24	VENDPARKIME	189	
25	GJELBËRIM (M ²)	0	
26	MËNYRA E NDËRHYRJES	Jo	
27	SIZMICITETI	SIPAS MSK 64	8 ballë
28		PGA	0.34 - 0.35
29	TIPOLOGJIA	TH7 TH7 TH7 TH7 TH7 TH7 TH7 TH7 TH7 TH7 TH7 TH7 TH7 TH7 TH7	
30	PËRDORIMI SPECIFIK	- - - - - - - - - - - - - - -	
31	PËRQINDJET E PËRDORIMIT	70% 20% 20% 20% 10% 10% 10% 10% 10% 10% 10% 10% 10% 10% 10%	
32	FAZA E ZHVILLIMIT	1 - 3	

Fig. 13: Shembull pasaporte (njësia VD-UB-162) draft

6 Transparenca dhe përfshirja e qytetarëve

Bashkia Vau-Dejës, aktualisht e radhitur ndër bashkitë me performancë relativisht të mesme në rang vendi³, përsa i përket transparencës ndaj publikut. Në kushte të tilla duhet të ketë një angazhim konkret në përmirësimin e instrumenteve për rritjen e transparencës në të gjitha funksionet që kryen, por njëkohësisht një vëmendje e veçantë duhet të jetë dhe në procesin e zbatimit të PPV-së.

Përsa i takon procesit të hartimit të PPV-së, stafi i Bashkisë Vau Dejës në bashkëpunim me ekspertët e kompanisë konsulente, kanë treguar një angazhim maksimal për dëgjuesat publike dhe transparencën. Bazuar edhe në kërkesat ligjore, për secilën fazë të hartimit të PPV janë organizuar 2-3 degjësa publike në polet kryesore urbane (Vau Dejës, Bushat dhe Hajmel).

Një instrument shtesë në rritjen e transparencës ishte dhe platforma WebGIS e hartuar nga kompania konsulente, e cila jep informacion të detajuar për të gjithë projektet e propozuara, njësitë strukturore sipas të cilave është ndarë territori dhe pasaportat me indikatorët e zhvillimit në përputhje me rregulloren lokale. Aktualisht platforma WebGIS është e aksesueshme nëpërmjet faqes <http://uts-01.com/WebGis/VauDejes> dhe është një mënyrë shumë e thjeshtë informimi dhe pjesëmarrjeje për qytetarët.




Fig. 14: Pamje nga faqja WebGis

Kjo platformë ndodhet në serverat e kompanisë konsulente që po mbështet bashkinë në hartimin e planit, por pas miratimit të PPV, mund të transferohet lehtësisht në faqen zyrtare bashkisë në mënyrë që të vazhdojë të shërbejë si një instrument transparence gjatë zbatimit të PPV.

³Raporti: Monitorimi 2017- Implementimi i të drejtës së informimit nga Bashkitë e Shqipërisë, realizuar nga Qendra për Çështje të Informimit Publik INFOÇIP. Sipas këtij raporti, Bashkia Vau Dejës renditet e 33-ta, në tabelën vlerësuese të 61 bashkive, sipas 5 komponentëve e ligjit 119/2014“Për të drejtën e informimit”

Një tjetër iniciativë me qëllim rritjen e transparencës ishte dhe organizimi i ekspozitës së PPV. Përmbajtja e ekspozitës kishte një informacion grafik të përshkallëzuar (përmes 5 hartave), duke filluar nga një shkallë e gjërë në nivel rajonal deri në informacion përdorimi toke në nivel parcele. Kjo ekspozitë qëndroi në sheshet kryesore të qendrave Vau-Dejës dhe Bushat për më shumë se 10 ditë. Qytetarët, përveç marrjes së infomacionit, patën mundësi të jepnin komentet e tyre përmes pyetsorëve të vënë në dispozicion pranë ekspozitës.



Fig. 15: Foto gjatë organizimit të ekspozitës së PPV

7 ANEKS

Në këtë aneks tregohen gjithë hartat që janë pjesë e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vau-Dejës, të përgatitura për secilin raport (fazë) respektivisht.

Analiza dhe Vlerësimi i Territorit (Faza e parë),Lista e hartave:

U/I-01	Harta bazë e njësisë vendore;
U/I-02	Harta topografike;
U/I-03	Harta gjeologo-inxhinierike;
U/I-04	Harta gjeologjike;
U/I-05	Harta hidrografike;
U/I-06	Harta hidrogjeologjike;
U/I-07	Harta e riskut hidrologjik;
U/I-08	Harta e zonimit sizmik;
U/I-09	Harta e tokave natyrore;
U/I-10	Harta e problemeve mjedisore;
U/I-11	Harta e monumenteve të natyrës;
U/I-12	Harta e monumenteve të kulturës;
U/I-13	Harta e pozicionit strategjik në raport me rajonin;
U/I-14	Harta e vlerësimit ekonomik;
U/I-15	Harta e vlerësimit social;
U/I-16	Harta e vlerësimit demografik;
U/I-17	Harta e analizës së planeve të mëparshme;
U/I-18	Harta e pronave;
U/I-19	Harta e rëndësisë kombëtare;
U/I-20	Harta e elementeve përjashtues;
U/I-21	Harta e sistemeve bazë;
U/I-22	Harta e tokave bujqësore;
U/I-23	Harta e kategorive bazë të sistemit urban;
U/I-24	Harta e lartësisë së objekteve;
U/I-25	Harta e infrastrukturës rrugore;
U/I-26	Harta e tipologjisë hapësinore;
U/I-27	Harta e periferialitetit;
U/I-28	Harta e elementeve të veçantë në territor;
U/I-29	Harta e intensitetit të ndërtimit;
U/I-30	Harta e klasifikimit të tipologjisë hapësinore;
U/I-31	Harta e bonitetit të tokave;
U/I-32	Harta e tipologjisë së zhvillimit hapësinor;
U/I-33	Harta e nënkategorive të përdorimit të tokës;

Strategjia Territoriale (Faza e dytë),Lista e hartave:

U/I-01	Harta e Vizionit Lokal të Përgjithshëm;
U/I-02	Harta e Strategjisë së Sistemit Natyror;
U/I-03	Harta e Strategjisë së Sistemit Ujor;
U/I-04	Harta e Strategjisë së Sistemit Bujqësor;

U/I-05	Harta e Strategjisë së Sistemit Urban;
U/I-06	Harta e Strategjisë së Sistemit Infrastrukturor;
U/I-07	Harta e Identifikimi dhe Hartëzimit të Projekteve;
U/I-08	Harta e Projeksionit Demografik;
U/I-09	Harta e Fazimit të Projekteve;
U/I-10	Harta e Potencialit Energjetik;
U/I-11	Harta e Konsumit të Ujit;
U/I-12	Harta e Fluksit të Ujit;
U/I-13	Harta e Fluksit të Ushqimit;
U/I-14	Harta e Flukseve;

Plani i Zhvillimit dhe Rregullorja Lokale (Faza e tretë),Lista e hartave:

U/III-01	Harta e ndarjes së territorit sipas sistemeve bazë;
U/III-02	Harta e sistemit urban;
U/III-03	Harta e sistemit infrastrukturor;
U/III-04	Harta e sistemit bujqësor;
U/III-05	Harta e sistemit ujor;
U/III-06	Harta e sistemit natyror;
U/III-07/01	Harta e ndarjes së njësive dhe kodifikimi;
U/III-08	Harta e zonimit sipas kategorive bazë të përdorimit të propozuar të tokës
U/III-09	Harta e zhvillimit të njësive;
U/III-10	Harta e mënyrave të ndërhyrjes;
U/III-11	Harta e intensitetit dhe numri i kateve të propozuara;
U/III-12	Harta e koeficientit të propozuar të shfrytëzimit;
U/III-13	Harta e njësive të propozuara për PPV-në;
U/III-14	Harta e shpërndarjes së popullsisë në territor;
U/III-15	Harta e projekteve të zhvillimit;
U/III-16	Harta e shpërndarjes territorial dhe mbulimi i shërbimeve sociale;
U/III-17	Harta e zonave të rëndësisë kombëtare;
U/III-18	Harta e transportit publik;
U/III-19/01	Harta e infrastrukturës së propozuar rrugore;
U/III-20	Harta e shkallës së ndërhyrjes në infrastrukturën rrugore;
U/III-21	Harta e zonimit të territorit;
U/III-22	Harta e instrumentave drejtues të zhvillimit;
U/III-23	Harta e nevojave për strehim;
U/III-24	Harta e planit të veprimit;
U/III-25	Harta e zhvillimit ekonomik;
U/III-26	Harta e zonave prioritare të zhvillimit;
U/III-27	Harta e pezullimit të zhvillimit;
U/III-28	Harta e zonimit sipas nënkategorive të propozuara të përdorimit të tokës;
U/III-29	Harta e vijës së kuqe të ndërtimit;
U/III-30	Harta e shërbimeve dhe infrastrukturës së propozuar;
U/III-31	Harta e zonave gri.